

Të dhënat kryesore financiare

Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.			
Vlerat monetare janë në milionë euro	2018	2017	Change
Pasqyra e të ardhurave	1/1-31/12	1/1-31/12	
Të ardhurat neto pas provizioneve	38.9	32.4	20.0%
Të ardhurat neto nga tarifat bankare	10.8	12.9	-16.5%
Të ardhurat neto nga vlerësimi i instrumenteve financiare në vlerë të drejtë	0.1	0.2	-51.0%
Të ardhurat / shpenzimet nga tregtimi	(0.2)	(0.1)	203.0%
Të ardhurat tjera operative	1.1	1.1	4.3%
Shpenzimet e përgjithshme administrative	(27.6)	(26.7)	3.2%
Fitimi para tatimit	23.0	19.9	15.9%
Fitimi pas tatimit	20.5	17.6	16.6%
Fitimet për aksion	N/A	N/A	N/A
Bilanci i gjendjes			
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	24.7	39.6	-37.5%
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	593.2	532.5	11.4%
Depozitat dhe huamarrjet nga bankat	0.6	9.2	-93.3%
Depozitat nga klientët	729.5	735.8	-0.9%
Ekuiteti (përfshi interesat jo-kontrolluse)	127.7	125.3	1.9%
Gjithsej bilanci i gjendjes	888.9	900.9	-1.3%
Informatat vendore rregullative			
Pasuritë e ponderuara sipas riskut B1	721.6	636.2	13.4%
Gjithsej fondet vetanake	132.8	130.5	1.8%
Gjithsej kërkesa për fonde vetanake	86.6	76.3	13.4%
Raporti i mbulimit tepricë	53.3%	70.9%	-17.6 PP
Raporti i kapitalit kryesor (klasi i parë)	15.9%	17.0%	-1.1 PP
Gjithsej raporti i fondeve vetanake	18.4%	20.5%	-2.1 PP
Performanca			
Kthimi në ekuitet (KE) para tatimit	20.6%	18.0%	2.6 PP
Kthimi në ekuitet (KE) pas tatimit	18.4%	16.0%	2.4 PP
Koeficienti kosto/të ardhura	51.3%	53.2%	-1.9 PP
Kthimi në pasuri (KP) para tatimit	2.6%	2.3%	0.4 PP
Raporti neto i provizionimit (Pasuritë mesatare të ponderuara sipas riskut B1 në librin e bankës)	0.5%	1.0%	-0.5 PP
Koeficienti rrezik / fitime	7.5%	11.3%	-3.8 PP
Burimet			
Numri i punëtorëve	845	804	5.1%
Zyrat e biznesit	46	46	0.0%

Përmbajtja

Raport nga Bordi Mbikëqyrës	4
Report nga Bordi Menaxhues	5
Bordi Menaxhues në Kosovë	6
Struktura organizative	7
Vizioni dhe misioni	8
Shkurtimisht mbi Raiffeisen Bank International	9
Zhvillimet në ekonominë e Kosovës	10
Sektori bankar në Kosovë	12
Performanca dhe financat e Bankës Raiffeisen në Kosovë	14
Thesari, menaxhimi i pasurive dhe i detyrimeve	18
Segmentet e biznesit	22
Produktet dhe shërbimet bankare	24
Kanalet e distribuimit	26
Menaxhimi i rrezikut	28
Burimet njerëzore dhe trajnimet	32
Qëndrueshmëria dhe përgjegjësia korporative	34
Pasqyrat financiare	38
Adresat dhe kontaktet	112

Raporti nga Bordi Mbikëqyrës

Zonja dhe zotërinj,

Banka ka pasur një vit tjetër të shkëlqyeshëm, me një fitim neto pas tatimit prej 20.5 milionë euro. Banka gjithashtu ka shënuar përmirësime në një varg të gjerë të treguesve kyç të performancës në krahasim me vitin 2017 dhe pozita jonë e parë në treg është konsoliduar edhe më tej.

Në vitin financiar 2018, anëtarët e Bordit Mbikëqyrës kanë mbajtur 4 takime të zakonshme dhe 1 takim të jashtëzakonshëm. Shkalla e përgjithshme e pjesëmarrjes në takimet e Bordit Mbikëqyrës të mbajtura në vitin financiar 2018 ishte rreth 96 përqind.

Bordi Mbikëqyrës ka monitoruar në mënyrë të rregullt dhe gjithëpërfshirëse performancën e biznesit dhe zhvillimet e rrezikut në Bankën Raiffeisen në Kosovë. Janë mbajtur diskutime të rregullta me Bordin Menaxhues mbi mjaftueshmërinë e kapitalit dhe likuiditetin, si dhe drejtimin e strategjive të bankës për biznesin dhe rrezikun. Bordi Mbikëqyrës gjithashtu është marrë në detaje me zhvillimin e mëtejshëm në fushën e qeverisjes korporative dhe ka monitoruar zbatimin e politikave korresponduese. Gjatë aktiviteteve të tij monitoruese dhe këshilluese, Bordi Mbikëqyrës ka mbajtur kontakt të drejtpërdrejt me anëtarët përgjegjës të Bordit Menaxhues, auditorin dhe udhëheqësit e funksioneve të kontrollit të brendshëm. Gjithashtu ka shkëmbyer vazhdimisht informacione dhe pikëpamje me përfaqësuesit e autoriteteve mbikëqyrëse bankare mbi çështjet aktuale.



Për më tepër, Bordi Menaxhues i ka ofruar Bordit Mbikëqyrës raporte të rregullta dhe të detajuara mbi çështjet relevante në lidhje me performancën në fushat përkatëse të biznesit. Gjatë periudhës ndërmjet takimeve, Bordi Mbikëqyrës gjithashtu ka mbajtur kontakt me Kryesuesin e Bordit Menaxhues dhe anëtarët e Bordit Menaxhues. Bordi Menaxhues ishte në dispozicion kur është kërkuar për diskutime multilaterale apo bilaterale me anëtarët e Bordit Mbikëqyrës, me përfshirjen e ekspertëve për çështjet e adresuara nga Bordi Mbikëqyrës, kur ishte e aplikueshme.

Puna që është ndërmarrë së bashku me Bordin Menaxhues është bazuar në një marrëdhënie të besimit të ndërsjellë dhe është realizuar në frymën e bashkëpunimit efikas dhe konstruktiv. Diskutimet kanë qenë të hapura dhe shumë të rëndësishme dhe Bordi Mbikëqyrës ka miratuar vendime pas shqyrtimit të të gjitha aspekteve. Nëse janë nevojitur informacione shtesë për të shqyrtuar çështjet e veçanta më në detaje, atëherë këto iu janë ofruar anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës pa vonesë dhe sipas kërkesës së tyre.

Do të doja të përfitoj nga ky rast për të falënderuar të gjithë punëtorët e Bankës Raiffeisen në Kosovë për punën e tyre të palodhshme dhe përpjekjet e tyre të palëkundura në vitin 2018, si dhe për të kërkuar angazhimin e tyre të vazhdueshëm në trajtimin e sfidave në të ardhmen.

Në emër të Bordit Mbikëqyrës

Peter Lennkh
Kryesues i Bordit Mbikëqyrës

Raporti nga Bordi Menaxhues

2018 ishte një vit i shkëlqyer për Bankën Raiffeisen Sh.A. në Kosovë. Mjededisi makro ekonomik i vendit ishte më i mirë se në shumë vende të tjera në Evropën Juglindore dhe Bruto Produkti Vendor i llogaritur për Kosovën ishte mbi 4 për qind, duke kontribuar kështu në një vit tjetër shumë të mirë për bankën, me fitim neto pas tatimit prej 20.5 milionë euro.

Rritja e kredive në të gjitha segmentet e klientëve ishte mbresëlënëse dhe edhe pse në ndërmorëm një qasje të matur dhe të arsyeshme në kreditimin tonë, portofolio jonë u rrit me 41 milionë euro, në 593.2 milionë euro në fund të vitit, duke përfaqësuar një rritje prej 11 përqind në vitin 2017. Qasja jonë e kujdeshme në kreditim për tashmë disa vite ka rezultuar në raport të shkëlqyer të kredive joperformuese prej 3.2 përqind në fund të vitit 2018 dhe sistemi bankar i Kosovës ka raportin më të ulët të KJP në Evropën Juglindore. Depozitat tona u zvogëluan me 0.9 përqind në 729.5 milionë euro dhe kjo ka qenë një strategji e qëllimshme në mënyrë që të ruajmë një raport të kënaqshëm të kredive ndaj depozitave prej 80 përqind. Menaxhimi i kostos dhe efikasiteti i përmirësuar vazhduan të jenë prioriteti i lartë në vitin 2018 dhe raporti i kostove ndaj të ardhurave u zvogëlua nga 52.8 përqind në vitin 2017 në 50.9 përqind në vitin 2018.


Fokusi jonë në rritjen e përdorimit të kanaleve alternative nëpërmjet një vargu të fushatave vetëdijësuese rezultoi në rezultate pozitive dhe ne kemi procesuar 683 mijë transaksione e-banking, që ishte një rritje prej 20 përqind në krahasim me vitin 2017. Përdorimi i shërbimit tonë mobil bankar u rrit me 36 përqind dhe pagesat nëpërmjet këtij kanali u rritën me 45 përqind. Gjithashtu kemi procesuar mbi 1.5 milionë transaksione në terminalat tona të pikave të shitjes, që ishte një rritje prej 28 përqind në krahasim me vitin 2017. Përveç kësaj, 4.5 milionë transaksione u realizuan në bankomatët tanë, që është një rritje prej 18 përqind krahasuar me vitin 2017.

Në segmentet tona të biznesit të ndërmarrjeve të vogla (NV) dhe korporatave vazhdoi trendi pozitiv i përdorimit të rritur të kanaleve alternative. Përgjatë vitit u procesuan 387 mijë transaksione e-banking, duke përfaqësuar 83 përqind të të gjitha pagesave të procesuara, një rritje prej 6 përqind në krahasim me vitin 2017, dhe përdorimi i shërbimit inovativ të pagesës me SMS për pagesat doganore i prezantuar në vitin 2016, vazhdoi të jetë në nivel të lartë me 269 milionë të pagesave doganore që procesohen, duke përfaqësuar 75 përqind në segmentin e korporatave dhe 32 përqind në atë të NV-ve, të të gjitha pagesave doganore të procesuara.

Shërbimi për klientë vazhdoi të jetë një përparësi e rëndësishme konkurruese dhe si gjithmonë, ne jemi fokusuar në përmirësimin e kënaqshmërisë së klientëve me të gjitha produktet dhe shërbimet tona. Kemi bërë investime të konsiderueshme në teknologji dhe trajnimin e punonjësve për të plotësuar dhe tejkaluar pritjet e klientëve tanë dhe për të siguruar se ofrojmë përvoja pozitive dhe të paharrueshme në çdo ndërveprim. Kultura jonë e përqendruar drejt klientit është një mundësi (ndihmues) i madh dhe është baza mbi të cilën zhvillojmë çdo gjë për të plotësuar kërkesat dhe pritjet e klientëve tanë. Duke qenë aktiv në rrjetet sociale, ne gjithashtu kemi arritur që të qëndrojmë afër klientëve tanë dhe të angazhohemi përmes komunikimeve relevante dhe motivuese dhe përgjigjeve ndaj kërkesave dhe pyetjeve të tyre në kohë të duhur.

Në fushën e përgjegjësisë shoqërore korporative, Banka ka vazhduar të kontribuojë në projekte të fushës së kulturës, teknologjisë, arsimit dhe mirëqenies sociale. Dy projektet kryesore kulturore të cilat Banka i përkrah financiarisht për një dekadë janë festivalet e mirënjohura: Chopin Piano Festival dhe Festivali i Filmit, PriFest. Banka po ashtu mbështeti Galerinë Kombëtare në dy ekspozitat kryesore "Muslim Mulliqi" dhe "Gjon Mili" ndërsa artistët e rinj kanë vazhduar ta shfrytëzojnë Galerinë Raiffeisen për të prezantuar veprat e tyre para publikut edhe gjatë vitit 2018. Sa i përket arsimit dhe inovacionit, Banka mbështeti projektet e Atomi, BoneVet, dhe Qendrës së Inovacionit në Kosovë (ICK). Banka po ashtu ka kontribuar edhe në projektet e mirëqenies sociale, përmes organizatës "Aksioni për Nënën dhe Fëmijë" që punon në ngritjen e vetëdijësisë dhe mbështetjen e nënave të reja në Kosovë. Në fund, në emër të Bordit Menaxhues do të dëshiroja të falënderoj të gjithë punonjësit për një vit tjetër të shkëlqyer. Asnjëra nga këto nuk do të ishte e mundshme pa aftësitë, angazhimin dhe dedikimin e tyre.

Në emër të Bordit Menaxhues,



Robert Wright
Kryesues i Bordit Menaxhues



Banka Raiffeisen në Kosovë Bordi Menaxhues



Robert Wright

Kryesues i Bordit
Menaxhues



Shukri Mustafa

Anëtar i Bordit
Menaxhues



Iliriana Toçi

Anëtare e Bordit
Menaxhues




Johannes Riepl

Anëtar i Bordit
Menaxhues

Banka Raiffeisen në Kosovë

Struktura organizative

Më datë 31 dhjetor 2018



*Auditori i brendshëm i raporton drejtpërdrejt Komitetit të Auditimit të Bordit Mbikqyrës

Vizioni dhe misioni i Bankës Raiffeisen në Kosovë

Vizioni

Të jetë banka kryesore dhe universale në Kosovë.

Misioni

Të zhvillojë marrëdhënie afatgjata me klientë duke ju ofruar një gamë të gjerë të produkteve konkurruese dhe shërbime të një standardi të lartë.

Të jetë punëdhënësi më i mirë në Kosovë.

Shkurtimisht mbi Raiffeisen Bank International

RBI e konsideron Austrinë, ku është një korporatë dhe bankë investuese prijëse, si dhe Evropën Qendrore dhe Lindore (EQL), si tregun e saj amë. Bankat filiale mbulojnë 13 tregje në gjithë rajonin. Përveç kësaj, Grupi përfshinë ofrues tjerë të shumtë të shërbimeve financiare në fushat si lizingu, menaxhimi i asetëve dhe bashkimi dhe blerja (M&A).

Gjithsej afërsisht 47,000 punëtorë të RBI u shërbejnë 16.1 milionë klientëve në më shumë se 2,100 njësi të biznesit, shumica e të cilave janë në EQL. Aksionet e RBI AG janë listuar në bursën e Vjenës që nga viti 2005.

Në fund të vitit 2018, asetet e përgjithshme të RBI ishin 140 miliardë euro. Bankat rajonale Raiffeisen mbajnë përafërsisht 58.8 përqind të aksioneve të RBI, ku pjesa e mbetur e aksioneve prej përafërsisht 41.2 përqind gjendet në shitje të lirë.

Zhvillimet në ekonominë e Kosovës

Ekonomia e Kosovës u rrit mesatarisht për 3.9 përqind gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2018, duke shënuar një ngadalësim krahasuar me 4.2 përqind sa ishte në vitin 2017 (burimi: vlerësimet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës). Rritja reale e ekonomisë mbështetet nga kërkesa e brendshme që kryesisht reflektohet në rritjen e kreditimit bankar dhe rritjen në investime. Tremujori i fundit pritet të ketë pothuajse të njëjtin nivel zgjerimi të aktivitetit ekonomik për shkak të investimeve më të larta private dhe publike.

Përkundër presioneve të lehta inflacioniste në fillim të vitit 2018, ndryshimi i dinamikës gjatë vitit rezultoi me rritje të normës së inflacionit në pjesën e dytë të vitit nga zona negative ose zona afër zeros të pjesës së parë. Megjithatë, norma vjetore e inflacionit sillej mesatarisht 1.1 përqind në vitin 2018, duke rënë nga 1.5 përqind e vitit 2017. Rritja e normës së inflacionit në muajt e fundit të vitit 2018 erdhi nga çmimet më të larta të ushqimit dhe karburanteve në tregjet ndërkombëtare.

Tregu i punës ka treguar shenja përmirësimi, duke shënuar rënie të shkallës së papunësisë nga mesatarisht 30.5 përqind në vitin 2017 në 29.5 përqind në vitin 2018. Megjithatë, niveli i papunësisë është përkeqësuar nga njëri tremujor në tjetrin, duke arritur kulmin prej 31.4 përqind në tremujorin e fundit të vitit 2018. Shkalla e papunësisë së të rinjve mbetet e lartë prej rreth 57.3 përqind.

Zhvillimet në sektorin fiskal tregojnë rritje të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore në vitin 2018. Rritja e të ardhurave buxhetore prej 4.5 përqind në vitin 2018 dhe rritja e shpenzimeve buxhetore për 10.3 përqind, kanë rezultuar me deficit të përgjithshëm buxhetor prej 73 milion euro krahasuar me deficitin buxhetor prej 68 milionë eurosh në vitin 2017. Deficiti i përgjithshëm buxhetor vlerësohet të jetë 1.2 përqind të BPV-së, që është në kuadër të nivelit të kërkuar prej 2.0 përqind të rregullës fiskale të BPV-së. Investimet publike në vitin 2018 u vlerësuan në 530 milionë euro sipas të dhënave preliminare fiskale (burimi: Ministria e Financave), që janë 13.4 përqind më të larta se vitin e kaluar, duke dhënë kontribut të rëndësishëm në rritjen ekonomike.

Niveli i borxhit publik është rritur në 948.1 milion euro në fund të vitit 2018 nga 856.9 milionë euro sa ishte në vitin 2017, duke arritur nivelin prej 17.1 përqind të BPV-së. Edhe pse borxhi publik paraqet një trajektore rritëse, raporti mes borxhit publik dhe BPV-së mbetet i shëndoshë.

Pozita e jashtme e Kosovës është përkeqësuar në vitin 2018, pasi që deficitin i llogarisë rrjedhëse, që arriti në 564 milionë euro në fund të vitit, u rrit me 47.2 përqind krahasuar me të njëjtin periudhë të vitit të kaluar, kryesisht si rezultat i përkeqësimit të deficitit tregtar. Deficiti tregtar arriti në 2,73 miliardë euro në vitin 2018 ose 10,9 përqind më i lartë se në vitin 2017, duke përbërë sfidën kryesore të ekonomisë së vendit. Pavarësisht se eksportet e shërbimeve vazhduan rritjen (5.4 përqind në baza vjetore) me mbështetjen kryesore të flukseve hyrëse të turizmit, importet e shërbimeve shënuan rritje më të shpejtë (17.2 përqind në baza vjetore), prandaj shërbimet neto shënuan rënie të lehtë në vitin 2018 duke pasur ndikim më të vogël negativ në deficitin e llogarisë rrjedhëse.

Remitancat vazhduan të rriten në vitin 2018, duke ndikuar pozitivisht në ekonominë e vendit. Remitancat arritën kulmin në 800.6 milionë euro, me rritje vjetore prej 5.5 përqind në vitin 2018, duke financuar plotësisht deficitin e llogarisë rrjedhëse. Në anën tjetër, IHD-të në fund të vitit 2018 arritën në rreth 214 milionë euro, duke u pakësuar për 16.3 përqind, duke nënkuptuar rënie të interesimit për investime ose se vendi nuk arriti ta tërheqë vëmendjen e investitorëve pavarësisht potenciali të tij të lartë.



Sektori bankar në Kosovë

Shënim: Të dhënat janë të bazuara në publikimet zyrtare të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Sektori bankar në Kosovë vazhdon të jetë sektori kryesor që kontribuon në stabilitetin dhe zgjerimin e aktiviteteve financiare në vend.

Struktura e sektorit bankar në Kosovë gjatë vitit aktual nuk ka pësuar ndonjë ndryshim. Ngjashëm me vitin paraprak, kishte dhjetë banka të licencuara që operonin në treg. Institucionet bankare me prejardhje nga BE dominojnë sektorin bankar në Kosovë, edhe pse bankat nga vendet tjera vazhdojnë ta rrisin praninë e tyre. Bankat me prejardhje nga BE-ja përbëjnë 61 përqind të totalit të aseteve të bankës derisa bankat me prejardhje nga Turqia gjithashtu shtuan praninë e tyre deri në 16.5 përqind.

Shuma totale e aseteve në sektorin bankar arrin në 4.18 miliardë euro në dhjetor 2018 (2017: 3.88 miliardë euro). Rritja e totalit të aseteve në vitin 2018 ishte 7.7 përqind dhe është më e lartë se rritja e vitit të kaluar prej 6.6 përqind. Rritja e totalit të aseteve të bankave është ndikuar kryesisht nga rritja e kredive dhe paradhënieve për konsumatorë, që vazhdon të jetë kategoria kryesore e aseteve.

Bilancet e bankës të parasë së gatshme dhe rezervës me Bankën Qendrore si dhe ekspozimi me bankat tjera komerciale janë rritur gjithashtu deri në dhjetor 2018. Rritja e parasë së gatshme dhe rezervës me Bankën Qendrore ishte 42.5 milionë euro ose 8.5 përqind. Rritja e bilanceve me bankat tjera ishte 37 milionë euro ose 12.2 përqind nga një vit më parë.



Aktiviteti kreditues i bankave vazhdoi të rritet gjatë vitit 2018, edhe pse rritja ishte pak më e vogël se norma e rritjes në vitin e kaluar. Totali i kredive dhe paradhënieve arriti vlerën prej 2.76 miliardë euro (2017: 2.49 miliardë euro), që është një rritje vjetore prej 10.9 përqind krahasuar me rritjen prej 11.5 përqind në vitin 2017. Kjo rritje pak më e ngadalshme sesa e vitit paraprak është rezultat i rritjes më të ngadaltë ekonomike dhe rritjes së normave të interesit në treg gjatë vitit 2018. Megjithatë, rritja vazhdon të jetë e konsiderueshme marrë parasysh kushtet e përgjithshme të favorshme të kreditimit nga bankat, qasja në huadhënie, përmirësimi i cilësisë së kredisë në treg dhe rritja e kërkesës për kredi.

Kontributi më i madh në rritjen e kredisë ishte si nga kreditë dhe paradhëniet për bizneset ashtu dhe për individët. Kreditë dhe paradhëniet për individë vazhduan të kenë ndikim të rëndësishëm në rritjen totale të portofolit të kredisë dhe gjatë vitit 2018 këto kredi u rritën për 11.2 përqind krahasuar me 12.7 përqind një vit më parë.

Përbërja në përqindje e portofolit të kredive dhe paradhënieve të bankës në dhjetorin e vitit 2018 ishte 64 përqind korporatat jofinanciare dhe 36 përqind individët. Kjo shpërndarje e përqindjes mes korporatave jofinanciare dhe individëve ka mbetur mjaft e qëndrueshme në tri vitet e fundit.

Përqendrimi në sektorë ekonomik i kredive dhe paradhënieve të reja për biznese vazhdoi të jetë i dominuar nga sektori i shërbimeve me një pjesëmarrje të përgjithshme prej 71 përqind, pasuar nga industria 13 përqind dhe ndërtimi me 9 përqind. (Burimi: Buletini Mujo Statistikor, dhjetor 18, Nr.208).


Nga ana tjetër, përbërja e kredive të reja për individët përfshin kryesisht kreditë konsumuese me 73 përqind, pasuar nga kreditë hipotekare me 18 përqind dhe kreditë tjera me 9 përqind. (Burimi: Buletini Mujo Statistikor, dhjetor 18, Nr.208).



Investimet e sektorit bankar në bono qeveritare dhe bono të thesarit ishin 430.2 milionë euro në dhjetor 2018 (2017: 486.7 milionë euro), me rënie prej 11.6 përqind. Investimet në bono të thesarit të Kosovës vazhduan të rriten, por rënia është rezultat i rënies më të shpejtë në ekspozime me bonot e lëshuara nga vendet e huaja. Rënia në kthimet (yield) e bonove mund të ketë ndikuar në këtë rënie dhe më shumë fonde janë orientuar në kreditimin e klientëve vendorë me kthime më të larta të përgjithshme.

Depozitat e klientëve vazhdojnë të jenë kontribuuesi kryesor në financimin e aktiviteteve bankare. Deri në dhjetor 2018, depozitat e klientëve përbënin 80 përqind të totalit të detyrimeve të sektorit bankar. Mbështetja e madhe në financimin nga depozitat vendore, sidomos nga individët privatë e bën këtë mënyrën më të besueshme të financimit krahasuar me kanalet tjera dhe e bën imune ndaj luhatjeve ndërkombëtare në tregjet financiare. Totali i depozitave në sektorin bankar arritën vlerën 3.4 miliardë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 272 milionë eurosh ose 8.8 përqind (2017: 6.7 përqind).

Struktura e depozitave në banka ka ndryshuar viteve të fundit, pasi që normat e interesit kanë shënuar rënie historike. Në këtë mënyrë, ka më shumë depozita në llogaritë rrjedhëse dhe më pak në depozita të afatizuara dhe llogari kursimi. Në dhjetor të vitit 2018, depozitat pa afat përbënin 60 përqind të totalit të depozitave dhe pjesa tjetër përbëhet nga depozitat e afatizuara dhe depozitat e kursimit me 40 përqind. Norma mesatare e depozitave u rrit për 0.2 pikë përqindjeje vitin e kaluar duke arritur 1.5 përqind nga 1.3 përqind sa ishte në dhjetor 2017. Norma mesatare për depozitat e individëve ishte 1.4 përqind ndërsa për bizneset ishte 1.5 përqind.



Normat e interesit për kredi kanë pësuar rënie tash e disa vite. Trendi i njëjtë vazhdoi edhe në vitin 2018. Norma mesatare efektive e interesit për kredi ka pësuar rënie në 6 përqind nga 6.8 përqind në dhjetorin e vitit 2017.

Normat e interesit për kredi kanë pësuar rënie si për bizneset ashtu edhe për individët privatë. Norma mesatare e interesit për bizneset në dhjetor 2018 ishte 6 përqind krahasuar me 6.5 përqind në dhjetor 2017. Ndërsa, norma mesatare e interesit për individët në dhjetor 2018 ka rënë në 6.3 përqind nga 7.3 përqind sa ishte në dhjetor të vitit 2017. (Burimi: BQK, Sistemi Financiar, Informata Mujore, dhjetor 2018).

Në vitin 2018, sektori bankar ka arritur performancë të mirë të përgjithshme financiare në disa nga treguesit kryesorë të performancës, përfshirë profitabilitetin dhe kreditë jo-performuese.

Të ardhurat e bankës u rritën në 253 milionë euro në vitin 2018 (2017: 241 milionë euro) ndërsa shpenzimet gjithashtu arritën në 166 milionë euro (2017: 156 milion euro). Rritja e të ardhurave vjen kryesisht nga rritja e të ardhurave nga interesi, si rezultat i rritjes së kredive dhe paradhënieve për klientë në vitin 2018.




Në vitin 2018, shpenzimet e interesit u rritën për 1 milion euro si rezultat i rritjes së niveleve të depozitave në treg dhe rritjes së normave mesatare derisa shpenzimet e përgjithshme dhe administrative të bankës gjithashtu kanë shënuar rritje të lehtë prej 0.7 milion eurosh nga viti 2017 duke arritur në 105 milionë euro në fund të vitit 2018. Deri më 31 dhjetor 2018, fitimi neto i sektorit bankar ishte 87 milionë euro (2017: 85.3 milionë euro). Kthimi mesatar në asetet e sektorit bankar ka shënuar rënie të lehtë në vitin 2018 me 0.1 pikë përqindjeje në 2.5 përqind (2017: 2.6 përqind) dhe kthimi mesatar në kapital gjithashtu ka rënë në 20.2 përqind nga 21.3 përqind në vitin 2018.

Raporti kredi/ depozita i bankave ishte 81.9 përqind në vitin 2018 nga 80.4 përqind sa ishte në vitin 2017. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (kapitali rregullativ/ asetet e peshuara me rrezik) ishte 17 përqind duke shënuar kështu rënie nga 18 përqind në vitin 2017. Në vitin 2018, raporti i kredive jo-performuese është përmirësuar dhe njëkohësisht edhe raporti i mbulimit me provizione i kredive jo-performuese gjithashtu është përmirësuar. Kështu që, në fund të dhjetorit të vitit 2018, raporti i kredive jo-performuese ndaj totalit të kredive ka rënë në 2.7 përqind (2017: 3.1 përqind). Raporti i mbulimit të kredive jo-performuese gjithashtu është përmirësuar nga 150 përqind në 2017 në 152 përqind në 2018.

Performanca dhe rezultatet financiare të Bankës Raiffeisen në Kosovë

Shënim: Analizat e tregut janë bazuar në rezultatet preliminare të botuara nga bankat komerciale, të përgatitura sipas rregullave të Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës.

Totali i aseteve të Bankës Raiffeisen në Kosovë më 31 dhjetor 2018 ishte 888.9 milionë euro. Kjo paraqet rënie të lehtë prej 1.3 përqind krahasuar me një vit më parë (2017: 900.9 milionë euro). Përqindja e pjesëmarrjes në treg të totalit të aseteve të Bankës Raiffeisen në Kosovë ishte 21 përqind (2017: 24 përqind).





Struktura e aseteve të Bankës Raiffeisen në Kosovë vazhdon të dominohet nga kreditë dhe paradhëniet për klientë. Deri në dhjetor 2018, 67 përqind e totalit të aseteve ishte përqendruar në kredi dhe paradhënie për klientë pas provizionimit për humbjet nga kreditë. Kjo është pasuar me 14 përqind në investimet në letrat me vlerë.

Investimet në letrat me vlerë përfshijnë investimet në bono qeveritare dhe të korporatave të vendeve të BE-së dhe SHBA-ve si dhe bono të thesarit të lëshuara nga Qeveria e Kosovës.

Investimet në letra me vlerë kanë pësuar një rënie prej 36 përqind në vitin 2018. Kjo rënie reflekton pozitën e përgjithshme të likuiditetit të bankës pasi që më shumë asete ishin të orientuara në kreditimin e segmenteve retail dhe jo-retail në treg. Investimet e përgjithshme në letra me vlerë në vitin 2018 ishin 123.7 milionë euro. Investimet në bono të thesarit të Qeverisë së Kosovës ishin 21.3 milionë euro (2017: 33.6 milionë euro) dhe investimet në obligacione tjera të qeverisë dhe korporatave të vendeve të OECD-së ishin 102.4 milionë euro (2017: 161 milionë euro).

Totali i kredive bruto dhe paradhëniet të Bankës Raiffeisen në Kosovë deri më 31 dhjetor 2018 ishte 615.2 milionë euro (2017: 554 milionë euro). Pjesëmarrja në treg e bankës në kredi dhe paradhënie më 31 dhjetor 2018 ishte 22 përqind (2017: 22 përqind).





Banka Raiffeisen në Kosovë ka ndarë edhe rezerva për humbjet nga kreditë në bazë të politikave të rrezikut kreditor. Këto rezerva për humbjet nga kreditë arrijnë në 22 milionë euro (2017: 21.5 milionë euro). Këto rezerva llogariten në bazë të modelit SNRF 9 për humbjet e pritshme nga kreditë dhe pasqyrojnë vlerësimin e Bankës Raiffeisen në Kosovë të rrezikut në portofolin e kredisë më 31 dhjetor 2018.

Bilanci i humbjeve të pritshme të kredisë është më i lartë se një vit më parë dhe kjo është pjesërisht rezultat i zbatimit të modelit të SNRF 9 për humbjet e pritshme nga modeli SNK 39 për humbjet e shkaktuara i përdorur më herët. Shuma e përgjithshme e rezervave për humbjet e pritshme ndaj kredive joperformuese në dhjetor 2018 ishte 110 përqind (2017: 75 përqind).


Shuma totale e depozitave të klientëve arriti në 729.5 milionë euro në dhjetor 2018, një rënie kjo nga 735.8 milionë euro sa ishin në dhjetor 2017. Kjo paraqet rënie prej 0.9 përqind.

Gjenerimi vendor i financave gjithashtu ka kontribuar drejt një stabiliteti më të madh në sektorin bankar dhe ka ulur ndikimin e çfarëdo paqëndrueshmërie në tregjet ndërkombëtare.



Struktura e detyrimeve të bilancit të gjendjes

në milionë euro



Kontribuuesi më i madh në depozitat nga klientët ishin llogaritë rrjedhëse me pjesëmarrje prej 79 përqind. Pasi në llogaritë e kursimeve me pjesëmarrje prej 18.5 përqind të totalit të depozitave të klientëve të bankës. Depozitat e afatizuara nga klientët përbëjnë vetëm 2.6 përqind të bazës së depozitave totale. Rritja në bilancet e llogarisë rrjedhëse mund të shpjegohet gjithashtu me rënien e normave të interesit në treg për llogaritë e kursimeve dhe depozitat e afatizuara në vitet e fundit.


Struktura e detyrimeve të Bankës Raiffeisen në Kosovë ishte e dominuar nga depozitat e klientëve, dhe ky ishte edhe rasti me tregun e Kosovës.

Në vitin 2018, kapitali aksionar i Bankës Raiffeisen në Kosovë mbeti i pandryshuar në 63 milionë euro. Kapitali i përgjithshëm më 31 dhjetor 2018 ishte 127.7 milionë euro (2017: 125.3 milionë euro), përfshirë gjithashtu edhe 65 milionë euro në formë të fitimeve të mbajtura. Banka Raiffeisen në Kosovë ka paguar një dividendë aksionarëve të saj nga fitimet e saj të mbajtura në vitin 2018 në vlerë prej 17.5 milionë eurosh.

Kjo pagesë nuk është reflektuar në vlerën e kapitalit të përgjithshëm e as në kërkesat e kapitalit rregullator.


Struktura e ekuitetit

në milionë euro



Banka Raiffeisen në Kosovë vazhdon të jetë e mirëkapitalizuar e që është reflektuar edhe në raportet e vitit 2018 të kapitalit rregullator të Klasit 1 ndaj aseteve totale të peshuara ndaj rrezikut prej 15.9 përqind (kërkesa ligjore është 8 përqind) dhe një raport të kapitalit total (duke përfshirë edhe Klasin 2) ndaj aseteve të peshuara të rrezikut prej 18.5 përqind (kërkesa ligjore është 12 përqind). Në llogaritjen e kapitalit të Klasit 2, Banka ka përfshirë shumën prej 19 milionë euro të borxhit të varur me një maturimin fillestar prej dhjetë vjetësh zvogëluar për 20 përqind në përputhje me kërkesat rregullatore. Kërkesat e mësipërme të kapitalit janë llogaritur në përputhje me rregulloren e BQK-së mbi mjaftueshmërinë e kapitalit si dhe rregulloret dhe rregullat tjera rregullative të zbatueshme.

Zhvillimi dhe struktura e të ardhurave bruto



Të ardhurat neto pas tatimit në vitin 2018 ishin 20.5 milionë euro (2017: 17.6 milionë euro). Ky rezultat është llogaritur në bazë të pasqyrave financiare të SNRF-së të përfshira në raport. Banka Raiffeisen në Kosovë gjithashtu harton raporte financiare bazuar në SNRF që pasqyrojnë kërkesat shtesë nga rregulloret e Bankës Qendrore dhe këto raporte dërgohen tek Banka Qendrore dhe gjithashtu publikohen çdo tremujor në faqen e internetit të Bankës Raiffeisen në Kosovë e gjithashtu edhe në gazetat e përditshme vendore.

Të ardhurat e Bankës Raiffeisen në Kosovë dominohen fuqishëm nga të ardhurat e gjeneruara nga kreditë dhe paradhëniet për klientët lokalë. Të ardhurat nga interesi mbi kreditë dhe paradhëniet dhe letrat me vlerë vazhdojnë të jenë burimi kryesor i të ardhurave pavarësisht normave për kredi në rënie në treg, si dhe kthimeve (yield) shumë të ulëta dhe nganjëherë negative në bonot e lëshuara nga qeveritë e OBZHE-së. Kjo është kompensuar pjesërisht nga normat në rënie për depozitat bankare nga klientët.


Në vitin 2018, Banka gjeneroi më pak të ardhura nga jointeresi, të cilat pësuan ulje me 19 për qind krahasuar me 2017, ndonëse të ardhurat nga interesi u rritën me 15 për qind, kështu që ulja e të ardhurave nga jointeresi u kompensua dhe ndikimi i përgjithshëm në KP-të e Bankës ishte pozitiv në vitin 2018.

Që nga viti 2016, është vërejtur një efekt i dukshëm nga ndryshimet në mjedisin ligjor me licencimin e përmblyesve privatë. Banka ka arritur të ekzekutojë një numër të rasteve të pajzgjdhura me një ritëm shumë më të shpejtë se më parë. Kjo ka rezultuar në shitje më të shpejtë të asetëve të riposduara të Bankës. Si rezultat, Banka kishte të ardhura më të larta në pozicionin të ardhura të tjera si rezultat i shitjeve të asetëve të riposduara të mbajtura si inventar i bankës. Pozita të ardhura të tjera ka përfshirë gjithashtu të ardhura nga një kontratë që ka të bëjë me një numër të kufizuar të shërbimeve të TI-së të ofruara për një numër të ZQ-ve të RBI-së në Vjenë dhe për grupe të tjera të kompanive të konsoliduara të RBI-së.

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative më 31 dhjetor 2018 ishin 27.5 milionë euro (2017: 27.3 milionë euro). Raporti të ardhura/kosto ishte 51 për qind (2017: 53.2 për qind). Kjo tregon një përmirësim të vogël në efikasitet.

Kostot e personelit gjithashtu përfshijnë kostot e ndërlidhura me personelin, të tilla si për trajnim dhe zhvillim tjetër profesional. Këto kosto kanë vazhduar të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve operative sepse Banka Raiffeisen në Kosovë e konsideron shumë të rëndësishëm investimin në zhvillimin profesional të personelit.

Zhvillimi i shpenzimeve të përgjithshme administrative



Thesari, menaxhimi i pasurive dhe detyrimeve

Menaxhimi i pasurive dhe detyrimeve

Viti 2018 ishte vit i suksesshëm sa i përket mbledhjes dhe konsolidimit të depozitave, si dhe lëshimit të kredive. Banka Raiffeisen në Kosovë ka arritur të rrisë edhe më tej pozicionin e saj të depozitave kryesore, duke ulur bilancin e përgjithshëm të depozitave për 6 milionë euro krahasuar me vitin 2017. Në një masë më të madhe Banka ishte në gjendje të rriste pozicionin e saj me kredi. Duke u bazuar në rritjen e besimit në sistemin financiar, veçanërisht brendin e Bankës Raiffeisen në Kosovë, likuiditeti i bankës ka mbetur në nivel të qëndrueshëm, duke i ulur kështu kostot e financimit mbi baza nga viti në vit. Asetet e thesarit/menaxhimi i aseteve dhe detyrimeve kanë rënë nga 39 për qind të aseteve të Bankës në vitin 2017 në rreth 29 për qind në fund të vitit 2018. Asetet e Thesarit u zvogëluan për të financuar kreditë e klientëve.

Në vitin 2018, Banka ka shënuar një ulje në depozitat e klientëve prej rreth 6 milionë euro ndërkohë që në anën e aseteve të kredisë jobankare ka një rritje prej 61 milionë eurosh. Menaxhimi i kujdesshëm i aseteve dhe detyrimeve bëri të mundur që Banka ta mbajë koston më të ulët të fondeve të depozitave në treg, që nga ana tjetër mundësoi norma më të ulëta interesi të kredive. Në masë të madhe, ulja e shpenzimeve të interesit është arritur përmes modelimit sasior (kuantitativ) të menaxhimit të aseteve dhe detyrimeve, si dhe përmes një zvogëlimi gradual të kontratave të depozitave të afatizuara me norma historike të larta në llogari të kursimit dhe llogari rrjedhëse me kosto më të ulëta.

Financimi kryesor

Banka përdor modelimin sasior për të matur pandryshueshmërinë e depozitave të klientëve, për asetet dhe detyrimet e saja që nuk maturojnë, si për qëllime të rrezikut të normës së interesit, ashtu edhe për qëllime të rrezikut të likuiditetit, si për klientët retail ashtu edhe ata joretail. Burimet e financimit të Bankës ishin kryesisht nga depozitat e qëndrueshme të klientëve retail (depozitat e ekonomive familjare) në shumën prej 88 për qind të totalit të depozitave të Bankës, ku është vënë re një rritje prej rreth 47 milionë euro në depozitat jokorporatë në vitin 2018. Efekti i përbashkuar i një pozicioni të likuiditetit të lartë, dhe një pozicioni të pandryshueshmërisë së lartë kanë krijuar një pozitë të qëndrueshme të likuiditetit. Vlera e pikëve bazë të normave të interesit (BPV) në vitin 2018, ka treguar një pozitë të BPV në fundvit prej rreth 29,762. Marzha neto e interesit ka qëndruar stabile në vitin 2017 në rreth 4.15 për qind përkundër rritjes së likuiditetit dhe normave më të ulëta të interesit të kredisë.

Likuiditeti

Deri në fund të vitit 2018, Banka ka pasur një raport të financimit të qëndrueshëm neto (NSFR) mbi 140 për qind dhe LCR mbi 340 për qind. Likuiditeti i Bankës përbëhet nga mbajtja e investimeve në Obligacione, në Treg të Parave dhe në Bankë Qendrore.

Rreziku i normës së interesit në librin dhe strategjinë bankare

Banka ka bërë një reduktim të konsiderueshëm të kohëzgjatjes. Reduktimi i kohëzgjatjes në mbajtjet e obligacioneve ka zvogëluar transformimin e maturitetit të normave të interesit të bankave në obligacione, por ka rritur pak kohëzgjatjen duke shpërndarë likuiditetin e tepërt në kredi. Krahasuar me 2016 dhe 2017, në vitin 2018, Banka ka arritur të transformojë një pjesë të konsiderueshme të librit të saj të kredive nga kreditë me norma fikse në kredi me norma të ndryshueshme. Pasja e një pozite të drejtë dhe të kujdesshme të bilancit të gjendjes së normës së interesit është shumë e rëndësishme për menaxhimin dhe aksionarët e Bankës.

Në një kontekst më të gjerë: tabela e mëposhtme tregon ekspozimet e Fitimeve dhe Humbjeve sipas valutës për ndryshim prej 1 pike bazë në lakore.

Ekspozimi: Ndikimi i Fitimeve dhe Humbjeve për çdo ndryshim prej 1 pike bazë në lakore BPV (Vlera e pikëve bazë)									
Valuta	Ekspozimi i vlerës së pikës bazë	<=1Y	1-2Y	2-3Y	3-5Y	5-7Y	7-10Y	10-15Y	<20Y
Gjithsej	29,762								
CHF	13	13							-
EUR	29,427	(6,832)	6,692	14,478	38,273	(14,923)	(8,160)	(84)	(17)
USD	321	(896)	(327)	514	1,030				-
(-) Grupimet (buckets) e gjata me norma fikse									


Letrat me vlerë FI të Qeverisë/Korporatës

Banka arriti të reduktojë zotërimet e saj të investimeve financiare në 2018 me gati 71 milionë euro në volumin prej 124 milionë euro në fund të vitit. Nga një total prej 124 milion euro investimesh financiare, rreth 78 për qind e portofolios janë investime cilësore në letrat me vlerë FI të Qeverisë/Korporatës dhe pjesa tjetër është e ndarë për ekspozimin në emetimet e borxhit të brendshëm të Qeverisë së Kosovës.

Vlerësimi Moody**	Përshkrimi	% e ndarjes së obligacioneve *	Kohëzgjatja e rregulluar
Aaa	Vlerësimi më i lartë	5.3%	1.2
Aaa	Vlerësimi më i lartë	3.9%	0.8
Aaa	Vlerësimi më i lartë	3.5%	1.2
Aaa	Vlerësimi më i lartë	7.1%	0.6
Aa1	Shkallë e lartë	12.1%	0.1
Aa3	Shkallë e lartë	11.3%	3.8
A2	Shkallë e mesme e lartë	6.5%	0.2
A3	Shkallë e mesme e lartë	11.7%	0.1
Baa1	Shkallë e mesme e ulët	11.3%	0.9
NR	Nuk ka vlerësim	5.7%	0.9
Të pavlerësuara Kosovë	Nuk ka vlerësim	21.6%	

(*)% e obligacioneve të mbajtura nga Raiffeisen Bank në Kosovë në librin e vet të obligacioneve(**) të renditura sipas tabelës së vlerësimit të Moody-t

Paralelisht, tregu i përgjithshëm për bonot e thesarit të Kosovës ka vazhduar me ritmin e njëjtë. Në rolin e tyre si tregtar/dealer primar, Banka dhe klientët e saj vazhduan të përcaktojnë krijimin e Tregut Sekondar të Borxhit të Qeverisë në Kosovë, megjithëse me një ritëm më të ngadaltë për shkak të rënies së atraktivitetit të tij, duke marrë parasysh normat më të ulëta të kthimit të arritura. Në vitin 2018, normat e interesit të ankandit për bonot/obligacionet e Kosovës janë përmirësuar ndjeshëm krahasuar me ankandet e vitit 2017. Kjo ka ndihmuar Bankën të përmirësojë kthimin e saj në likuiditet. Tabela më poshtë tregon informatat e fundit të ankandit për secilin vit përkatës.



Derivatvët financiarë lidhur me librin bankar

Portofolio e kundërkëmbimeve (SWAP) të normave të interesit të Bankës është një mjet i rëndësishëm i menaxhimit të rrezikut për portofolion e saj afatgjatë. Kundërkëmbimet e normave të interesit përdoren për të ulur rreziqet nga lëvizjet e normave të interesit në drejtime jo të favorshme. Banka nuk ka hyrë në ndonjë kontratë të re për kundërkëmbime të normave të interesit në vitin 2018. Në vend që të hyjë në marrëveshje derivative të IRS, Banka ka shfrytëzuar mundësinë që të vazhdojë të konvertojë një pjesë të normave të librit të saj kreditor në kredi me normë të ndryshueshme dhe gjithashtu të mbajë në kontroll kohëzgjatjen e pozicionit të saj të obligacioneve.

Banka pret që normat e tregut së shpejti do ta kenë arritur nivelin e tyre më të ulët dhe një kthim drejt normave më të larta të interesit do të ndodhë në normat afatmesme deri tek ato afatgjata, të cilat kombinuar me normat e ulëta historike afatshkurta, do të përcaktojnë një kurbë kthimi më të pjerrët.

Segmentet e biznesit

Klientët korporatë

Zhvillimi dhe mirëmbajtja e marrëdhënieve afatgjata me klientët e korporatës është qëllimi kryesor i strategjisë së Bankës dhe viti 2018 ka rezultuar suksesshëm në këtë drejtim. Objektivat kryesore të departamentit të korporatës ishin ruajtja e pozitës së udhëheqësit në treg në Kosovë duke mbështetur më tej rritjen e klientëve aktual dhe përvetësimin e klientëve të rinj. Kombinimi i forcës financiare, bazës së lartë të kapitalit dhe njohurive të thella dhe ekspertizës së menaxherëve të marrëdhënieve dhe produktit të korporatave ka vendosur Raiffeisen Bank në Kosovë në një pozitë të veçantë në krahasim me kolegët e saj.

Të qenit pjesë e Raiffeisen Bank International (RBI) dhe të pasurit e një modeli të fuqishëm të biznesit lokal dhe një game të gjerë të produkteve, i ka mundësuar Bankës blerjen e disa kompanive të reja ndërkombëtare që filluan të operojnë në Kosovë në vitin 2018, duke ofruar një shërbim bankar standard të plotë ndërkombëtar.

Në vitin 2018, biznesi i korporatës ka regjistruar rritje të mëtejshme në portofolin e tij të kreditimit në vlerë prej 222 milion € ose 8 për qind më shumë në krahasim me vitin paraprak, me përmirësimin e cilësisë së asetëve që rezultojnë në kredi jo-performuese që përbëjnë vetëm 4.26 për qind të portofolit të kredisë, dhe me rënie prej 52 për qind në krahasim me vitin paraprak. Portofoli i kreditimit i kolateralizuar mirë rezultoi në Kthim të qëndrueshëm në Kapitalin e Korrigjuar për Rrezikun (RoRAC) prej 182 për qind dhe fitimi neto pas tatimit u rrit me 41 për qind në 8.3 milion € nga viti në vit (2017: 6.1 milion €).

Gjatë vitit 2018, vëmendje e veçantë i është kushtuar sigurimit të përputhshmërisë së plotë me kërkesat e shtuara rregulatore qoftë atyre vendore, ndërkombëtare dhe kërkesave grupore siç janë Basel III, FATCA, KYC, etj.

Ndërmarrjet e vogla

Në vitin 2018, Banka ka vazhduar të kultivojë marrëdhëniet me ndërmarrjet e vogla përmes menaxherëve të marrëdhënieve me përvojë, të vendosur në katër rajonet kryesore të Kosovës, mbështetur nga zyra qendrore dhe ekspertiza e menaxherëve të produkteve. Ky koncept ka rezultuar në arritjen e rezultateve edhe më të mira se ato të planifikuara në aspektin e profitabilitetit, vëllimit të asetëve dhe cilësisë së portofolit. Oferta e produkteve të Bankës është e përshtatur gjithmonë ndaj kërkesave të klientëve dhe nivelit të zhvillimit të biznesit.

Në vitin 2018, portofoli i kreditimit të NV-ve ka mbajtur një rritje stabile duke arritur vlerën prej 70.7 milion euro. Orecksi për investime që kërkojnë financim afatgjatë ka vazhduar të jetë modest në krahasim me nevojat e kapitalit qarkullues në mesin e klientëve të NV-ve. Një portofol i kreditimit i kolateralizuar mirë ka rezultuar në nivel të lartë të kthimit në kapitalin e korrigjuar për rrezikun (RoRAC) prej 92 për qind, një rezultat të konsiderueshëm përfundimtar prej 1.5 milion € ose plus 10 për qind në krahasim me vitin e kaluar. Ka pasur përmirësim thelbësor të cilësisë së portofolit me normën e kredive jo-performuese prej 7.5 për qind, një rënie për 10 për qind nga viti i kaluar.

Për të mbështetur proceset e brendshme, gjatë vitit janë ndërmarrë një sërë iniciativash për efikasitetin e procesit, kryesisht në thjeshtësimin e proceseve duke i bërë më të pakta ose të përshtatshme me madhësinë dhe kompleksitetin e aplikacioneve.

Ndërmarrjet mikro

Banka Raiffeisen në Kosovë vazhdoi të ofrojë një gamë të gjerë të produkteve dhe shërbimeve bankare, standarde dhe të përshtatura për ndërmarrjet mikro. Në vitin 2018, ka ofruar produkte dhe shërbime bankare për më shumë se 13,000 klientë.

Gjatë vitit 2018, Banka filloi proceset që lehtësuan kriteret e financimit për klientët. Kjo i mundësoi Bankës të përbushë kërkesat e financimit të klientëve duke ofruar dhe krijuar një qasje më të mirë dhe me çmime atraktive për më shumë konsumatorë. Kjo përfshinte fushata të veçanta me çmime preferenciale, të cilat rezultuan në një numër të madh aplikimesh nga klientët e rinj dhe ekzistues dhe ndikimi pritet të reflektojë pozitivisht performancën e Bankës dhe klientëve në vitet në vijim - duke ndihmuar ata të rrisin qarkullimin e tyre dhe të rrisin numrin e punonjësve.

Në vitin 2018, është rritur edhe më shumë bashkëpunimi me Qeverinë e Kosovës në lidhje me bazën e klientëve të agrobiznesit. Aktiviteti i ofrimit të granteve për klientët e agrobiznesit ka vazhduar të jetë fokusi i politikave të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Një zbatim dhe përdorim i suksesshëm i fondeve të palës së tretë në formën e garancive, të tilla si shfrytëzimi i kufirit prej 90 përqind të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, hapi rrugën për hapjen e negociatave me ofruesit e tjerë ndërkombëtar të skemës së ndarjes së rrezikut.

Rreth 70 përqind e transfereve të procesuara nëpërmjet bankimit në internetit dhe mobil, 90 përqind e transaksioneve në para të gatshme në ATM dhe 33 përqind rritje nga viti në vit në pagesat me kartela në terminalët POS janë tregues të zhvendosjes së vazhdueshme të preferencave të klientëve drejt kanaleve elektronike. Ky ndryshim pozitiv i mentalitetit të bazës së klientëve u bë i mundur nëpërmjet fushatave të ndryshme të vetëdijesimit dhe është një tregues pozitiv se po favorizohet sektori formal i ekonomisë, gjë nga e cila do të përfitojnë edhe klientët dhe Banka duke mundësuar rritjen e ekspozimit ndaj klientit bazuar në rritjen e qarkullimit.

Shërbimet bankare për individët dhe ato premium

Viti 2018 ishte një vit shumë i suksesshëm për segmentin e Individëve dhe Klientëve Premium dhe kjo ishte kryesisht si rezultat i fushatave kreative dhe konkurruese që u janë prezantuar tregut, të cilat adresojnë nevojat dhe kërkesat e klientëve. Kështu, Banka ka vazhduar të ruajë pozitën e saj udhëheqëse në këtë segment të sektorit bankar, me një pjesëmarrje në treg prej 26 përqind. Gjatë vitit 2018, Banka ka ofruar shërbime bankare për më shumë se 240,000 individë dhe 10,000 klientë premium.

Gjatë vitit 2018, fushatat e marketingut ishin kryesisht të fokusuar në kredi: të dyja, kredi të siguruara dhe jo të siguruara - si dhe mbitërheqje. Këto fushata i mundësuan Bankës që të ketë një rritje të konsiderueshme në portofolin e kredive për individët dhe klientët premium me rreth 17 përqind në krahasim me vitin e kaluar. Përveç kësaj, Banka ka shënuar një rritje të konsiderueshme në portofolin e kredive hipotekare me rreth 23 përqind. Në të njëjtën kohë, Banka gjithashtu ka rritur edhe portofolin e kartelave të kreditit, si në vëllim ashtu edhe në njësitë e reja. Këto rezultate janë arritur si rrjedhojë e ofertave preferenciale për klientët që kanë kredit kartela pas fushatave negociuese me tregtarë të ndryshëm. Në vitin 2018, ka pasur edhe fushata tjera më të vogla tërheqëse të marketingut, ku kemi përdorur qasjen e Ekonomisë së Sjelljes, si një mënyrë e re e komunikimit dhe qasjes ndaj klientëve.

Viti 2018 ishte veçanërisht i suksesshëm për shërbimet bankare premium, që është shërbim bankar unik që Banka u ofron klientëve, të cilët përzgjidhen në bazë të kriterëve të caktuar. Asetet e përgjithshme të shërbimit bankar premium u rritën për 27 përqind, ndërsa numri i klientëve u rrit për 20 përqind.

Përveç produkteve të kredisë, Banka vazhdoi të përqendrohet në ofrimin e zgjidhjeve profitabile për kursime me anë të krijimit të një qasjeje holistike këshilluese për klientët premium. Gjithashtu ka vazhduar të ofrojë mundësinë për klientët premium që të tregtojnë bonot e thesarit për maksimizimin e kursimeve të tyre. Përveç kësaj, me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të shërbimeve për klientët premium, Banka ka rritur numrin e menaxherëve të marrëdhënies me klientët premium në të gjitha degët në Kosovë, gjë që kontribuoi në rezultate më të mira financiare në këtë segment.

Një tjetër iniciativë e zbatuar në segmentin e shërbimeve bankare për individë privat dhe atyre premium në vitin 2018 ishte zhvillimi i qasjes digjitale, që është dizajnuar dhe zhvilluar kryesisht për klientët nga Diaspora por do të jetë në dispozicion edhe për të tjerët në Kosovë, duke u ofruar kështu klientëve një mënyrë të re të bankimit.

Produktet dhe shërbimet bankare

NV dhe korporatat

Banka Raiffeisen në Kosovë vazhdon të jetë banka e vetme në Kosovë që ofron financim të projekteve, gjë që i mundësoi asaj të mbështesë kërkesat jo standarde të klientëve, duke zhvilluar zgjidhje të përshtatura për të plotësuar kërkesat e tyre. Vlen të theksohet rasti i financimit të projektit për zgjerimin e qendrës më të madhe tregtare në Kosovë.

Banka ka vazhduar të mbajë pozitën udhëheqëse në financimin tregtar në krahasim me simotrat e saj. Me ekspertizë të gjerë dhe duke qenë pjesë e një grupi të madh bankar që ka krijuar një rrjet bankash në të gjithë botën, kjo ka lehtësuar pranimin e instrumenteve të sigurimit si garancitë dhe letërkreditë. Si rezultat, portofoli i financimit tregtar gjatë vitit 2018 ka shënuar një rritje të jashtëzakonshme prej 79 përqind në krahasim me vitin e kaluar.

Banka Raiffeisen në Kosovë posedon një portofol të gjerë të teknologjisë më të avancuar, me qëllim që të përmbushë pritjet e klientëve duke ofruar komoditet, shpejtësi, transparencë dhe produkte tejet inovative. Një shërbim i veçantë në treg është pagesa me SMS për pagesat doganore. Klientët mund të bëjnë pagesa doganore me një shpejtësi prej më pas se 10 sekonda, nga kudo në vend, vetëm me anë të një telefoni celular. Një zgjidhje e tillë u ka mundësuar klientëve të korporatave të kanalizojnë 74 përqind të të gjitha pagesave doganore përmes SMS-ve.

Në vitin 2018, Banka Raiffeisen në Kosovë vazhdoi të mbetet e vetmja bankë që ofron faktoring. Portofoli tregoi një rritje të jashtëzakonshme prej 152 përqind, edhe pse nga një bazë relativisht e ulët. Faktoringu vazhdoi të plotësojë gamën e produkteve të financimit të kapitalit qarkullues për klientët e korporatave dhe të ndërmarrjeve të vogla.

Në përputhje me ritmin e shpejtë të zhvillimit teknologjik, Banka vazhdoi të ndjekë konceptin e saj digjital, për të përmbushur pritshmëritë e klientëve duke siguruar komoditet, shpejtësi dhe transparencë. Në këtë drejtim, u themelua një Qendër Agile e Ekselencës e Korporatës, me mision për të ofruar produkte superiore të TI-së dhe zhvillime të zgjidhjeve për klientët e NV-ve dhe të korporatave me një koncept plotësisht agjil si dhe për të ndihmuar bankimin e korporatave të bëhet një organizatë adaptive.

Shërbimet retail

Zhvillimet e tregut dhe kërkesat e konsumatorëve janë më shumë se kurrë të fokusuar në kanalet elektronike dhe si rezultat, rritja e kapaciteteve në kanalet elektronike mbetet prioritet i lartë i Bankës.

Në vazhdimësi me rritjen e Bankës sa i përket përdorimit të kanaleve elektronike, gjatë vitit 2018, është rritur si bankimi i ATM ashtu edhe ai në internet për 89 përqind krahasuar me 84 përqind në vitin 2017. Rritja e përqindjes është një krahasim i transaksioneve ndërmjet bankimit të bankomatëve (ATM) dhe atij në internet /mobil kundrejt atij në degë (para të gatshme dhe transfert). Përqindja e përdorimit është rezultat i rritjes prej 29 përqind në numrin e transaksioneve bankare përmes internetit/mobilit (289 mijë transaksione në vitin 2018 krahasuar me 223 mijë transaksione në vitin 2017) dhe rritjes prej 20 përqind në transaksionet përmes bankomatëve (3.9 milionë transaksione në vitin 2018 kundrejt 3.2 milionë transaksione në vitin 2017).

Për më tepër, si shkak i zhvillimit të fushatave të ndryshme të vetëdijesimit dhe stimujve të ndryshëm, transaksionet e depozitimit të parave të gatshme në bankomatë janë rritur për 137 përqind në vitin 2018, prej 178 mijë në vitin 2017 në 421 mijë në vitin 2018.

Gjithashtu, biznesi i kartelave ka mbetur një prioritet i lartë dhe ka vazhduar të mbështetet me qasje inovative, si në marrjen e kartelave ashtu edhe në lëshimin e kartelave. Pasi që ishte vendosur infrastruktura POS dhe ishte kryer një valë fillestare e vetëdijesimit me klientët dhe partnerët tregtarë, përdorimi i pagesave pa kontakt pati një efekt pozitiv në treg. Si rezultat i kësaj, numri i transaksioneve POS është rritur për 38 përqind, prej 1.2 milionë në vitin 2017 në 1.7 milion në vitin 2018 ku dhe vëllimi i transaksioneve në POS është rritur për 21 përqind prej 44 milionë në vitin 2017 në 53 milionë në vitin 2018.

Numri i transaksioneve pa kontakt gjithashtu kishte një rritje të konsiderueshme. Përkundër asaj se kjo ishte një risi për mbajtësit e kartelave dhe tregtarët, Banka ka arritur të procesojë me sukses 186 mijë transaksione pa kontakt në vitin 2018, krahasuar me 8 mijë transaksione pa kontakt në vitin 2017.

Banka Raiffeisen vazhdimisht ndërmerr iniciativa të ndryshme për të rritur shitjet e iniciuara në mënyrë digjitale, të cilat përfshijnë shitjen e kredive personale dhe kartelave të kreditit përmes faqes së kredidhënies. Kështu, shitjet e iniciuara në mënyrë digjitale u rritën konsiderueshëm për 503 përqind në vitin 2018 krahasuar me të njëjtën periudhë në vitin 2017. Në vëllim të përgjithshëm, shitjet në internet ishin 740 mijë në vitin 2018 krahasuar me 22 mijë në vitin 2017.

Shërbimi E-Commerce (E-tregtia) i certifikuar me pagesën e sigurt me Visa dhe MasterCard ofruar nga Banka Raiffeisen në Kosovë, po e rritë vazhdimisht bazën e tregtarëve. Numri i tregtarëve të regjistruar në shërbimin e-Commerce pothuajse është dyfishuar deri në fund të vitit 2018 krahasuar me vitin 2017 (nga 9 tregtarë në 17 tregtarë), numri i transaksioneve të procesuara është rritur për 126 përqind, nga 1,043 në 2,358 dhe vëllimi i transaksioneve është rritur për 106 përqind për të njëjtën periudhë. Kështu, Banka vazhdoi të mbështesë ndryshimet e vazhdueshme dhe mënyrat komode të pagesave në tregun e Kosovës.

Kanalet e distribuimit

Rrjeti i degëve

Duke qenë fizikisht e pranishme në të gjitha rajonet e Kosovës me 46 degë dhe nën-degë, Raiffesen Bank në Kosovë përfaqëson rrjetin më të madh të degëve në treg. Në vitin 2018, numri i bankomatëve u rrit për 8 përqind, prej 108 bankomatë në vitin 2017 në 117 bankomatë në 2018, ndërsa numri i POS për 17 për qind, prej 2,180 POS në vitin 2017 në 2,547 POS në vitin 2018.

Një Program i Transformimit të Degëve ishte ndryshimi kryesor që shënjoj rrjetin e degëve gjatë vitit 2018. Qëllimi i programit ishte optimizimi i rrjetit të degëve përmes konsolidimit të mjediseve të degëve në mjedise më efikase me më shumë efektivitet në kosto, duke synuar gjetjen e mundësive për rritjen e të ardhurave duke rritur personelin e shitjes përmes stafit shumëdetyrësh. Degët e modelit të ri ofrojnë një zonë të vetë-shërbimit në të cilën klienti mund të përdorë shërbimet bankare në internet 24/7, por gjithashtu edhe një hapësirë komode për klientët që të takohen dhe diskutojnë planet e tyre financiare me zyrtarët e degëve.

Si pjesë e Programit të Transformimit të Degëve, gjatë vitit 2018, Banka rimodeloi 11 nën-degë duke shtuar zona të vetë-shërbimit. Kjo rezultoi në një rritje të numrit të përgjithshëm të zonave të vetë-shërbimit në 20 sosh. Në mënyrë që shërbimet e parasë së gatshme të bëhen më të lehta dhe më të përshtatshme për klientët, funksioni i deponimit/cash-in i është shtuar bankomatëve të të gjitha degëve të bankës Raiffeisen në Kosovë. Programi i Transformimit të Degëve ka për qëllim të rimodelojë dhe optimizojë të gjithë rrjetin e degëve deri në vitin 2021.

Përveç kësaj, Banka përdor edhe Rrjetin e Agjentëve të Shitjeve Direkte si një kanal shumë efektiv në ofrimin dhe shitjen e produkteve bankare. Këta agjentë shitjesh ofrojnë shërbime konsultuese për klientët në çdo rajon të vendit përmes takimeve sy më sy. Gjatë vitit 2018, agjentët e shitjes së Bankës arritën të takohen me rreth 20,000 klientë dhe të ofronin këshilla financiare dhe zgjedhje produkti.

Qendra kontaktuese

Qendra kontaktuese e Bankës është qendra kryesore e mbështetjes për klientët ekzistues dhe ata potencialë në komunikimin e përditshëm me Bankën. I ka dy linja kryesore të aktivitetit, duke trajtuar kërkesat dhe ofruar mbështetje klientëve 24/7 përmes ekipit të dedikuar për thirrjet hyrëse, si dhe zhvillimit të telemarketingut, shitjeve direkte dhe fushatave të ndryshme të edukimit të klienteve përmes një ekipi të thirrjeve dalëse.

Qendra kontaktuese shërben si qendër e rëndësishme mbështetëse që trajton një sërë pyetjesh dhe konsultash me klientë lidhur me produktet bankare nëpërmjet kanaleve të ndryshme të komunikimit - telefon, e-mail, biseda (chat), Facebook, desku i informimit dhe një qendër komunikimi përmes bankimit në internet. Gjatë vitit 2018, Banka krijoi një ekip të dedikuar të shitjeve që është përgjegjës për komunikimin e ofertave më të mira për klientët.

Një rol tjetër i rëndësishëm i Qendrës kontaktuese është edhe monitorimi i aktiviteteve për shërbimet e produkteve të kartelave dhe shërbimeve bankare elektronike për të siguruar parandalimin e mashtrimeve.

Përvoja e klientëve

Grumbullimi i njohurive jetike të klientëve në një mjedis shumëkanalësh ishte një nga aktivitetet kryesore në agjendën e përvojës së klientit në vitin 2018. Nevoja për të ofruar përvojë të kënaqshme për klientin, mbetet një prioritet për Bankën Raiffeisen në Kosovë. Banka vazhdimisht investon në zgjerimin e kanaleve të informatave kthyesë të klientëve duke implementuar produkte dhe zgjidhje inovative.

Si pjesë e programit Elevator Lab, një program i përshpejtimit Fintech i themeluar nga Raiffeisen Bank International AG në Austri (RBI), Banka Raiffesien në Kosovë ishte nikoqire e një Shqyrtimi të qëndrueshmërisë së Konceptit (provës së konceptit-proof of concept) me një kompani që ofron zgjidhje të Përvojës së Klientit. Kjo platformë mundëson grumbullimin e njohurive të klientëve dhe vlerësimin e përvojave si në kanalet fizike ashtu edhe digjitale. Kjo i mundëson Bankës të ftojë klientët të ofrojnë informata kthyesë dhe të vlerësojnë përvojat e tyre menjëherë pas ndërveprimeve dhe përvojave të tyre në degë, uebfaqe, Facebook, bankomatë, Qendra kontaktuese dhe faqet e kredihënies së produkteve. Duke grumbulluar perceptimet e klientëve pas blerjes së produktit, Banka ka matur edhe një rezultat (poena) të përpjekjeve të klientëve që bën të mundur ndërmarrjen e veprimeve në përmirësimin e proceseve kryesore për produktet kryesore.

Gjatë vitit 2018, Banka u përqendrua edhe në fushatat vetëdijesuese për të kontribuar në edukimin e klientëve për përdorimin e bankimit vetë-shërbyes. Qëllimi i aktiviteteve të tilla është për të ndihmuar klientët që ta kenë më të lehtë dhe më të përshtatshëm bankimin e përditshëm.

Menaxhimi i rrezikut

Menaxhimi aktiv i rrezikut është një kompetencë thelbësore e Bankës Raiffeisen në Kosovë. Në mënyrë që rreziku të identifikohet, matet dhe menaxhohet në mënyrë efektive, Banka vazhdon të zhvillojë sistemin e saj gjithëpërfshirës të menaxhimit të rrezikut. Menaxhimi i rrezikut është një pjesë integrale e menaxhimit të përgjithshëm të bankës. Në mënyrë të veçantë, përveç kërkesave ligjore dhe rregullative, Banka merr parasysh natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e aktiviteteve të saj të biznesit dhe rreziqet që rezultojnë.


Banka ka një sistem të parimeve dhe procedurave të rrezikut për matjen dhe monitorimin e rrezikut, që synon kontrollin dhe menaxhimin e rreziqeve materiale. Rreziku kreditor, rreziku i tregut, rreziku i likuiditeti dhe rreziqet operacionale maten, kufizohen, agregohen dhe krahasohen me kapitalin në dispozicion për mbulimin e rrezikut.

Menaxhimi i portofolios kreditore

Menaxhimi i portofolios kreditore në Bankë, ndër të tjerash, është i bazuar në strategjinë e portofolios kreditore, e cila në anën tjetër bazohet në strategjinë e biznesit dhe të rrezikut. Me anë të strategjisë së përzgjedhur, shuma e ekspozimit në industritë ose llojet e produktit kufizohet dhe kështu parandalohen përqendrimit e padëshiruara të rrezikut.

Grafiku i mëposhtëm tregon ekspozimin kreditor të Bankës në fund të periudhës raportuese dhe dy periudhat paraprake. Totali i ekspozimit ndaj rrezikut kreditor ishte 902 milion euro më 31 dhjetor 2018, që është një rënie për 3.3 përqind në krahasim me fundin e vitit 2017, përkatësisht një rënie për 2.2 përqind krahasuar me fundin e vitit 2016. Rënia rezulton kryesisht nga zvogëlimi i ekspozimit ndaj Bankës & Sovranëve.

Ky portofol është diversifikuar ndërmjet segmenteve të klientëve të biznesit dhe klientëve individualë dhe përfshin ekspozimet në dhe jashtë bilancit të gjendjes, para aplikimit të provizioneve të zhvlerësimit (rënies në vlerë) dhe faktorëve të konvertimit të kredive dhe kështu përfaqësojnë totalin e ekspozimit kreditor.



Menaxhimi i kredive jo-performuese

Viti 2018 ishte veçanërisht një vit shumë i suksesshëm për rimëkëmbjen dhe reduktimin e portofolit të papaguar/me vonesa. Banka është angazhuar në mënyrë aktive në parandalimin, që rezultoi me një fluks hyrës të ulët të llogarive të papaguara/me vonesa gjatë gjithë vitit. Raporti i kredive jo-performuese është zvogëluar në krahasim me fundvitin 2017 nga 5.2 përqind në 3.2 përqind në vitin 2018. Gjatë të njëjtës periudhë, raporti i mbulimit u rrit nga 75.1 përqind në 111.2 përqind.

Rreziku i likuiditetit

Mjaftueshmëria e likuiditetit sigurohet si nga perspektiva ekonomike ashtu edhe ajo rregullative. Për t'iu qasur perspektivës ekonomike, banka krijoi një kornizë qeverisëse që përfshin limitet e brendshëm dhe masat drejtuese.

Komponenti rregullativ adresohet me anë të përputhshmërisë me kërkesat e raportimit sipas Bankës Qendrore të Kosovës (Raporti Rregullativ i Likuiditetit). Krahas kërkesave rregullative vendore, Banka respekton edhe kërkesat për raportim Basel III (Raporti i Mbulueshmërisë së Likuiditetit dhe Raporti neto i financimit stabil).

Raportet dhe koeficientët e likuiditetit rregullativ dhe të brendshëm gjenerohen në bazë të supozimeve të veçanta të modelimit. Përderisa raportet rregullative llogariten mbi specifikimet e dhëna nga autoritetet, raportet e brendshme modelohen me supozimet nga vëzhgimet empirike.

Themelet e kornizës së rrezikut ekonomik të likuiditetit janë skenarët e Vijmësisë së biznesit (going concern-GC) dhe i periudhës së mbijetesës (Time to Wall-TTW). Raporti i Vijmësisë paraqet pozicionin strukturor të likuiditetit. Përfshinë të gjithë shtytësit kryesorë të rrezikut, të cilët mund të ndikojnë negativisht në grup në një skenar të biznesit të zakonshëm. Nga ana tjetër, raporti i periudhës së mbijetesës (periudha e disponueshmërisë së likuiditetit) paraqet horizontin e mbijetesës për skenarët e përcaktuar negativ dhe modelet e stresit (tregu, kriza reputacionale dhe e kombinuar), si dhe përcakton nivelin minimal të rezervës së likuiditetit (dhe/ose kapacitetit kundërbalancues) të bankës.

Skenarët e likuiditetit janë modeluar duke përdorur një qasje në nivel të mbarë Grupit, duke pasur parasysh specifikat lokale kur ato arsyetohen nga faktorë ndikues si mjedisi i tregut ose karakteristikat e biznesit të veçantë.

Monitorimi i limiteve dhe përputhshmëria e limiteve të raportimit kryhet në mënyrë efektive dhe kanalet përkatëse të përshkallëzimit përdoren dhe funksionojnë ashtu siç janë projektuar.

Pozicioni i likuiditetit të Bankës ka vazhduar të mbetet stabil dhe ka zbuluar një rezervë të theksuar të likuiditetit gjatë vitit 2018.

Raporti rregullativ i likuiditetit i Bankës Qendrore të Kosovës

	2018	2017	Kërkesa minimale
Të gjitha valutat	35.0%	39.6%	25.0%
Valuta euro	27.0%	31.9%	20.0%

Rreziku i tregut

Banka e definon rrezikun e tregut si rreziku i humbjeve të mundshme që rrjedhin nga ndryshimet në çmimet e tregut të pozicioneve të investimeve dhe të tregtimit. Vlerësimet e rrezikut të tregut bazohen në ndryshimet në normat e interesit, kurset e këmbimit dhe diferencat (spread) e kreditit (diferenca në kthimet e bonove).

Sistemi i limiteve

Vlerat e mëposhtme maten dhe limitohen në baza ditore në sistemin e menaxhimit të rrezikut të tregut:

- *Vlera-në-rrezik (niveli i konfidencës 99 përqind, horizonti i rrezikut një ditë)*

Vlera-në-rrezik (VaR) është instrumenti kryesor drejtues në tregjet likuide dhe situatat normale të tregut. VaR matet bazuar në një qasje simulimi hibrid, ku kalkuloheh 5,000 skenarë. Qasja kombinon përparësitë e një simulimi historik dhe simulimit Monte-Carlo dhe përfton parametrat e tregut nga të dhënat historike prej 500 ditësh. Supozimet e shpërndarjes përfshijnë tipare moderne si shpërndarja e paqëndrueshmërisë (volatilitetit) dhe ndryshimi rastësor i kohës. Kjo ndihmon në riprodhimin e distribuimeve asimetrike në mënyrë të saktë. Rezultatet e vlerës-në-rrezik nuk përdoren vetëm për limitimin e rrezikut, por edhe për ndarjen ekonomike të kapitalit.

- *Ndjeshmëritë (ndaj ndryshimeve në normat e kursit valutor dhe normat e interesit)*

Limitet e ndjeshmërisë sigurojnë që përqendrimet të shmangen në situata normale të tregut dhe janë instrumenti kryesor drejtues në situata ekstreme të tregut dhe në tregjet jolikuide ose në tregje që janë strukturalisht vështirë të maten.

- *Ndalimi i humbjeve*

Ky limit forcon disiplinën e tregtuesve ashtu që ata nuk lejojnë të grumbullohen humbjet në pozicionet e tyre të pronarit por në vend të kësaj i kufizojnë rreptësisht ato.

Një koncept gjithëpërfshirës për testimin e stresit plotëson këtë sistem të limiteve shumë-nivelëshe. Simulon ndryshimet e mundshme të vlerës aktuale të skenarëve të përcaktuar për portofolin total.

Rreziku operacional

Rreziku operacional përkufizohet si rreziku i humbjeve që rezultojnë nga proceset e brendshme jo adekuate ose jo funksionale, nga njerëzit dhe sistemet, ose nga ngjarje të jashtme, duke e përfshirë edhe rrezikun ligjor. Në këtë kategori të rrezikut menaxhohen shtytësit e brendshëm të rrezikut si aktivitetet e paautorizuara, mashtrimi ose vjedhja, humbjet e lidhura me sjelljen, gabimet e modelimit, të ekzekutimit dhe procesit, apo ndërprerja e punës dhe dështimet e sistemit. Faktorët e jashtëm si dëmtimi i asetëve fizike apo mashtrimi menaxhohen dhe kontrollohen gjithashtu.

Kjo kategori e rrezikut analizohet dhe menaxhohet në bazë të të dhënave vetanake historike të humbjeve dhe rezultateve të vetë-vlerësimit. Një tjetër mjet i menaxhimit është sistemi i stimulimeve i zbatuar në ndarjen e brendshme të kapitalit. Ky sistem shpërblen cilësinë e lartë të të dhënave dhe menaxhimin aktiv të rrezikut.

Si me llojet e tjera të rrezikut, parimi i vendosjes së mureve ndarëse ndërmjet menaxhimit të rrezikut dhe kontrollit të rrezikut është zbatuar edhe për rrezikun operacional. Për këtë qëllim, përcaktohen individët dhe trajnohen si menaxherë të rrezikut operacional për çdo fushë biznesi. Menaxherët e rrezikut operacional sigurojnë kontrollin qendror të rrezikut operacional me raporte mbi vlerësimet e rrezikut, ngjarjet e humbjes, treguesit dhe masat. Ata në punën e tyre mbështeten nga Specialistët e Dedikuar të Rrezikut Operacional (DORS).

Njësia e kontrollit të rrezikut operacional është përgjegjëse për raportimin, zbatimin e kornizës, zhvillimin e masave të kontrollit dhe monitorimin e përputhshmërisë me kërkesat. Brenda kornizës të ciklit vjetor të menaxhimit të rrezikut, ata koordinojnë edhe pjesëmarrjen e departamenteve përkatëse të linjës së dytë mbrojtëse dhe të të gjithë partnerëve të linjës së parë të mbrojtjes (menaxherët e rrezikut operacional).

Identifikimi i rrezikut

Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve që mund të rrezikojnë ekzistencën e bankës (por që ka shumë pak gjasa të ndodhin) si dhe i fushave ku humbjet ka shumë gjasa të ndodhin më shpesh (por kanë vetëm ndikim të kufizuar) janë aspekte të rëndësishme të menaxhimit të rrezikut operacional.

Vlerësimi i rrezikut operacional kryhet në mënyrë të strukturuar sipas kategorive të rrezikut siç janë llojet e proceseve të biznesit dhe aktiviteteve. Për më tepër, vlerësimi i rrezikut zbatohet edhe për produkte të reja. Banka e vlerëson ndikimin e ngjarjeve me probabilitet të lartë/ndikim të ulët dhe incidenteve me probabilitet të ulët/ndikim të lartë, sipas vlerësimit të saj të potencialit të humbjes për vitin e ardhshëm dhe në dhjetë vitet e ardhshme. Ngjarjet me probabilitet të ulët / ndikim të lartë kuantifikohen nga një mjet analitik me skenarë të veçantë. Profili i rrezikut të brendshëm, rezultimi i humbjeve dhe ndryshimet e jashtme përcaktojnë se cilat raste trajtohen detajisht.

Monitorimi

Për të monitoruar rreziqet operationale, përdoren treguesit e paralajmërimit të hershëm, që mundësojnë identifikimin e shpejtë dhe minimizimin e rreziqeve.

Të dhënat e humbjes mblidhen në një bazë qendore të dhënash të quajtur ORCA (Aplikacioni i kontrollit të rrezikut operacional) në një mënyrë të strukturuar sipas llojit të ngjarjes dhe linjës së biznesit. Përveç kërkesave për raportim të brendshëm dhe të jashtëm, informacionet mbi ngjarjet e humbjeve shkëmbehen me grupe të të dhënave ndërkombëtare për të zhvilluar më tej mjete të avancuara të menaxhimit të rrezikut operacional, si dhe për të përcjellë më tej masat dhe efikasitetin e kontrollit. Rezultatet e analizave, si dhe ndodhitë që rezultojnë nga rreziqet operationale raportohen rregullisht në mënyrë gjithëpërfshirëse në Komitetin e Menaxhimit të Rrezikut Operacional.

Të dhënat e humbjes mblidhen në një bazë të dhënash të quajtur ORCA (Aplikacioni i kontrollit të rrezikut operacional). Mbledhja e humbjeve që rrjedhin nga rreziqet operationale është një parakusht për zbatimin e një modeli statistikor të distribuimit të humbjeve dhe një kërkesë minimale për implementimin e qasjes rregullative të standardizuar. Për më tepër, të dhënat për humbjet përdoren për të krijuar dhe për të validuar skenarët e rrezikut operacional dhe për shkëmbimin me grupe të të dhënave ndërkombëtare për të përcjellur më tej mjete të avancuara të menaxhimit të rrezikut operacional, si dhe për të përcjellë më tej masat dhe efikasitetin e kontrollit. Rezultatet e analizave, si dhe ndodhitë që rezultojnë nga rreziqet operationale raportohen rregullisht në mënyrë gjithëpërfshirëse në Komitetin e Menaxhimit të Rrezikut Operacional.

Kuantifikimi dhe zbutja e rrezikut

Banka aktualisht llogarit kërkesat rregullative të kapitalit për rreziqet operationale sipas Basel III duke përdorur qasjen e standardizuar (TSA). Ulja e rrezikut operacional inicohet nga menaxherët e biznesit të cilët vendosin për veprimet parandaluese si zbutjen e rrezikut ose transferimin e rrezikut. Progresi dhe suksesi i këtyre veprimeve monitorohet nga kontrolli i rrezikut. Këta të fundit përcaktojnë edhe planet rezervë dhe emërojnë personat apo departamentet përgjegjëse për fillimin e veprimeve të përcaktuara në qoftë se humbjet në fakt ndodhin. Përveç kësaj, një njësi e dedikuar organizative ofron përkrahje për njësitë e biznesit për uljen e rreziqeve operationale. Një rol të rëndësishëm e merr menaxhimi i mashtrimit që zvogëlon humbjet e mundshme të mashtrimit përmes monitorimit proaktiv dhe veprimeve parandaluese. Banka gjithashtu zbaton një program të gjerë të trajnimit të punonjësve dhe ka vendosur plane të ndryshme për emergjencat dhe sisteme rezervë.

Ndryshimet në mjedisin rregullativ

Banka ka ndjekur nga afër zhvillimet aktuale rregullative dhe ato të ardhshme të vitit 2019. Sektori bankar i Kosovës mbetet shumë dinamik me ndryshimet në legjislacion në përputhje me BE-në.

Në vitin 2018, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka rishikuar rregulloret për menaxhimin e rrezikut kreditor, mjaftueshmërinë e kapitalit dhe rregulloren mbi raportin e levës, të cilat pritet të hynë në fuqi në janar të vitit 2020. Në ndërkohë, janë hartuar rregullore të reja siç janë rregullorja për Procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit (ICAAP), SNRF 9 dhe rregullorja për ekspozimin jo-performues dhe për shtyrjen e afatit. Si pjesë e grupit Raiffeisen Bank International (RBI), Banka i nënshtrohet edhe ndryshimeve në mjedisin rregullativ të BE-së. Kjo na mundëson që t'i përshtatem paraprakisht ndryshimeve në rregulloret lokale, të cilat synojnë të jenë të harmonizuara me rregulloret e BE-së.

Burimet njerëzore dhe trajnimet

Të qenit punëdhënës i preferuar në Kosovë është misioni i Bankës Raiffeisen, që demonstroi një angazhim të madh drejt punonjësve të saj.

Departamenti i burimeve njerëzore dhe trajnimit në Bankë është përgjegjës për të siguruar që njerëzit e duhur janë në pozitat përkatëse dhe se kapacitetet e tyre pasurohen me anë të aktiviteteve të zhvillimit. Arritja e objektivave të korporatës përmes punonjësve profesionalë, shumë të motivuar, të angazhuar dhe të kënaqur, është misioni i vazhdueshëm i Departamentit të burimeve njerëzore dhe të trajnimit.

Më 31 dhjetor 2018, Banka kishte 845 punonjës (774 me orar të plotë, 71 me orar të pjesshëm) dhe 75 agjentë të shitjes direkte. Krahasuar me vitin 2017, numri i përgjithshëm i punonjësve në vitin 2018 është rritur me 5.1 për qind. Numri i punonjësve të rinj që janë bërë pjesë e Bankës ishte 105. Gjatë vitit 2018, Banka kishte një program të rregullt të praktikës dhe disa projekte të tjera që përfshinin praktikantë. Numri i praktikantëve që ishin pjesë e programit dhe projekteve ishte 157. Qëllimi i programeve të praktikës është mbështetja e studentëve të padiplomuar, studentëve që ndjekin studimet Master dhe kandidatët e diplomuar të Kosovës në zhvillimin e tyre profesional.

Mosha mesatare e punonjësve ishte 36 vjeç, gjë që tregon një kapital relativisht të ri njerëzor. Deri në vitin 2018, 52.8 për qind e gjithsej të punësuarve ishin femra, ndërsa 47.2 për qind ishin burra.

Zhvillimi profesional

Banka është e angazhuar për të siguruar që punonjësit e saj të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre duke iu ofruar atyre një shumëllojshmëri të mundësive të të mësuarit dhe zhvillimit përmes trajnimit në vend të punës, trajnimit të brendshëm dhe të jashtëm në klasë, ELearning (të mësuarit përmes platformave elektronike), detyrave dhe përfshirjes në projekte sfiduese vendore dhe ndërkombëtare, mësimi të përzier, rotacionet etj. Këto projekte kanë rezultuar në përmirësimin e njohurive në fushën e produkteve dhe shërbimeve bankare. Në këtë mënyrë, Banka ka fituar një përparësi konkurruese në treg duke ofruar një shërbim më profesional dhe më efikas për klientët e saj. Një fokus i veçantë i është dhënë konceptit të vetëzhvillimit dhe iniciativës vetanake për të mësuarit e pavarur online në vitin 2018, dhe një investim i rëndësishëm ishte bërë me përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mësimi online, i cili ofron shërbime të cilësisë së lartë për nxënës duke përdorur teknologjinë më të fundit.

Banka bashkëpunon me ofrues të ndryshëm të trajnimit brenda dhe jashtë Kosovës për programe specifike trajnimi. Identifikimi i nevojave të trajnimit bëhet në mënyrë të vazhdueshme për të pasur programe të përshatura që i plotësojnë nevojat e punonjësve. Ekzistojnë gjithashtu plane individuale të zhvillimit të mbështetura nga trajnime (mentorime) individuale për një numër të punonjësve, të cilat fokusohen në mënyrë specifike mbi kompetencat e një individi dhe rrisin mundësinë e zhvillimit personal.

E-Learning është tashmë një platformë e të mësuarit shumë mirë e pranuar nga shumica e punonjësve. Në vitin e saj të 11-të të ekzistencës, ka pasur një nivel mbresëlënës të interesimit dhe përkrahjes nga ana e punonjësve të Bankës për të hartuar dhe ndjekur kurse të krijuara brenda organizatës. Gjatë vitit 2018, kishte rreth 2800 regjistrime të punonjësve në sesionet e vetë-dizajnuara të Bankës dhe kurset e RBl-së. Fokus shtesë i është dhënë edhe kurseve online nga ofruesit e jashtëm për rritjen e efikasitetit dhe shumëllojshmërisë në mësim.

Përveç aktiviteteve të lartpërmendura, Banka ka vazhduar t'i përkrahë punonjësit për kurse specifike profesionale dhe të licencimit në një gamë temash që nga ato të aftësive teknike e deri te aftësitë e buta, si pjesë e ngritjes së kapaciteteve. Mësimi gjatë gjithë jetës mbetet një nga mesazhet kryesore në Bankë. Përveç të gjithë mësimi të zhvilluar, kishte gjithashtu një fokus të vazhdueshëm në organizimin e ngjarjeve argëtuese për të arritur një ekuilibër të pranueshëm punë-jetë dhe për të zhvilluar frymën ekipore në mesin e punonjësve.

Menaxhimi i talentit

Gjatë vitit 2018, ka vazhduar fokusi në rritjen e ndërgjegjësimit dhe aftësive të menaxherëve të Bankës në drejtim të aftësive njerëzore. Aktivitetet e menaxhimit të talentit janë organizuar në të gjithë Bankën përmes një procesi që është i lidhur shumë ngushtë me ngritjen e brendshme në detyrë dhe zhvillimin e fokusuar. Banka ka vazhduar t'i realizojë iniciativat zhvillimore si programet e Rotacionit dhe ato ndërfunkionale, si dhe detyrat e përshtatura mësimore. Këto programe të brendshme si dhe programe ndërkombëtare të zhvillimit synojnë të thellojnë më tutje ekspertizën e punonjësve dhe menaxherëve më të talentuar të Bankës përmes një kombinimi inovativ të metodave praktike, alternative dhe akademike të të mësuarit.

Brendimi i punëdhënësit

Gjatë vitit 2018, u prezantuan iniciativat lidhur me Fushatën e Brendimit të Punëdhënësit. Duke përdorur kanale të brendshme të komunikimit dhe media sociale, Banka Raiffeisen në Kosovë ishte e pranishme në publik me fushata të ndryshme të brendimit. Fokusi ishte në promovimin e mundësive të brendshme për zhvillimin profesional të punonjësve të bankës. Këto fushata prezantuan storië të suksesit të punonjësve lidhur me avancimin në karrierë në Bankën Raiffeisen në Kosovë, të cilat demonstuan angazhimin e vazhdueshëm të Bankës për të qenë Punëdhënësi i Preferuar në Kosovë.

Sistemi i menaxhimit të shëndetit

Aktivitetet e menaxhimit të shëndetit vazhduan të jenë një fokus edhe në vitin 2018. Qëllimi është përmirësimi i shëndetit dhe mirëqenies së punonjësve në Raiffeisen Bank në Kosovë duke përmirësuar motivimin, shëndetin dhe performancën e punonjësve.

Banka ka kryer hulumtime për të kuptuar praktikat më të mira në vende të ndryshme kur bëhet fjalë për shëndetin në punë. Bazuar në hulumtimet, banka ndau shëndetin në punë në dy pjesë:

- Seanca me karakter informativ
- Email-a lidhur me kancerin e gjirit
- Masat parandaluese
- Email-a lidhur me të ushqyerit e shëndetshëm
- Punëtori me një mjek për "Efektet e qëndrimit ulur për periudha të gjata kohore"
- Punëtori rreth shëndetit
- Email-a lidhur me efektet e pirjes së duhanit
- Seanca me qëllim të aktivizimit fizik të punonjësve
- Seanca të ecjes në natyrë (hiking)


Kemi mbledhur normat preferenciale për punonjësit në mbarë Kosovën për:

- Palestër
- Fitnes
- Pishina
- Futboll.

Qëndrueshmëria dhe përgjegjësia korporative

Qëndrueshmëria ka qenë gjithmonë një parim themelor për Grupin RBI dhe një masë e suksesit korporativ. Për 130 vjet, Raiffeisen ka kombinuar suksesin financiar me veprimet me përgjegjësi sociale. Banka e kupton qëndrueshmërinë si aktivitetet e përgjegjshme korporative për sukses afatgjatë ekonomik duke marrë në konsideratë aspektet kyçe shoqërore dhe mjedisore. Si një vartëse e Raiffeisen Bank International (RBI), Banka Raiffeisen në Kosovë është e përkushtuar që të punojë në përputhje me parimet "Global Compact" të OKB-së.¹

Për këtë arsye, Banka Raiffeisen në Kosovë angazhohet për harmonizimin e strukturave të saj të menaxhimit dhe proceseve me këtë qëndrim. Në tri zonat e qëndrueshmërisë të "bankier i përgjegjshëm", "partner i drejtë" dhe "qytetar i angazhuar", të cilat janë të lidhura ngushtë me aktivitetet e saj të biznesit, Banka bën përpjekje për t'i zbatuar në mënyrë optimale vlerat dhe aftësitë e saj për të inkurajuar zhvillimin e qëndrueshëm në kompani dhe në shoqëri.



Qasja e Bankës si krijues të një institucioni dhe shoqërie të qëndrueshme

Duke u udhëhequr nga parimet e saj udhëzuese të qëndrueshmërisë, Banka punon që ta bëjë biznesin e saj të qëndrueshëm, dhe dëshiron të krijojë vlerë të qëndrueshme për palët e saj të interesit. Aktivitetet afariste operationale janë të lidhura me ndikimet mjedisore që Banka përpiqet t'i mbajë sa më të vogla që është e mundur përmes menaxhimit sistematik mjedisor. Si punëdhënëse, Banka është përgjegjëse për të siguruar kushte të sigurta dhe tërheqëse të punës për punonjësit e saj. Si anëtare e shoqërisë, Banka dëshiron të kontribuojë për të mirën e përbashkët edhe përtej aktiviteteve të saj afariste dhe të ndërmarrë veprime në përputhje me kapacitetet e saj.

¹ Një thirrje për kompanitë për t'i harmonizuar strategjitë dhe operationet me parimet universale të të drejtave të njeriut, të punës, mjedisit dhe anti-korrupsionit, dhe për të ndërmarrë veprime të cilat avancojnë qëllimet e shoqërisë. www.unglobalcompact.org

Bankieri i përgjegjshëm

Banka Raiffeisen në Kosovë në vitin 2018 kishte shumë aktivitete që kanë një ndikim në të qenit një bankier i përgjegjshëm në Kosovë.

Për sa i përket qeverisjes dhe përputhshmërisë, Banka vlerëson përgjegjësinë dhe transparencën, dhe i zbaton këto vlera në të gjitha aktivitetet e saj. Baza për këtë është Kodi i Sjelljes i Bankës, i cili zbatohet në të gjithë Grupin, për të gjithë anëtarët e stafit dhe partnerët e saj të biznesit.

Politika e kreditimit dhe politika e vendimit të kreditimit

Modeli i biznesit i Bankës është i orientuar rreth qëllimit strategjik të nivelit të lartë të krijimit të vlerës afatgjate. Kredidhënia e përgjegjshme është një komponent i rëndësishëm i këtij modeli. Banka e arrin këtë me një politikë të kreditimit që është e bazuar në ruajtjen e vazhdimësisë. Banka mbetet një huadhënës i drejtë dhe i besueshëm për bizneset me perspektiva për të ardhmen, madje edhe në kohë të vështira, dhe përveç kësaj mban një pozicion të qartë në lidhje me trajtimin e fushave të ndjeshme të biznesit. Banka Raiffeisen në Kosovë ka prezantuar një sistem të menaxhimit mjedisor dhe social, duke përfshirë edhe politikën përkatëse. Qëllimi i kësaj politike është për të kryer biznesin si një qytetar korporativ, i mirë dhe i përgjegjshëm. Prandaj, Banka përpiqet t'i respektojë të gjitha ligjet dhe rregulloret e Kosovës, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me çështjet mjedisore dhe shoqërore dhe është e përkushtuar që të përmirësojë kapacitetin e menaxhimit të rrezikut mjedisor dhe shoqëror (M&Sh) për t'i zvogëluar rreziqet e kredisë dhe detyrimeve.

Kredidhënia e qëndrueshme

Gjatë vitit 2018, në kuadër të financimit të projektit, Banka vazhdoi të mbështeste dhe të financonte zhvillimin e projekteve të pasurive të patundshme në lokacionet më të mira, nga zhvilluesit të cilët kanë treguar historik të ndërtimit cilësor, dorëzimit në kohë të projekteve dhe profitabilitet të qëndrueshëm. Gjatë vitit, Banka gjithashtu trajtoi projektet e energjisë së ripërtërishme, me përpilimin e një liste të projekteve prioritare duke kuptuar dhe duke u përgatitur për financimin e hidrocentraleve të vogla si dhe burimeve të tjera të ripërtërishme të energjisë, siç është energjia solare.

Kredidhënia e përgjegjshme

Banka Raiffeisen në Kosovë është e përkushtuar për politika të përgjegjshme të kredidhënies. Kjo do të thotë që Banka përpiqet të japë kredi për klientët vetëm atëherë sa mund ta përballojë gjendja e tyre financiare. Nëse klientët megjithatë hasin në vështirësi financiare, Banka i përkrah ata sa më mirë që mundet me informacion dhe këshilla.

Kënaqshmëria e klientëve

Kënaqshmëria e klientëve është prioriteti kryesor i Bankës. Prandaj, kjo matet rregullisht, si në biznesin retail ashtu edhe të korporatave, për të mundësuar veprimin e duhur sipas nevojës. Kënaqësia e klientit dhe cilësia e shërbimit në biznesin retail janë matur tashmë disa vite. Në vitin 2018, rezultati i Net Promotor Score (NPS) ishte 44, që është më shumë se 39, që ishte rezultati mesatar i NPS në treg.

Praktikat e përgjegjshme të shitjes dhe marketingut

Çështjet financiare janë çështje besimi. Prandaj, Banka Raiffeisen në Kosovë përpiqet për etiketim të qartë dhe transparent të produkteve dhe shërbimeve për të gjithë klientët dhe palët e interesit. Me rastin e reklamimit dhe marketingut të produkteve bankare, Banka i përmbahet parimeve të rrepta të destinuara për të mbrojtur klientët e saj. Banka mendon që reklamimi i rrejshëm apo çorientues është diçka e papranueshme.

Partner i drejtë

Korrupsioni dhe pastrimi i parave

Banka ndërmeret të gjitha veprimet për të shmangur çdo formë të korrupsionit, pastrimit të parave, mashtrimit apo tregtimit insajder (përdorim i informacionit të privilegjuar me qëllim përfitimin). Një parakusht në praktikën e saj biznesore dhe operacionale është sjellja e drejtë, etike dhe në përputhje me ligjin, e të gjithë anëtarëve të personelit. Mekanizmi që e siguron respektimin është kodi i sjelljes (CoC) dhe rregulloret e qarta dhe të detajuara të përfshira në Manualin e Përputhshmërisë.

Burimet njerëzore

Më 31 dhjetor 2018, Banka kishte 845 punonjës (774 me orar të plotë, 71 me orar të pjesshëm) dhe krahas këtyre 75 agjentë të shitjes direkte. Në krahasim me vitin 2017, numri i përgjithshëm i punonjësve në vitin 2018 shënoi ngritje prej 5.1 për qind. Numri i punonjësve të ri që iu bashkuan Bankës ishte 105. Gjatë vitit 2018, Banka kishte një program të rregullt të praktikës dhe disa projekte të tjera që përfshinin praktikantë. Numri i përgjithshëm i praktikantëve që ishin pjesë e programit dhe projektit ishte 157. Programi i praktikës kishte për qëllim mbështetjen për studentët e padiplomuar, studentët e programit Master dhe të diplomuar të Kosovës në zhvillimin e tyre profesional.

Zhvillimi profesional

Banka u ofron punonjësve të saj një shumëllojshmëri të mundësive të të mësuarit dhe zhvillimit përmes trajnimit në vendin e punës, trajnimit të brendshëm dhe të jashtëm në klasë, E-Learning (të mësuarit elektronik), detyra dhe përfshirje në projekte sfiduese vendore dhe ndërkombëtare, mësim të përzier, rotacione etj. Një fokus i veçantë i është dhënë konceptit të vetëzhvillimit dhe iniciativës vetanake për të mësuarit e pavarur online në vitin 2018, dhe një investim i rëndësishëm është bërë me përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mësimit online, i cili ofron shërbime të cilësisë së lartë për nxënës duke përdorur teknologjinë më të fundit. Banka bashkëpunon me ofrues të ndryshëm të trajnimit brenda dhe jashtë Kosovës për programe specifike trajnimi. Identifikimi i nevojave të trajnimit bëhet në mënyrë të vazhdueshme për të pasur programe të përshtatura që i plotësojnë nevojat e punonjësve. Ekzistojnë gjithashtu plane individuale të zhvillimit të mbështetura me trajnime (mentorime) individuale për një numër të punonjësve, të cilat fokusohen në mënyrë specifike mbi aftësitë e një individi dhe rrisin mundësinë e zhvillimit personal.

Qytetar i angazhuar

Banka e konsideron veten si një qytetar korporativ i angazhuar, që mbështet në mënyrë aktive zhvillimin e qëndrueshëm në shoqëri. Zotimi si qytetar korporativ shkon përtej biznesit bazë dhe ka për qëllim zhvillimin e të rinjve në Kosovë në kulturë, sport, teknologji dhe arsim. Përveç kësaj, Banka gjithashtu ka kontribuar në projektet e mirëqenies sociale, me fokus të veçantë në nënat dhe fëmijët në Kosovë.

Projektet dhe iniciativat e mbështetura

Gjatë vitit 2018, Banka Raiffeisen në Kosovë vazhdoi të jetë një sponsor tradicional i projekteve të ndryshme në pesë fusha kryesore: mirëqenia sociale, kultura, arsimit, shëndetësia dhe sporti. Sa i përket mirëqenies sociale, Banka vazhdoi mbështetjen e organizatës "Aksioni për Nëna dhe Fëmijë" që punon në ngritjen e vetëdijesimit dhe mbështetjen e nënave të reja në Kosovë.

Kultura ka mbetur njëra nga fushat kryesore në të cilën Banka ka vazhduar të angazhohet. Dy projektet kryesore kulturore të cilat Banka i përkrah financiarisht tash e nëntë vjet me radhë janë dy festivalet e mirënjohura: Festivali Chopin Piano Festival dhe Festivali i Filmit në Prishtinë, PriFest. Festivali Chopin Piano Festival ofron koncerte, master kurse për studentë dhe një simpozium që i dedikohet jetës dhe punës së kompozitorëve apo pianistëve që përkujtohen çdo vit anembanë botës. Njëra nga pjesët më të rëndësishme të PriFest në Prishtinë është seria e ngjarjeve "Ko-produksioni Rajonal PriFORUM", i cili sjellë regjisorë të filmit nga vende të ndryshme të Evropës dhe të botës në Kosovë. Punëtori të ndara dhe master kurse për artistët e rinj ishin gjithashtu pjesë e këtyre dy festivaleve kryesore.

Banka Raiffeisen në Kosovë tradicionalisht ka mbështetur Galerinë Kombëtare në dy ekspozitat kryesore “Muslim Mulliqi” dhe “Gjon Mili”, që e pozicionon Bankën si mbështetëse kryesore të artit pamor. Galeria Kombëtare e Kosovës është institucioni publik kulturor më aktiv në Kosovë. Duke qenë i vetmi institucion publik për prezantimin e arteve pamore në Kosovë, ky institucion merret me promovimin e artit bashkëkohor në përgjithësi (arti konceptual, performanca, instalimi, video, piktura dhe skulptura). Ekspozita ndërkombëtare “Muslim Mulliqi” u iniciua në vitin 2003 nga Ministria e Kulturës e Kosovës për promovimin e arteve pamore në Kosovë. Ekspozita “Çmimi i Muslim Mulliqit” është ekspozita më e rëndësishme për artet bashkëkohore në Kosovë. Është një ekspozitë e kuruar me pjesëmarrës vendorë dhe ndërkombëtarë e bërë nga një kurator i jashtëm ose kuratorë të cilët zgjedhin pjesëmarrësit vendorë dhe ndërkombëtarë.

Përveç kësaj, Banka vazhdoi të promovojë artin me Galerinë Raiffeisen. Ideja ishte që t’u jepte artistëve të rinj, të ardhshëm mundësinë për të prezantuar veprat e tyre para publikut. Për këtë qëllim, Banka ka marrë me qira një hapësirë në Albi Mall, qendra më e madhe tregtare e Kosovës dhe kjo hapësirë u shndërrua në një hapësirë inovative ku çdo muaj ekspozohen vepra të reja nga artistë të rinj. Kjo ndihmon komunitetin të ketë një vend ku ata mund të mbajnë ekspozitë pa asnjë shpenzim.

Sa i përket arsimit dhe inovacionit në vitin 2018, Banka Raiffeisen në Kosovë mbështeti projektin Atomi, i cili fokusohet në identifikimin dhe mbështetjen e personave me inteligjencë të jashtëzakonshme, me dhunti dhe talente në Kosovë. Më saktësisht, qëllimi i projektit Atomi është identifikimi i hershëm i nxënësve me inteligjencë të jashtëzakonshme, me dhunti dhe talente (këtej e tutje atomist) në mënyrë që të ofrohen mundësi të duhura, kushte, kujdes dhe shkollim përkatës për këta nxënës në bazë të potencialeve të tyre intelektuale, dhuntisë, talentit, personalitetit, ambicieve, interesave, motivimit dhe kushteve dhe rrethanave të tyre socio-ekonomike. Të gjitha këto shërbime dhe aktivitete ofrohen për t’iu mundësuar këtyre studentëve që të zhvillojnë dhe realizojnë potencialin e tyre të plotë intelektual dhe në këtë mënyrë të kontribuojnë së pari në zhvillimin e tyre personal dhe në të njëjtën kohë në interesin shoqëror dhe kombëtar.

Projekte tjera të rëndësishme që u mbështetën gjatë vitit 2018 ishin klasa muzikore për fëmijët me Sindromin Doën dhe kampi veror për SOS Kopshtin e fëmijëve në Prishtinë.

Si pjesë e mbështetjes së arsimit dhe inovacionit në vitin 2018, Banka vazhdoi bashkëpunimin me BoneVet. BoneVet është një program që ofron mjedis stimulues për imagjinim, kreativitet dhe ndërtimin e ekipit. Fëmijët mësojnë duke bërë gjëra dhe duke menduar mbi atë çfarë bëjnë. Ata kanë qasje në teknologjinë moderne ARDUINO, LITTLEBITS, COMPUTERS, 3D-PRINTERS, ELECTRONICS, CNC, dhe të ngjashme për të bërë/krijuar, dizajnuar dhe luajtur. Në këtë mënyrë, ata fitojnë jo vetëm shkathtësi teknike, por gjithashtu edhe shkathtësi tjera që nuk mësohen në shkollë, si të menduarit kritik, zgjidhja e problemeve, puna në ekip, komunikimi konstruktiv dhe vetëbesimi. Ata mësojnë vlerat si barazia, diversiteti, komunikimi i hapur dhe liria e shprehjes.

Një tjetër aktivitet në fushën e inovacionit është bashkëpunimi me Qendrën e Inovacionit në Kosovë (ICK) në fushat e sigurisë kibernetike dhe fintech, ku Banka ofroi mentorim dhe sesione arsimuese sa i përket këtyre temave për të ndihmuar bizneset fillestare (start-up) që planifikojnë të investojnë në këtë fushë. Përveç kësaj, Banka Raiffeisen në Kosovë mundësoi hapjen e dy laboratorëve kompjuterikë në dy universitete private si pjesë e Memorandumit të Mirëkuptimit midis Bankës dhe Universiteteve duke pajisur të dy laboratorët me kompjuterë.

Gjatë vitit 2018, Banka Raiffeisen në Kosovë gjithashtu mbështeti projekte të ndryshme nga qytete rajonale të Kosovës si pjesë e thirrjes së hapur. Projektet e mbështetura kanë të bëjnë me artin, sportin dhe mbrojtjen e mjedisit.

Pasqyrat financiare

Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat e veçanta financiare për vitin e përmbyllur më 31 dhjetor 2018 janë të përgatitura në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Raporti i auditorit të pavarur	41
Pasqyra e veçantë e pozicionit financiar	42
Pasqyra e veçantë e të ardhurave gjithëpërfshirëse	43
Pasqyra e veçantë e ndryshimeve në ekuitet	44
Pasqyra e veçantë e rrjedhës së parasë	45
Shënimet për pasqyrat financiare të veçanta	46-111

Deklarata mbi përgjegjësinë e menaxhmentit

Për aksionarët dhe Bordin Mbikëqyrës të Raiffeisen Bank Kosovo Sh.a.


Ne kemi përgatitur pasqyrat financiare si më datën 31 dhjetor 2018 dhe për vitin e mbyllur në atë datë, të cilat paraqesin në mënyrë të saktë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Raiffeisen Bank Kosovo Sh.a. (në tekstin e mëtejshëm "Banka") si më 31 dhjetor 2018 si dhe rezultatet e veprimtarisë së saj dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur. Menaxhmenti është përgjegjës për të siguruar se Banka i mbanë llogaritë në pajtueshmëri me rregulloret bankare të Kosovës dhe të cilat mund të ndryshohen në mënyrë të përshtatshme për të shpalosur me saktësi të arsyeshme pozitën financiare të Bankës dhe rezultatet e veprimtarisë së saj dhe rrjedhën e parasë sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar që përfshijnë edhe Standardet dhe Interpretimet Ndërkombëtare të Kontabilitetit, të cilat janë nxjerrë nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (IASB) dhe Komiteti Ndërkombëtar për Interpretime të Raportimit Financiar (IFRIC) i IASB-së, të cilat janë relevante për veprimtarinë e saj dhe të cilat ishin në fuqi për periudhën të cilën e mbulojnë të dhënat. Menaxhmenti ka edhe përgjegjësi të përgjithshme për t'i ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm në dispozicionin e vet për të ruajtur asetet e Bankës dhe për të parandaluar dhe zbuluar mashtrimet dhe parregullsitë tjera.

Menaxhmenti konsideron se, gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, Banka i ka shfrytëzuar politikat adekuatë kontabël, të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente dhe janë mbështetur nga gjykime dhe vlerësime të arsyeshme dhe të matura, dhe se gjatë kësaj janë respektuar Standardet përkatëse Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.


Rrjedhimisht, pasqyrat financiare konsiderohen të miratuara nga Bordi Menaxhues.

Pristinë, Kosovë
25 prill 2019


Bordi Menaxhues i Bankës Raiffeisen në Kosovë



Robert Wright
Kryesues i Bordit Menaxhues



Shukri Mustafa
Anëtar i Bordit Menaxhues



Iliriana Toçi
Anëtare e Bordit Menaxhues



Johannes Riepl
Anëtar i Bordit Menaxhues

Raporti i auditorit të pavarur

Për Aksionarët e Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C. Raport mbi auditimin e pasqyrave financiare

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të veçanta të Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C. (më poshtë "Banka"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2018, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme. Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të veçanta paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2018, dhe të rezultatit të saj financiar dhe të rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësi e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Banka në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël ("Kodi BSNEPK") së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe të Kodit BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera të përfshira në Raportin Vjetor të vitit 2018 të Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.

Informacione të tjera përfshijnë informacione në Raportin Vjetor të Bankës për vitin 2018, përveç pasqyrave financiare të veçanta dhe këtij raporti të auditorit. Menaxhmenti është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor i Bankës për vitin 2018 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të auditorit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare të veçanta nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare të veçanta, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lartë kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare të veçanta apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe të personave që janë të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare të veçanta

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të veçanta në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të veçanta që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare të veçanta, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur menaxhmenti synon ta likuidojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare të veçanta

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të veçanta në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalië mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare të veçanta. Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare të veçanta, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionit mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga Menaxhmenti.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Bankës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e auditorit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare të veçanta, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Banka të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të veçanta, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare të veçanta paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen e Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C., përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.


Pasqyra e veçantë e pozicionit financiar

(shumat në € '000)	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Pasuritë			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme	9	112,032	119,609
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	10	24,733	39,551
Pasuritë financiare të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	12	27,882	79,497
Pasuritë financiare të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	12	95,840	-
Pasuritë financiare në dispozicion për shitje	12	-	102,726
Instrumentet e borxhit me koston e amortizuar	12	-	12,332
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	11	593,202	532,476
Pasuritë tjera	13	3,097	2,362
Investimet në filiale	14	2,234	2,234
Prona, pajisjet dhe pasuritë e paprekshme	15	29,893	10,132
Gjithsej pasuritë		888,913	900,919
Detyrimet			
Depozitat dhe huamarrjet nga bankat	16	618	9,174
Depozitat nga klientët	17	729,467	735,790
Detyrimet financiare të matura me vlerën e drejtë	18	812	1,100
Detyrimet tjera	18	10,236	8,639
Provizionet	18	537	109
Detyrimet tatimore aktuale		-	985
Detyrimi i tatimit të shtyrë	26	254	482
Kreditë e varura	19	19,325	19,325
Gjithsej detyrimet		761,249	775,604
Kapitali i aksionarëve			
Kapitali aksionar		63,000	63,000
Rezerva e vlerës së drejtë		(386)	274
Fitimet e mbajtura		65,050	62,041
Gjithsej kapitali i aksionarëve	20	127,664	125,315
Gjithsej detyrimet dhe kapitali i aksionarëve		888,913	900,919

Pasqyrat financiare të veçanta janë aprovuar që të lëshohen në emër të menaxhmentit të Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C. dhe janë nënshkruar në emër të tyre më 25 prill 2019.



Fatos Shllaku
Drejtor Financiar



Robert Wright
Drejtor Ekzekutiv
Anëtar i Bordit Menaxhues

Pasqyra e veçantë e pozicionit financiar lexohet së bashku me shënimet që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të veçanta të paraqitura në faqet 46 deri 111.

Pasqyra e veçantë e të ardhurave gjithëpërfshirëse

(shumat në € '000)	Shënimet	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Të ardhurat nga norma efektive e interesit	21	43,245	39,090
Shpenzimet nga interesi	21	(2,413)	(2,494)
Neto të ardhurat nga interesi		40,832	36,596
Të ardhurat nga dividendi		1,074	-
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet	22	17,569	18,976
Shpenzimet për tarifa dhe komisione	22	(6,810)	(6,085)
Të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet		10,759	12,891
Shpenzimet tregtare neto		(178)	(59)
Shpenzimet e humbjes kreditore për kreditë dhe paradhëniet për klientët	7	(4,639)	(5,655)
Shpenzimet e humbjes kreditore për kreditë dhe paradhëniet për banka		(25)	-
Shpenzimet e humbjes kreditore për letrat me vlerë		(39)	-
Rikuperimet nga kreditë e shlyera më parë		1,740	1,493
Shpenzimet për provizione për humbjet nga zotimet kreditore dhe detyrimet kontingjente		(175)	10
Fitimet neto të pasurive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes		115	235
Të ardhura tjera operative	23	1,134	1,087
Të ardhurat operative neto		50,598	46,598
Shpenzimet e personelit	24	(12,815)	(12,472)
Zhvlrësimi i pronave dhe pajisjeve	25	(1,611)	(1,455)
Amortizimi i pasurive të paprekshme	25	(1,639)	(1,845)
Shpenzime tjera operative	25	(11,510)	(10,959)
Fitimi para tatimit		23,023	19,867
Shpenzimet e tatimit në fitim	26	(2,517)	(2,288)
Fitimi për vitin		20,506	17,579
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse			
<i>Zërat që janë apo mund të ri-klasifikohen në fitim apo humbje</i>			
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të pasurive financiare nëpërmjet të ardhurave gjithëpërfshirëse		(660)	-
Ndryshimi neto në pasuritë financiare në dispozicion për shitje		-	314
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		19,846	17,893

Pasqyra e veçantë e të ardhurave gjithëpërfshirëse lexohet së bashku me shënimet që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të veçanta të paraqitura në faqet 46 deri 111.

Pasqyra e veçantë e ndryshimeve në ekuitet

(shumat në '000 Euro)	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezerva e vlerës së drejtë	Gjithsej kapitali i aksionarëve
Gjendja më 1 janar 2017	63,000	59,862	(40)	122,822
Fitimi i vitit	-	17,579	-	17,579
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të Investimeve Financiare - të mbajtura për shitje	-	-	314	314
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	63,000	77,441	274	140,715
Kontributet dhe shpërndarjet				
Dividendët ndaj pronarëve të kapitalit	-	(15,400)	-	(15,400)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	63,000	62,041	274	125,315
Ndikimi i adaptimit të SNRF 9 Shënimi 6	-	3	-	3
Gjendja hapëse e ri paraqitur sipas SNRF 9 Shënimi 6	63,000	62,044	274	125,318
Fitimi i vitit	-	20,506	-	20,506
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të pasurive financiare nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	(660)	(660)
Të ardhurat të tjera gjithëpërfshirëse	63,000	82,550	(386)	145,164
Kontributet dhe shpërndarjet				
Dividendët ndaj pronarëve të kapitalit	-	(17,500)	-	(17,500)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	63,000	65,050	(386)	127,664

Pasqyra e veçantë e ndryshimeve në ekuitet lexohet së bashku me shënimet që janë pjesë përbërëse të pasqyrave financiare të veçanta të paraqitura në faqet 46 deri 111.

Pasqyra e veçantë e rrjedhës së parasë

(shumat në € '000)	Shënimet	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Interesi i pranuar në kredi		39,706	38,435
Interesi i paguar në plasmane		144	(93)
Interesi i pranuar në investimet në letra me vlerë		2,296	4,005
Interesi i paguar në depozita dhe kredi të varura		(2,909)	(3,021)
Tarifat dhe komisionet e pranuar		17,569	18,976
Tarifat dhe komisionet e paguara		(6,881)	(5,488)
Të ardhura të tjera nga aktivitetet jo-bankare		2,874	2,982
Shpenzimet e personelit të paguara		(12,762)	(12,365)
Shpenzime të tjera operative të paguara		(10,575)	(6,428)
Tatimi në të ardhura i paguar		(3,900)	(2,550)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative para ndryshimeve në pasuritë dhe detyrimet operative		25,562	34,453
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative			
Rezerva e detyrueshme e likuiditetit		293	(4,498)
Kreditë dhe paradhëniet për bankat		14,818	1,013
Kreditë dhe paradhëniet për klientët		(72,858)	(41,649)
Investimet në letra me vlerë		70,942	9,481
Pasuri të tjera		(735)	(926)
Detyrimet ndaj klientëve		(5,757)	10,883
Depozitat nga banka		(202)	440
Detyrimet tjera		563	(5,211)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		32,626	3,986
Rrjedhat e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerja e pronës, pajisjeve dhe pasurive të paprekshme	15	(14,021)	(3,116)
Neto paraja e shfrytëzuar në aktivitete investuese		(14,021)	(3,116)
Rrjedhat e parasë nga aktivitetet financuese			
Kthimi i huamarrjeve	8	(8,354)	-
Huamarrjet e marra	8	-	8,223
Dividendët e shpërndara	8	(17,500)	(15,400)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese		(25,854)	(7,177)
Efekt i ndryshimit të normës së këmbimit valutor		(34)	(54)
Zvogëlimi neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë		(7,283)	(6,361)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	9	47,986	54,347
Paraja dhe ekuivalentët e parasë më 31 dhjetor	9	40,703	47,986

Pasqyra e veçantë e rrjedhës së parasë lexohet së bashku me shënimet që janë pjesë përbërëse e të pasqyrave financiare të veçanta të paraqitura në faqet 46 deri 111.

Shënimet për pasqyrat financiare e veçantë për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2018

1. Njësia raportuese

Raiffeisen SEE Region Holding GmbH është aksionari që ka në pronësi 100% të Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C. Raiffeisen SEE Region Holding GmbH është 100 % në pronësi indirekte të Raiffeisen Bank International AG.

Banka operon sipas licencës bankare të lëshuar nga BQK më 8 nëntor 2001. Aktivitetet kryesore afariste të Bankës janë aktivitetet bankare komerciale dhe retail brenda Kosovës.

Më 31 dhjetor 2018 Banka ka 8 degë dhe 38 nëndegë brenda Kosovës (31 dhjetor 2017: 8 degë dhe 38 nëndegë). Zyra e regjistruar e Bankës është e vendosur në adresën në vijim: Rruga UÇK nr. 51, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

2. Baza e përgatitjes

2.1 Baza e kontabilizimit

Pasqyrat financiare të veçanta janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") dhe interpretimet e saj të miratuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (BNSK).

2.2 Standardet dhe interpretimet e reja dhe të ndryshuara

Në këto pasqyra financiare, Banka ka aplikuar për herë të parë SNRF 9, SNRF 15 dhe SNRF 7R, efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018. Banka nuk ka miratuar në fillim asnjë standard tjetër, interpretim ose amendim që është lëshuar por që ende nuk është efektiv.

2.2.1 SNRF 9 Instrumentet Financiare

SNRF 9 zëvendëson SNK 39 për periudhat vjetore më ose pas 1 janarit 2018.

Banka nuk ka riparaqitur informacion krahasues për vitin 2017 për instrumentet financiare në fushën e SNRF 9. Prandaj, informacioni krahasues për vitin 2017 raportohet sipas SNK 39 dhe nuk është i krahasueshëm me informacionin e paraqitur për vitin 2018. Dallimet që rrjedhin nga miratimi i SNRF 9 janë njohur drejtpërdrejt në fitimet e pashpërndara që nga 1 janari 2018 dhe janë shpalosur në Shënimin 6.

2.2.1.1 Ndryshimet në klasifikim dhe matje

Për të përcaktuar kategorinë e tyre të klasifikimit dhe matjes, SNRF 9 kërkon që të gjitha pasuritë financiare, përveç instrumenteve të kapitalit dhe derivativëve, të vlerësohen në bazë të një kombinimi të modelit të biznesit të njësisë ekonomike për menaxhimin e pasurive dhe karakteristikat e rrjedhave monetare kontraktuale të instrumenteve.

Kategoritë e matjes së pasurisë financiare të SNK 39 (vlera e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVPL), të mbajtura për shitje (AFS), të mbajtura deri në maturim dhe kosto e amortizuar) janë zëvendësuar me:

- Instrumentet e borxhit me koston e amortizuar
- Instrumentet e borxhit me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI), ku fitimet ose humbjet kthehen si mosnjohje në pasqyrën e fitimit ose humbjeve;
- Instrumentet e kapitalit në FVOCI, pa kthimin e fitimeve ose humbjeve si mosnjohje në pasqyrën e fitimit ose humbjeve;
- Pasuritë financiare FVPL

Kontabilizimi i detyrimeve financiare mbetet kryesisht i njëjtë me atë të SNK 39, përveç trajtimit të fitimeve ose humbjeve që lindin nga risku kreditor të një njësie ekonomike që lidhet me detyrimet e përcaktuara në FVPL. Lëvizje të tilla janë paraqitur në OCI pa rriklasifikim të mëvonshëm në fitim ose humbje.

2.2.1.2 Ndryshimet në llogaritjen e rënies në vlerë

Miratimi i SNRF 9 ka ndryshuar rrënjësisht kontabilitetin e Bankës për zhvlerësimin e humbjeve nga kreditë duke zëvendësuar qasjen e humbjeve të ndodhura me SNK 39 me një qasje të pritshme të humbjes kreditore ("ECL"). SNRF 9 kërkon që Banka të regjistrojë një kompensim për ECL-të për të gjitha huatë dhe pasuritë e tjera financiare të borxhit që nuk mbahen në FVPL, së bashku me angazhimet e huasë dhe kontratat e garancisë financiare. Zbritja bazohet në ECL-të që lidhen me probabilitetin e mosplotësimin në dymbëdhjetë muajt e ardhshëm nëse nuk ka pasur një rritje të konsiderueshme në riskun kreditor që nga krijimi. Nëse pasuria financiare plotëson përkufizimin e kredisë së blerë ose të krijimit të kredisë me probleme (POCI), lejohet ngarkesa e ECL-ve bazuar në jetëgjatësinë e pasurisë.

Detajet e metodës së zhvlerësimit të Bankës janë paraqitur në Shënimin 3 dhe 4. Ndikimi sasior i zbatimit të SNRF 9 më 1 janar 2018 është shpalosur në Shënimin 6.

2.2.2 SNRF 7R

Për të pasqyruar ndryshimet midis SNRF 9 dhe SNK 39, SNRF 7 *Instrumentet Financiare: Dhënia e Informacioneve shpjeguese* është përditësuar dhe Banka e ka miratuar atë së bashku me SNRF 9 për vitin që fillon më 1 janar 2018. Ndryshimet përfshijnë dhënien e informacioneve shpjeguese në tranzicion siç tregohet në Shënimin 6, informacioni cilësor dhe sasior në lidhje me llogaritjet ECL si supozimet dhe inputet e përdorura janë paraqitur në Shënimin 6. Bashkëndimi i saldove hapëse dhe mbyllëse i zbritjeve ECL është paraqitur në Shënimin 6. SNRF 7R gjithashtu kërkon dhënie informacionesh shpjeguese shtesë dhe më të detajuara për kontabilitetin mbrojtës edhe për njësitë ekonomike që zgjedhin të vazhdojnë të zbatojë dhe të mbrojnë kërkesat e kontabël të SNK 39.

2.2.3 SNRF 15 Të Ardhurat nga Kontratat me Klientët

SNRF 15 zëvendëson të gjitha kërkesat ekzistuese të të hyrave në SNRF (SNK 11 Kontratat e Ndërtimit, SNK 18 Të Hyrat, IFRIC 13 Programet e Besnikërisë së Klientit, KIRFN 15 Marrëveshjet për Ndërtimin e Pasurive të Paluajtshme, KIRFN 18 Transferet e Pasurive nga Konsumatorët dhe KIS 31 Të Ardhurat - Shërbimet e Reklamimit) dhe zbatohet për të gjitha të ardhurat që rrjedhin nga kontratat me klientët, me përjashtim të rasteve kur kontratat janë në kuadër të standardeve të tjera, siç janë SNK 17 Qiradhënie (ose SNRF 16 Qira, një herë e aplikuar). Kërkesat e saj gjithashtu sigurojnë një model për njohjen dhe matjen e fitimeve dhe humbjeve në dispozicion të disa pasurive jo financiare, duke përfshirë pasuritë afatgjata materiale, ndërtesa, makineri e pajisje dhe pasuri jo-materiale. Duke qenë se fokusimi i SNRF 15 nuk është kontabilizimi i të ardhurave nga instrumentet financiare të cilat në rastin e Bankës trajtohen sipas SNRF 9, numri i kontratave për të cilat standardi është i aplikueshëm është shumë i kufizuar.

Banka miratoi SNRF 15 duke përdorur metodën e modifikuar retrospektive duke filluar me datën e zbatimit fillestar të 1 janarit 2018. Banka zgjodhi të zbatojë standardin për të gjitha kontratat më 1 janar 2018. Informacioni krahasues nuk është riparaqitur dhe vazhdon të raportohet sipas SNK 18 dhe interpretimet përkatëse.

SNRF 15 kryesisht përfshin brenda fushëveprimit të saj të ardhurat nga tarifat dhe komisione të Bankës (Shënimi 22). Këto tarifa dhe komisione normalisht fitohen kur transaksionet ekzekutohen ose janë tarifat e aplikuar për mirëmbajtjen e llogarive brenda një muaji apo viti dhe zakonisht përmbushin detyrimet e performancës dhe të ardhurave njihen brenda vitit financiar. Miratimi i SNRF 15 nuk ka ndryshuar praktikat e njohjes së të ardhurave të Bankës.

2.3 Valuta funksionale dhe e prezantimit

Valuta funksionale e Bankës e përdorur në përgatitjen e pasqyrave financiare të veçanta është Euro, pasi që është valuta e mjedisit ekonomik primar në të cilin punon Banka dhe pasqyron substancën ekonomike të ngjarjeve të lidhura ("valuta funksionale"). Të gjitha shumat janë rrumbullkuar në mijëshen më të afërt, përveç kur specifikohet ndryshe.

2.4 Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimeve

Në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare të veçanta, menaxhmenti ka bërë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël të Bankës dhe shumat e raportuara të pasurive, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet reale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

3. Politikat e rëndësishme kontabël

Informacioni për fushat e rëndësishme të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimet kritike në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare të veçanta janë përshkruar në shënimet 3.4, 4 dhe 5.

Politikat kontabël të mëposhtme janë zbatuar në vazhdimësi në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare të veçanta.

3.1 Filialet dhe konsolidimi

Filialet janë entitete të kontrolluara nga Banka. Kontrolli ekziston kur Banka është e ekspozuar, ose ka të drejta, ndaj kthimit variabil nga përfshirja e saj me të investuarin (filialin) dhe ka aftësinë të ndikojë në atë kthim përmes pushtetit të vet mbi të investuarin.

Këto pasqyra financiare paraqesin rezultatin dhe pozitën financiare vetëm të Bankës dhe nuk përfshijnë ato të filialeve të saj, siç është dhënë në detaje në shënimin 14.

Banka përgatitë pasqyra financiare të veçanta në përputhje me SNRF. Është bërë përjashtim nga konsolidimi sepse Banka në vetvete është vartës tërësisht në pronësi dhe kompania mëmë përfundimtare Raiffeisen Bank International përgatitë pasqyra financiare të konsoliduara, në dispozicion për përdorim publik në <http://www.rbinternational.com>, që janë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Interesat në filiale janë llogaritur në bazë të kostos në pasqyrat financiare e veçanta.

3.2 Transaksionet në valuta të huaja

Transaksionet në valutë të huaj regjistrohen me kursin në ditën e transaksionit. Pasuritë dhe detyrimet monetare në valutë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e raportimit.

Fitimet dhe humbjet nga këmbimi valutor si rezultat i pagesës së transaksioneve të tilla dhe nga konvertimi në kursin e këmbimit në fund të vitit të pasurive dhe detyrimeve monetare në valutë të huaj paraqiten në fitim dhe humbje.

3.3 Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare

3.3.1 Klasifikimi i Pasurive financiare

Nga 1 janari 2018, Banka klasifikon të gjitha pasuritë e saj financiare bazuar në modelin e biznesit për menaxhimin e pasurive dhe kushteve kontraktuale të pasurisë, të matura në:

- koston e amortizuar;
- vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI); dhe
- vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVTPL).

3.3.2 Klasifikimi i Detyrimeve financiare

Sipas SNRF 9, të gjitha detyrimet financiare klasifikohen si më pas të matura me koston e amortizuar përveç për artikujt e mëposhtëm që maten në FVTPL:

- Detyrimet financiare që mbahen për tregtim - duke përfshirë derivativët;
- Detyrimet financiare që lindin kur një transferim i një pasurie financiare nuk kualifikohet për çregjistrim ose kur zbatohet qasja e përfshirjes së vazhdueshme;
- Garancitë financiare dhe nën angazhimet kreditore për interesat me normë të tregut;
- Detyrimet kontingjente të njohura nga një blerës në një kombinim biznesi;
- Detyrimet financiare që janë përcaktuar si në FVTPL për njohjen fillestare.

Banka klasifikon të gjitha detyrimet e saj financiare me koston e amortizuar.

3.3.3 Modeli i Biznesit

Banka përcakton modelin e saj të biznesit në nivelin që reflekton më mirë se si menaxhon grupet e pasurive financiare për të arritur objektivin e saj të biznesit.

Modeli i biznesit i Bankës nuk vlerësohet në bazën instrument pas instrumente, por në një nivelin më të lartë të portofoleve të grumbulluara dhe bazohet në faktorë të vëzhgueshëm si:

- Si vlerësohet dhe raportohet performanca e modelit të biznesit dhe pasurive financiare të mbajtura brenda atij modeli biznesi të personelit drejtues të njësisë ekonomike;
- Risqet që ndikojnë në ecurinë e modelit të biznesit (dhe pasuritë financiare të mbajtura brenda atij modeli biznesi) dhe, në veçanti, mënyrën se si menaxhohen ato risqe;
- Si kompensohen menaxherët e biznesit (për shembull, nëse kompensimi bazohet në vlerën e drejtë të pasurive të administruara ose në mjetet kontraktuale të arkëtuara);
- Frekuenca e pritshme, vlera dhe koha e shitjeve janë gjithashtu aspekte të rëndësishme të vlerësimit të Bankës.

Megjithatë, pritjet e Bankës janë se niveli më i lartë i gjenerimit është në nivel të Departamentit të Bankës. Duhet të përdoren nën-portofole të mëtejshëm në mënyrë që çdo portofol të jetë i njëjtë ose i ngjashëm.

- Zona e biznesit;
- Vlerësimi i performancës së KPI;
- Menaxhimi kyç Personal (B-1);
- Risku dhe proceset e menaxhimit të riskut;
- IT Infrastruktura.

Vlerësimi i modelit të biznesit bazohet në skenarë të pritshëm, pa marrë në konsideratë skenarët e “rastit më të keq” ose “rastin e stresit”. Nëse rrjedhat e mjeteve monetare pas njohjes fillestare realizohen në një mënyrë të ndryshme nga pritjet origjinale të Bankës, Banka nuk ndryshon klasifikimin e pasurive të mbetura financiare të mbajtura në atë model biznesi, por përfshin informacion të tillë gjatë vlerësimit të pasurive financiare të sapo krijuara apo të sapo blera.

3.3.4 Karakteristikë e rrjedhës së parasë kontraktuale

Pasi Banka të përcaktojë se modeli i biznesit të një portofoli specifik është mbajtja e mjeteve financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale (ose duke mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe duke shitur pasuritë financiare), vlerëson nëse kushtet e kontratës së pasurisë financiare japin rritje në datat specifike të flukseve të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar. Për këtë qëllim, interesi përcaktohet si shpërbllim për vlerën kohore të parasë dhe për risku kreditor që shoqërohet me shumën e principalit të papaguar gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe për risqet e tjera bazë (p.sh. likuiditeti) dhe shpenzimet (p.sh. administrative), si dhe një marzhë fitimi.

Në vlerësimin nëse rrjedhat monetare kontraktuale janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit, banka do të marrë parasysh kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo do të përfshijë vlerësimin nëse pasuria financiare përmban një term kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e rrjedhave të mjeteve monetare kontraktuale në mënyrë që të mos plotësojë këtë kusht. Banka konsideron:

- Parapagimet, kushtet e zgjatjes
- Karakteristika e avantazheve
- Pretendimi është e kufizuar në pasuritë e specifikuar ose rrjedhat e mjeteve monetare
- Instrumente të lidhura në mënyrë kontraktuale

Ky vlerësim duhet të kryhet në instrument për instrument në datën e njohjes fillestare të pasurisë financiare

3.3.5 Modifikimi i Vlerës në kohë të Parasë dhe Testit Benchmark

Vlera në kohë e parasë është elementi i interesit që ofron konsideratë vetëm për kalimin e kohës. Nuk merr parasysh risqet e tjera (kredi, likuiditet etj.) ose kostot (administrative, etj.) të lidhura me mbajtjen e një pasurie financiare.

Në disa raste, vlera në kohë e elementit të parasë mund të modifikohet (e papërsosur). Ky do të ishte rasti, për shembull, nëse norma e interesit të një pasurie financiare rikthehet periodikisht, por frekuenca e atij adaptimi nuk përputhet me normën e interesit. Në këtë rast njësitë duhet të vlerësojnë modifikimin nëse rrjedhat monetare kontraktuale ende përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe të interesit, d.m.th. Termi i modifikimit nuk ndryshon ndjeshëm rrjedhat e mjeteve monetare nga një instrument referent ‘i përsosur’. Ky vlerësim nuk është një zgjedhje e politikës kontabël dhe nuk mund të shmanget thjesht duke konkluduar që një instrument, në mungesë të një vlerësimi të tillë, do të matet me vlerën e drejtë.

Për karakteristikat e mëposhtme kontraktuale kryesore që potencialisht mund të modifikojnë vlerën kohore të parasë, zbatohet një test benchmark:

- Shpejtësia e interesit të ri nuk përputhet me maturimin e interesit;
- Treguesin e trendit;
- Klauzolën zbutëse;
- Greis periudhën;
- Referenca e rendimentit dytësor të tregut.

Testi benchmark për çdo produkt të zbatueshëm në nivel bankar drejtohet nga RBI HO në Vienë.

3.3.6 Njohja e pasurive dhe detyrimeve financiare

Banka fillimisht njeh kreditë, të arkëtueshmet dhe detyrimet e tjera financiare në datën në të cilën ato janë krijuar. Të gjitha instrumentet të tjera financiare (përfshirë blerjet e rregullta dhe shitjet e pasurive financiare) njihen në datën e tregimit, që është data në të cilën Banka bëhet pjesë në dispozitat kontraktuale të instrumentit të provizionimit. Pasuria financiare ose detyrimi financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë plus, për zërin që nuk është me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostove të transaksionit që lidhen drejtpërdrejtë me blerjen apo emetimin.

3.3.7 Mosnjohja e pasurive dhe detyrimeve financiare

3.3.7.1 Mosnjohja për shkak të modifikimit thelbësor të termave dhe kushteve - Politika e zbatueshme nga 1 janari 2018 (SNRF 9)

Banka çregjistron një pasuri financiare, të tillë si një hua për një klient, kur kushtet janë rinegocuar në atë masë që, në thelb, bëhet një hua të re, me diferencën e njohur si fitim ose humbje, në masën se një humbje nga zhvlerësimi nuk është regjistruar ende. Huatë e reja të njohura klasifikohen si Kategoria 1 për qëllimet e matjes ECL, përveç nëse kredia e re konsiderohet të jetë POCL.

Gjatë vlerësimit për mosnjohjen e një huaje për një klient, ndër të tjera, Banka konsideron faktorët e mëposhtëm:

- Ndryshimi në valutën e huasë;
- Prezantimi i një tipari të kapitalit;
- Ndryshimi në palën tjetër;
- Nëse modifikimi është i tillë që instrumenti të mos plotësojë kriterin e SPPI.

Nëse modifikimi nuk rezulton në rrjedhën e mjeteve monetare që janë në thelb të ndryshme, modifikimi nuk rezulton në mosnjohje. Bazuar në ndryshimet në rrjedhën e mjeteve monetare të skontuara në EIR origjinale, Banka regjistron një fitim ose humbje modifikimi, në masën që një humbje nga zhvlerësimi nuk është regjistruar ende.

3.3.7.2 Mosnjohja përveç modifikimit substancial - Politika e zbatueshme nga 1 janari 2018 (SNRF 9)

Pasuritë financiare

Një pasuri financiare (ose, kur është e mundur, një pjesë e një pasurie financiare ose një pjesë të një grupi të pasurive financiare të ngjashme) çregjistrohet kur të drejtat për të marrë mjete monetare nga pasuria financiare ka skaduar. Banka gjithashtu çregjistron pasurinë financiare nëse ka transferuar pasurinë financiare dhe transferimi kualifikohet për çregjistrim.

Banka ka transferuar pasurinë financiare nëse dhe vetëm nëse:

- Banka ka transferuar të drejtat e saj kontraktuale për të marrë mjete monetare nga pasuria financiare, ose
- Ajo ruan të drejtat e mjeteve monetare, por ka marrë përsipër detyrimin për të paguar mjetet monetare të marra në tërësi pa vonesë materiale për një palë të tretë nën një marrëveshje kalimtare.

Marrëveshjet kalimtare janë transaksione ku Banka ruan të drejtat kontraktuale për të marrë mjetet monetare të një pasurie financiare ('pasuria origjinale'), por merr përsipër një detyrim kontraktual për të paguar këto mjete monetare në një ose më shumë subjekte ('përfituesit eventuale'), kur plotësohen të gjitha tri kushtet e mëposhtme:

- Banka nuk ka asnjë detyrim për të paguar shumat për përfituesit eventualë, nëse nuk ka mbledhur shuma ekuivalente nga pasuria origjinale, duke përfshirë paradhëniet afatshkurtra me të drejtën e rimbursimit të plotë të shumës së huasë plus interesin e përlogaritur me normat e tregut;
- Banka nuk mund të shesë ose të zotojë pasurinë origjinale përveçse si siguri për përfituesit eventualë;
- Banka duhet të dorëzojë çdo mjet monetar që mbledh në emër të përfituesve eventual pa vonesë thelbësore.

Përveç kësaj, Banka nuk ka të drejtë të riinvestojë mjete të tilla monetare, me përjashtim të investimeve në para dhe ekuivalentët e parasë duke përfshirë interesin e fituar, gjatë periudhës midis datës së arkëtimit dhe datës së dërgesës së kërkuar për përfituesit eventualë.

Një transferim kualifikohet për mosnjohje nëse:

- Banka ka transferuar kryesisht të gjithë riskun dhe përfitimet e pasurisë;
- ose
- Banka nuk ka transferuar ose ruajtur në mënyrë të konsiderueshme të gjitha risqet dhe përfitimet e pasurisë, por ka transferuar kontrollin e pasurisë.

Banka e konsideron të transferojë kontrollin nëse dhe vetëm nëse transferuesi ka aftësinë praktike për të shitur pasurinë në tërësinë e saj për një palë të tretë të palidhur dhe është në gjendje ta ushtrojë atë aftësi në mënyrë të njëanshme dhe pa vendosur kufizime shtesë për transferimin.

Kur Banka nuk ka transferuar ose ruajtur në mënyrë të konsiderueshme të gjitha risqet dhe përfitimet dhe ka ruajtur kontrollin e pasurisë, pasuria vazhdon të njihet vetëm në masën e përfshirjes së vazhdueshme të Bankës, në të cilin rast, Banka njih edhe një detyrim shoqërues. Pasuritë e transferuara dhe detyrimi shoqërues maten në bazë që pasqyron të drejtat dhe detyrimet që Banka ka ruajtur.

Nëse përfshirja e vazhdueshme merr formën e një opsioni të shkruar ose të blerë (ose të dyja) në pasurinë e transferuar, përfshirja e vazhdueshme matet në vlerën që Banka do të kërkojë të paguajë pas riberjes. Në rastin e një opsioni të vënë me shkrim mbi një pasuri që matet me vlerën e drejtë, shkalla e përfshirjes së vazhdueshme të njësisë ekonomike kufizohet në vlerën më të ulët të vlerës së drejtë të pasurisë të transferuar dhe çmimit të ushtrimit të opsionit.

Detyrimet financiare

Detyrimi financiar nuk njihet kur obligimi nga detyrimi zbatohet, anulohet ose skadon. Kur një detyrim financiar ekzistues zëvendësohet nga një tjetër nga i njëjti huadhënës në kushte thelbësisht të ndryshme, ose kushtet e një detyrimi ekzistues ndryshohen në mënyrë substanciale, një shkëmbim ose modifikim i tillë trajtohet si një mosnjohje e detyrimit fillestar dhe njohja e një detyrimi të ri. Diferenca midis vlerës kontabël të detyrimit financiar fillestar dhe vlerës së paguar njihet në fitim ose humbje.

3.3.7.3 Mosnjohja e pasurive dhe detyrimeve financiare (Politika e zbatueshme para 1 janarit 2018 SNK 39)

Banka e çregjistron një pasuri financiare kur të drejtat kontraktuese mbi rrjedhat e parasë nga pasuria financiare mbarojnë, ose kur transferon të drejtat për të marrë rrjedhat monetare kontraktuese në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë financiare janë transferuar apo një pasuri financiare për të cilën Banka as nuk mban thelbësisht të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk e mban kontrollin e pasurisë financiare.

Me çregjistrimin e pasurisë financiare, diferenca ndërmjet vlerës bartëse të pasurisë (ose vlera e bartur e ndarë për pjesën e pasurisë që po çregjistrohet) dhe shumës së konsideratës së pranuar (përfshirë çdo pasuri të re të përfituar minus çdo detyrim të ri të marrë përsipër) dhe çdo fitimi ose humbje kumulative që është njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, njihet në fitim ose humbje. Çdo interes në pasuritë financiare të transferuara që kualifikohen për çregjistrim që krijohet ose mbahet nga Banka njihet si pasuri apo detyrim i veçantë.

Banka çregjistron një detyrim financiar kur obligimet e veta kontraktuale përfundojnë apo anulohen, apo u skadon afati.

3.3.8 Netimi

Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare netohen reciprokisht dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e gjendjes financiare kur, dhe vetëm kur, Banka ka të drejtë ligjore për të kompensuar shumat dhe synon ose t'i shlyejë ato në bazë neto ose të realizojë pasurinë dhe ta shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet sipas SNRF.

3.3.9 Matja e kostos së amortizuar

“Kostoja e amortizuar” e një pasurie financiare ose detyrimi financiar është shuma me të cilën pasuria financiare ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare minus shlyerjet e kryegjësë, plus ose minus amortizimi i akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus zbritjet eventuale për shkak të rënies në vlerë.

3.3.10 Matja e vlerës së drejtë

“Vlera e drejtë” është çmimi që do të merrej nëse shitet një pasuri ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes në tregun kryesor ose, në mungesë të tij, tregun më të favorshëm në të cilin Banka ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e detyrimit pasqyron riskun e mos performancës së tij.

Qëllimi i përdorimit të një teknike vlerësimi është të përcaktojë se cili do të ishte çmimi i transaksionit (p.sh. një çmim dalës) në datën e matjes në një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësve të tregut. Vlera e drejtë vlerësohet në bazë të rezultateve të një teknike vlerësimi që merr përdorimin maksimal të inputeve të tregut dhe mbështetet sa më pak të jetë e mundur në inputet specifike të entitetit. Një teknikë vlerësimi pritet të arrijë në një vlerësim real të vlerës së drejtë nëse:

- a) reflekton në mënyrë të arsyeshme se si mund të pritet çmimi i tregut për vlerën e instrumentit; dhe
- b) inputet në teknikën e vlerësimit në mënyrë të arsyeshme paraqesin pritjet e tregut dhe masat e faktorëve të riskut-khimit të qenësishme në instrumentin financiar.

Prandaj, një teknikë vlerësimi

- a) përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do ta konsideronin në vendosjen e një çmimi;
- b) është në përputhje me metodologjitë e pranuar ekonomike për çmimet e instrumenteve financiare.

Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i transaksionit – d.m.th. vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë.

Metodologjitë e tjera përfshijnë krahasimin e vlerës së drejtë të atij instrumenti në krahasim me transaksionet e tjera të tregut të tanishëm të vëzhguar në instrumentin e njëjtë / të ngjashëm (d.m.th. pa modifikim ose ripaketim) ose bazuar në një teknikë vlerësimi ndryshore e të cilave përfshijnë të dhëna nga tregjet e vëzhgueshme. Qasja e rrjedhës monetare të skontuar është një teknikë e përdorur për të lidhur shumat e ardhshme (rrjedhat e mjeteve monetare) me të tashmen nëpërmjet një norme skontimi.

Konceptet e vlerës aktuale janë qendrore për zhvillimin e teknikave për vlerësimin e vlerës së drejtë të instrumenteve financiare, sepse çmimi i daljes nga tregu i një instrumenti financiar përfaqëson vlerësimin kolektiv të pjesëmarrësit të tregut të vlerës aktuale të flukseve monetare të pritura. Prandaj, rrjedha e mjeteve monetare dhe norma e skontimit duhet të pasqyrojnë vetëm faktorët që janë specifike për instrumentin financiar që matet dhe duhet të reflektojnë supozimet që pjesëmarrësit e tregut do të përdorin në vlerësimet e tyre të vlerës së drejtë. Gjithashtu, duke qenë se rrjedhat e mjeteve monetare të përdorura janë më shumë vlerësime sesa shuma të njohura, një vlerësim me vlerën e drejtë, duke përdorur vlerën aktuale, bëhet në kushtet e pasigurisë.

Ndërsa pjesëmarrësit e tregut në përgjithësi kërkojnë kompensim për mbajtjen e pasigurisë së qenësishme në rrjedhën e mjeteve monetare (primat të rrezikut), efekti i ndryshueshmërisë (rrezikut) në rrjedhën e mjeteve monetare duhet të pasqyrohet ose në rrjedhën e mjeteve monetare ose në normën e skontimit. Në zbatimin e analizës së rrjedhës së mjeteve monetare (“DCF”), Banka duhet të përdorë norma skontimi të barabarta me normat mbizotëruese të kthimit për instrumentet financiare që kanë në thelb të njëjtat kushte dhe karakteristika, duke përfshirë cilësinë e kreditorit të instrumentit, afati i mbetur mbi të cilin është caktuar norma e interesit kontraktuale, afati i mbetur për rimbursimin e principalit dhe valuta në të cilën duhet të bëhen pagesat. Rrjedhat e mjeteve monetare të përdorura në modelin DCF duhet të “përshtaten” me normën e skontimit dhe gjithashtu duhet të marrin në konsideratë karakteristikat e përmendura më lart (p.sh. perioda e mbetur e normës së interesit kontraktuale dhe e principalit).

Kur është e mundur, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë

instrument. Tregu konsiderohet si aktiv nëse transaksionet për pasurinë ose detyrimin zhvillohen me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacionin e çmimeve në baza të vazhdueshme. Nëse nuk ka çmim të kuotuar në një treg aktiv, atëherë Banka përdor teknikën e vlerësimit që maksimizojnë përdorimin e inputeve përkatëse të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve që nuk vëzhgohen. Teknika e përzgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në çmimet e një transaksioni.

Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i transaksionit – d.m.th. vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë.

Nëse Banka përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk dëshmohet as me çmim të kuotuar në treg aktiv për një pasuri ose detyrim identik dhe as në bazë të një teknike vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregje të vëzhgueshme, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, të korrigjuar për të shtyrë dallimin ndërmjet vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit.

Më pas, ky dallim njihet në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme përgjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se kur vlerësimi përkrahet plotësisht nga të dhëna të vëzhgueshme të tregut ose kur transaksioni të mbyllet. Në qoftë se një pasuri ose detyrim i matur me vlerën e drejtë ka një çmim të ofertës dhe një çmim të kërkesës, atëherë Banka matet pasuritë dhe pozicionet e gjata me çmimin e ofertës dhe detyrimet dhe pozicionet e shkurtra me çmimin e kërkesës.

Vlera e drejtë e depozitës sipas kërkesës nuk është më pak se shuma e pagueshme sipas kërkesës, e skontuar nga data e parë në të cilën shuma mund të kërkohej për t'u paguar. Banka njih transferet ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë deri në fund të periudhës raportuese gjatë së cilës ka ndodhur ndryshimi.

3.3.11 *Garancitë financiare, letër e kreditë dhe angazhimet e huasë*

Banka lëshon garanci financiare, letra kredie dhe kredi.

Garancitë financiare fillimisht njihen në pasqyrat financiare (me provizione) me vlerë të drejtë, duke qenë primi i marrë. Pas njohjes fillestare, detyrimi i Bankës sipas secilës garanci matet me shumën më të madhe të shumës së njohur fillimisht në amortizimin kumulativ të njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe - sipas SNK 39 - vlerësimi më i mirë i shpenzimeve të kërkuara për të shlyer çdo detyrim financiar që del si një rezultat i garancisë, ose - sipas SNRF 9 - një dispozitë ECL siç përcaktohet në Shënimin 18.1. Primi i pranuar njihet në pasqyrën e të ardhurave në shpenzimet neto dhe të ardhurat nga komisionet në bazë të drejtpërdrejtë gjatë jetës së garancisë. Zotimet e huaja dhe letrat e kredive janë angazhime nën të cilat, gjatë kohëzgjatjes së angazhimit, Bankës i kërkohej të ofrojë një hua me terma të paracaktuar për klientin. Ngjashëm me kontratat e garancisë financiare, sipas SNK 39, është bërë një provizion nëse ato ishin një kontratë e vështirë, por që nga 1 janari 2018, këto kontrata janë në kuadër të kërkesave të ECL.

Vlera nominale kontraktuale e garancive financiare, letër kredive dhe angazhimeve, ku huatë e dakorduara për t'u ofruar janë në terma të tregut, nuk regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar. Vlerat nominale të këtyre instrumenteve së bashku me ECL-të përkatëse janë dhënë në Shënimin 12.

3.3.12 *Pasuritë financiare të rëna në vlerë (Politika e zbatueshme nga 1 janari 2018)*

Miratimi i SNRF 9 ka ndryshuar rrënjësisht metodën e zhvlerësimit të humbjes kreditore të Bankës duke zëvendësuar metodën e humbjeve të ndodhura me SNK 39 me një qasje ECL afatgjatë. Nga 1 janari 2018, Banka ka regjistruar zbritjen për humbjet e pritshme kreditore për të gjitha huatë dhe pasuritë e tjera financiare të borxhit që nuk mbahen në FVPL, së bashku me angazhimet e huasë dhe kontratat e garancisë financiare. Instrumentet e kapitalit neto nuk janë subjekt i zhvlerësimit sipas SNRF 9. SNRF 9 përdor një model të pritshëm të humbjes kreditore për të njohur zhvlerësimin në kundërshtim me SNK 39 i cili përdor një model humbjeje të shkaktuar. Modeli i pritshëm i humbjes kreditore zbatohet për instrumentet e borxhit me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse, të arkëtueshmeve të qirasë, kontratat e pasurisë dhe angazhimeve të huasë dhe kontratave të garancisë financiare që nuk maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Banka ka krijuar një politikë për të kryer një vlerësim, në fund të çdo periudhe raportuese, nëse risku kreditor i një instrumenti financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, duke marrë parasysh ndryshimin në riskun e mosplotësimi që ndodh gjatë jetës së mbetur të instrumentit financiar.

Bazuar në procesin e mësipërm, Banka grumbullon kreditë e saj në Kategorinë 1, Kategorinë 2, Kategorinë 3 dhe POCl, siç përshkruhet më poshtë:

- Kategorinë 1: Kur kreditë njihen për herë të parë, banka njih një kompensim në bazë të 12mECL. Kreditë e Kategorisë 1 gjithashtu përfshijnë objekte ku risku kreditor është përmirësuar dhe kredia është riklasifikuar nga Kategorinë 2.

- **Kategoria 2:** Kur një hua ka shfaqur një rritje të konsiderueshme në riskun kreditor që nga krijimi, banka regjistron një zbritje për jetëgjatësinë e humbjeve e pritshme kreditore - LTECLs. Kreditë e Kategorisë 2 gjithashtu përfshijnë objekte, ku risku kreditor është përmirësuar dhe kredia është riklasifikuar nga Kategoria 3.
- **Kategoria 3:** Kreditë që konsiderohen me probleme (siç janë shënuar në Shënimin 4). Banka regjistron një kompensim për LTECL-të.
- **POCI:** Norma e skontimit e përdorur në llogaritjen e pritshme të humbjes kreditore (POCI) janë pasuritë financiare që janë me probleme në njohjen fillestare. Pasuritë e POCI regjistrohen me vlerën e drejtë në njohjen fillestare dhe të ardhurat nga interesi njihen më pas në bazë të një EIR të rregulluar nga kredia. ECL-të njihen ose njihen vetëm në masën që ka një ndryshim pasues në humbjet e pritura kreditore. Për pasuritë financiare për të cilat Banka nuk ka shpresa të arsyeshme për mbulimin e të gjithë shumës së mbetur, ose një pjesë të saj, vlera kontabël bruto e pasurisë financiare është zvogëluar. Kjo konsiderohet një çregjistrim (i pjesshëm) i pasurisë financiare.

Ekzistojnë 3 qasje kryesore të cilat mund të përdoren për të llogaritur humbjet e pritura të kredive këto janë:

- A. Qasja e përgjithshme;
- B. Qasje e thjeshtuar;
- C. Pasuritë financiare të blera ose të rena në vlerë në origjinë (POCI).

A. Qasja e përgjithshme

Duke përdorur metodën e përgjithshme, shuma e humbjeve të pritshme të kreditorëve të njohura si një humbje ose provizion varet nga vlerësimi i shkallës së përkeqësimit të kredisë që nga njohja fillestare.

Qasja e përgjithshme aplikohet për vlerësimin ECL për huatë dhe paradhëniet për klientët, huatë dhe paradhëniet për bankat dhe investimet financiare, që kërkon përdorimin e modeleve komplekse dhe supozimet e rëndësishme për kushtet e ardhshme ekonomike dhe sjelljen e pagesave.

Nevojiten gjykime të rëndësishme në zbatimin e kërkesave kontabël për matjen e humbjeve të pritura të kreditorëve, ndër të tjera:

- Përcaktimi i kriterëve për rritje të ndjeshme të risku kreditor;
- Zgjedhja e modeleve dhe supozimeve të përshtatshme për matjen e humbjeve të pritshme kreditorëve;
- Humbjet e pritshme të kredisë duhet të njihen bazuar në rritjen e konsiderueshme të gjasave ose rrezikut të një mospagimi që ndodh që nga njohja fillestare pavarësisht nëse një instrument financiar është rivlerësuar për të pasqyruar një rritje në rrezikun kreditorë. Krijimi i numrit dhe skenarëve të ardhshëm për çdo lloj produkti / tregu dhe humbjet e pritura të kredive të lidhura;
- Krijimi i grupeve të pasurive financiare të ngjashme me qëllim matjen e humbjeve të pritura kreditorëve.

Definicioni i vonesës

Banka e konsideron një instrument financiar të papaguar dhe për këtë arsye Kategoria 3 është kur një ose më shumë nga kriteret sasiore, cilësore dhe kriteret e kthimit si në vijim janë plotësuar:

Kriteret kuantitative

Huamarrësi është më shumë se 90 ditë në vonesë për një detyrim material të kredisë. Nuk është bërë asnjë përpjekje për të hedhur poshtë supozimin se pasuritë financiare që janë me vonesë më shumë se 90 ditë duhet të tregohen në Kategorinë 3.

Kriteret kualitative

Huamarrësi plotëson pamundësinë për të paguar kriteret, të cilat tregojnë se huamarrësi është në vështirësi të konsiderueshme financiare dhe nuk ka gjasa të paguajë detyrimet e kredisë në tërësi. Treguesit e pamundësisë për të paguar përfshijnë:

- Detyrimi kreditor vihet në një status jo-akruar për shkak të gjendjes së përkeqësuar të kredisë;
- Detyrimi kreditor është shitur me humbje materiale ekonomike;
- Një detyrim kreditor i nënshtrohet një ristrukturimi;
- Është e mundshme që huamarrësi të falimentojë;

- Është e mundshme që huamarrësi ka kryer mashtrime në kredi;
- Huamarrësi është i vdekur;
- Një kontratë e kredisë u ndërpre në mënyrë të parakohshme për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve nga huamarrësi.

Kriteret e mësipërme janë zbatuar në të gjitha instrumentet financiare të mbajtura nga Banka dhe janë në përputhje me përkufizimin e vonesës të përdorur për qëllime të menaxhimit të riskut të brendshëm kreditor. Përcaktimi i vonesës është aplikuar vazhdimisht për të modeluar probabilitetin e vonesës (PD), ekspozimin në vonesë (EAD) dhe humbjen nga vonesa (LGD) gjatë llogaritjeve të humbjeve të pritura të bankës.

Një instrument konsiderohet të mos jetë më në vonesë pas një periudhë provuese prej tre muajsh (gjashtë muaj pas një ristrukturimi të vështirë), ku gjatë periudhës së provës klienti demonstroi një disiplinë të mirë pagese dhe asnjë tregues tjetër i pamundësisë për të paguar nuk ishte vërejtur.

Rritje e ndjeshme e riskut kreditor (SICR)

Një numër faktorësh janë të rëndësishëm gjatë vlerësimit të rritjes së ndjeshme të rrezikut kreditorë. Lista nga SICR përmban kryesisht informacionin që është në pjesën e modelit të brendshëm të vlerësimit të Bankës, pra përdoret për caktimin e vlerësimit të kredisë. Duke pasur informacionin e përfshirë tashmë në vlerësimin e brendshëm, metoda sasiore është e mjaftueshme për vlerësimin e saktë të rritjes së ndjeshme të riskut kreditor.

Kriteri sasior zbatohet individualisht për çdo instrument. Nuk bëhet grupimi i ekspozimit, që do të thotë se matja e një rritjeje të konsiderueshme të riskut kreditor nuk kryhet në baza kolektive. Për këtë qëllim, nëse huamarrësi është më shumë se 30 ditë vonesë për një detyrim material kreditor.

Kriteret cilësore

Kriteret cilësore të përdorura nga Banka në lidhje me SICR përfshijnë:

- Ndryshimet në qasjen e menaxhimit të kredisë të njësisë ekonomike në lidhje me instrumentin financiar;
- Ndryshimet e pritshme në dokumentacionin e huasë (d.m.th., Ndryshimet në kushtet e kontratës);
- Ndryshime të dukshme në treguesit e jashtëm të tregut të riskut kreditor për një instrument financiar të veçantë ose instrumente financiare të ngjashme me të njëjtën jetëgjatësi.

Vlerësimi i brendshëm

Banka gjithashtu përfshin vlerësimin e brendshëm për të përcaktuar SICR;

- Ndryshime të dukshme në treguesit e brendshëm të çmimeve të riskut kreditor si rezultat i një ndryshimi në riskun kreditor që nga fillimi;
- Një ndryshim aktual ose i pritshëm i vlerësimit të jashtëm të instrumentit financiar;
- Një ulje e vlerësimit të brendshëm të kredisë aktuale ose të pritshme për huamarrësin;
- Ndryshimet ekzistuese ose të parashikuara negative në kushtet e biznesit, financiare ose ekonomike;
- Një ndryshim i dukshëm ose i pritshëm në rezultatet e operimit të huamarrësit;
- Rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë në instrumente të tjerë financiarë të të njëjtit huamarrës;
- Një ndryshim aktual ose i pritshëm i rëndësishëm negativ në mjedisin rregullator, ekonomik ose teknologjik të huamarrësit;
- Ndryshime të rëndësishme në vlerën e kolateralit që mbështetin detyrimin;
- Një ndryshim domethënës në cilësinë e garancisë të siguruar nga një aksionar;
- Ndryshime të rëndësishme, të tilla si zvogëlimi, mbështetja financiare nga një njësi ekonomike mëmë ose degë tjetër ose një ndryshim i rëndësishëm aktual ose i pritshëm në cilësinë e rritjes së kredisë;
- Ndryshime të dukshme në ecurinë dhe sjelljen e pritur të huamarrësit;
- Ndryshime të tjera në normat ose kushtet e një instrumenti financiar ekzistues që do të ishte shumë ndryshe nëse instrumenti sapo krijuar ose lëshuar në datën e raportimit.

Shpjegimi i inputeve, supozimeve dhe teknikave të vlerësimit

Humbja e pritshme kreditore matet ose në bazë të një periudhe 12-mujore ose në natyrë të jetëgjatësisë në varësi të faktit nëse ka ndodhur një rritje e dukshme e riskut kreditor që nga njohja fillestare ose nëse një pasuri konsiderohet si e rënë në vlerë nga kreditë. Informacioni ekonomik i avancuar gjithashtu përfshihet në përcaktimin e PD-së 12-mujore dhe të jetëgjatësisë, EAD dhe LGD. Këto supozime ndryshojnë sipas llojit të produktit.

Humbjet e pritshme kreditore janë produkti i skontuar i probabilitetit të vonesës (PD), humbjes nga vonesa (LGD), ekspozimit në vonesë (EAD) dhe faktorit zbritje (D).

Probabiliteti i vonesës (PD)

Probabiliteti i vonesës paraqet gjasat që një huamarrës të mos përmbushë detyrimet e tij financiare gjatë 12 muajve të ardhshëm ose gjatë jetëgjatësisë së mbetur të detyrimit. Në përgjithësi, probabiliteti i vjetërsisë së mos pagesës llogaritet duke përdorur probabilitetin rregullator 12 mujor të mos pagesës, të zhveshur nga çdo diferencë konservatizmi, si pikënisje. Më pas përdoren metoda të ndryshme statistikore për të gjeneruar një vlerësim se si profili i mos pagesës do të zhvillohet nga pika e njohjes fillestare gjatë gjithë jetës së kredisë ose portfolios së kredive. Profili bazohet në të dhënat e vërejtura historike dhe funksionet parametrike.

Modele të ndryshme janë përdorur për të vlerësuar profilin e mos pagesës të shumave të kredive të papaguara dhe këto mund të grupohen në kategoritë e mëposhtme:

- Institucionet publike, lokale dhe rajonale, kompanive të sigurimeve dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive, iu gjenerohet profili i mos pagesës duke përdorur një qasje të matricës së tranzicionit. Informacioni i paraparë është inkorporuar në probabilitetin e mos pagesës duke përdorur një faktor të modelit Vasicek.
- Klientëve të korporatave, projekteve financuese dhe institucioneve financiare, profili i paracaktuar iu gjenerohet duke përdorur një metodë parametrike të regresit të mbijetesës (Weibull). Informacioni i paraparë është inkorporuar në probabilitetin e mos pagesës duke përdorur një faktor të modelit Vasicek.
- Hipotekave me pakicë dhe kredive tjera me pakicë profili i mos pagesës iu gjenerohet duke përdorur regresin parametrik të mbijetesës në kornizat konkurruese të riskut. Informacioni i paraparë është inkorporuar në probabilitetin e parazgjedhur duke përdorur modelet satelitore.

Kreditë me kushte të ristrukturuara janë kredi të cilat janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të huamarrësit dhe ku banka ka bërë lëshime të cilat nuk do të konsideronte përndryshe. Pasi kredia është ristrukturuar mbetet në të njëjtën kategori deri sa të arrihet një performancë e kënaqshme. Performanca e kënaqshme definohet si tri pagesa të njëpasnjëshme të kryeqjës dhe/ose interesit kontraktual.

Vlerësimi i humbjes së pritshme kreditore - ECL

Banka vendos një lejim për humbjet nga rënia në vlerë që përfaqëson vlerësimin e humbjeve që do të ndodhin në portfolion e saj kreditore.

Politika e shlyerjes

Politika e kontabilitetit të Bankës sipas SNRF 9 mbetet e njëjtë me atë të SNK 39. Pasuritë financiare shlyhen pjesërisht ose tërësisht vetëm kur Banka ka ndaluar ndjekjen e rikuperimit. Nëse shuma që duhet të shlyhet është më e madhe se kompensimi për humbjen e akumuluar, diferenca fillimisht trajtohet si shtesë e shumës që zbatohet më pas ndaj vlerës kontabël bruto. Çdo rikthim i mëvonshëm kreditohet në shpenzimet e humbjes kreditore.

Përmbledhje e kredive të modifikuara

Tabelat në vijim paraqesin një përmbledhje të pasurive të modifikuara të Bankës më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017.

31 dhjetor 2018	Kategoria 2			Kategoria 3			Raporti i kredive të modifikuara
	Vlera bartëse bruto	Modifikime të përhershme për T & Cs	Gjithsej kreditë e modifikuara	Modifikime të përhershme për T&Cs	Gjithsej kreditë jo performuese të riprogramuara	Gjithsej kreditë e modifikuara	
Depozitat në banka	7,600	-	-	-	-	-	0%
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	-	-	-	-	-	-	-
Klientët Korporata	296,649	7,781	-	11,668	-	-	0%
Klientët Individualë	318,544	2,829	2,832	768	768	3,600	1.13%
Gjithsej Kreditë dhe paradhëniet për klientët	615,193	10,610	2,832	12,436	768	3,600	1.13%

31 dhjetor 2017	Portfolio performuese			Portfolio jo-performuese			Raporti i kredive të modifikuara
	Vlera bartëse bruto	Modifikime të përhershme për T & Cs	Gjithsej kreditë e modifikuara	Modifikime të përhershme për T & Cs	Gjithsej kreditë jo performuese të riprogramuara	Gjithsej kreditë e modifikuara	
Depozitat në banka	16,091	-	-	-	-	-	0%
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	-	-	-	-	-	-	-
Klientët Korporata	278,404	6,363	-	18,826	-	-	0%
Klientët Individualë	275,565	2,724	2,704	825	838	3,542	1.29%
Gjithsej Kreditë dhe paradhëniet për klientët	553,969	9,087	2,704	19,651	838	3,542	1.29%

Përmbledhje e kredive të modifikuara

31 dhjetor 2018	Shuma bruto e kredive të modifikuara			Humbjet e pritshme të kredive të modifikuara		
	Kategoria 2	Kategoria 3	Gjithsej	Kategoria 2 Kolektive	Kategoria 3 Kolektive	Gjithsej
Depozitat në banka	-	-	-	-	-	-
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	-	-	-	-	-	-
Klientët Korporata	-	-	-	-	-	-
Klientët Individualë	2,832	768	3,600	333	716	1,049
Gjithsej Kreditë dhe paradhëniet për klientët	2,832	768	3,600	333	716	1,049

31 dhjetor 2017	Performuese	Jo-performuese		Gjithsej	Lejime specifike	Lejime kolektive	Gjithsej
		- jo të rëna në vlerë	- të rëna në vlerë				
Depozitat në banka	-	-	-	-	-	-	-
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	-	-	-	-	-	-	-
Klientët Korporata	-	-	-	-	-	-	-
Klientët Individualë	2,704	138	700	3,542	-	970	970
Gjithsej Kreditë dhe paradhëniet për klientët	2,704	138	700	3,542	-	970	970

Kreditë dhe paradhëniet për klientët

Ekspozimi maksimal ndaj riskut kreditor para kolateralit dhe lehtësimeve tjera kreditore më 31 dhjetor 2018 nga sektori i kundërt.

	Kreditë dhe paradhëniet për klientët	
	2018	2017
Jo- Derivative		
Bankat	138,999	161,394
Institucionet publike	123,722	194,555
Klientët korporata	372,701	338,746
Klientët individualë	310,348	268,295
Gjithsej shuma bruto	945,770	962,990
Derivative		
Bankat	28,930	36,330
Gjithsej shuma bruto	28,930	36,330

Tabelat e mëposhtme shpalosin informacion në lidhje me cilësinë kreditore të pasurive financiare dhe lejimin për rënie në vlerë/ humbjen e mbajtur nga Banka kundër këtyre pasurive.

	Kreditë dhe paradhëniet për klientët	
	2018	2017
Ekspozimi maksimal ndaj riskut kreditor		
Shuma bruto	615,193	553,969
Lejimi për rënie në vlerë	(21,991)	(21,493)
Vlera bartëse neto	593,202	532,476
Kreditë me kushte të rinegociuara		
Vlera bartëse bruto	22,714	28,005
Lejimi për rënie në vlerë	(12,025)	(12,545)
Vlera bartëse neto	10,689	15,460

Më poshtë është një analizë e kolateralit dhe rritjes së kredive gjatë viteve:

31 dhjetor 2018	Kreditë dhe paradhëniet për klientët			Vlera e drejtë e kolateralit		
	Individuale	Korporata	Gjithsej	Individuale	Korporata	Gjithsej
Pasuri të patundshme komerciale	821	4,933	5,754	786	4,871	5,657
Pasuri të patundshme rezidenciale	34,588	-	34,588	32,078	-	32,078
Pasuri të luajtshme	283,135	291,716	574,851	172,268	281,339	453,607
Gjithsej	318,544	296,649	615,193	205,132	286,210	491,342

31 dhjetor 2017	Kreditë dhe paradhëniet për klientët			Vlera e drejtë e kolateralit		
	Individuale	Korporata	Gjithsej	Individuale	Korporata	Gjithsej
Pasuri të patundshme komerciale	522	6,135	6,657	277	7,779	8,056
Pasuri të patundshme rezidenciale	27,183	-	27,183	15,697	-	15,697
Pasuri të luajtshme	247,860	272,269	520,129	30,570	283,335	313,905
Gjithsej	275,565	278,404	553,969	46,544	291,114	337,658

Më poshtë është një analizë e pasurive financiare të matura me koston e amortizuar. Përveç nëse tregohet në mënyrë specifike, për pasuritë financiare, shumat në tabelë përfaqësojnë vlerën kontabël bruto:

31 dhjetor 2018					
	Gjithsej vlera bartëse bruto	Kategoria 1	Kategoria 2	Kategoria 3	Vlera e drejtë e kolateralit
Portofolio të korporatave	296,649	258,840	23,741	14,068	286,210
Portofolio individuale	318,544	298,780	13,757	6,007	205,132
Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët	615,193	557,620	37,498	20,075	491,342
31 dhjetor 2017					
	Gjithsej vlera bartëse bruto	Kategoria 1	Kategoria 2	Kategoria 3	Vlera e drejtë e kolateralit
Portofolio të korporatave	278,404	235,886	18,196	24,322	291,114
Portofolio individuale	275,565	256,473	14,247	4,845	46,544
Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët	553,969	492,359	32,443	29,167	337,658

Banka monitoron përqendrimit e riskut kreditor sipas sektorëve. Një analizë e përqendrimeve të riskut kreditor më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 për huatë dhe paradhëniet për klientët me ditë vonese dhe të rëne në vlerë - Kategoria 3 janë paraqitur më poshtë:

31 dhjetor 2018					
	Më pak se 1 muaj	Nga 1 në 3 muaj	Nga 3 në 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Gjithsej
Portofolio të korporatave	10,904	90	1,261	1,813	14,068
Portofolio individuale	397	87	861	4,662	5,735
Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët me vonesë	11,301	177	2,122	6,475	20,075
31 dhjetor 2017					
	Më pak se 1 muaj	Nga 1 në 3 muaj	Nga 3 në 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Gjithsej
Portofolio të korporatave	17,967	80	2,065	4,210	24,322
Portofolio individuale	654	118	619	3,454	4,845
Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët me vonesë	18,621	198	2,684	7,664	29,167

Kreditë dhe paradhëniet për bankat

Ekspozimet ndërbankare monitorohen nga afër çdo ditë nga menaxhimi i rrezikut dhe Departamenti i Thesarit. Banka kufizon depozitat dhe transaksionet e tjera bankare në banka të vendore ose ndërkombëtare. Para se të fillohet një marrëdhënie biznesi me një bankë të caktuar, menaxhmenti dhe Departamenti i Riskut kryejnë një analizë të gjendjes financiare të institucionit. Performanca financiare e palëve kontraktuese monitorohet vazhdimisht. Për më tepër, të gjitha bankat korresponduese si dhe emetuesit e bonove në të cilat Banka ka ekspozime investimi monitorohen vazhdimisht për vlerësimet e tyre nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit si: Moody's, Standard & Poor's (S & P) dhe Fitch përveç ekspozimeve me bonot e thesarit të Kosovës të cilat nuk janë vlerësuarat. Për të përfaqësuar vlerësimet e agjencive të ndryshme ndërkombëtare të vlerësimit, tabelat e mëposhtme janë përgatitur në përputhje me skemat e vlerësimit të Bankës Qendrore të Kosovës që përfaqësojnë si më poshtë;

Definicionet e vlerësimeve	Moody' ose ekuivalent	
	Shkalla e vlerësimit afatgjatë	Shkalla e vlerësimit afatshkurtër
Cilësi e lartë e kredisë	Aaa Aa1 Aa2 Aa3	P-1
Kapacitet të fortë të pagesave	A1 A2 A3	P-2
Kapaciteti i pagesës adekuate	Baa1 Baa2 Baa3	P-3

Një funksion i pavarur nga departamenti i thesarit, zakonisht menaxhimi i rrezikut, duhet të monitorojë që ekspozimi ndaj të gjitha bankave nuk i kalon limitet rregullatore ose kufijtë e brendshëm të përcaktuar nga menaxhmenti i Bankës.

Në pajtim me rregulloren e re për ekspozimet e mëdha të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, bankat nuk do të kenë ndonjë ekspozim të përgjithshëm të riskut kreditor ndaj palëve të ndërlidhura që tejkalojnë 15 për qind të kapitalit rregullator të nivelit të parë.

Kreditë dhe paradhëniet për bankat janë dhënë pa kolateral. Tabela e mëposhtme paraqet llogaritë rrjedhëse të Bankës dhe depozitat me afat me bankat përkatëse sipas klasifikimit të kredive, të cilat janë klasifikuar si Kategoria 1.

31 dhjetor	2018	2017
P-1	11,999	11,807
P-2	15,433	26,721
P-3	4,134	16,373
	31,566	54,901

Investimet në letra me vlerë

Investimet në letrat me vlerë kryesisht janë në bono qeveritare me vendet e OECD, T-Bills të Republikës së Kosovës dhe bono të korporatave.

Investimet janë kryesisht për menaxhimin e likuiditetit të bankës dhe sigurojnë diversifikim të mjaftueshëm të riskut në drejtim të ekspozimit kreditor me një sovran duke marrë në konsideratë edhe mjedisin rregullator lokal dhe kufizimin e ekspozimeve të mëdha.

Tabela e mëposhtme paraqet ekspozimin e letrave me vlerë bazuar në vlerësimin e Moody's;

	2018	2017
P-1	45,322	100,588
P-2	38,303	46,078
P-3	14,078	14,304
E pa vlerësuar	26,019	33,585
	123,722	194,555

Ekspozimi i raportuar si i pavlerësuar pasqyron ekspozimin bankar në Republikën e Kosovës.

Tabela më poshtë paraqet ekspozimin ndaj riskut bazuar në riskun e palës së kundërt të ekspozimit.

	2018	2017
T-Bills dhe T-Bonds të Republikës së Kosovës	26,019	33,585
Bondet qeveritare dhe bonot qeveritare me vendet e OECD-së	55,068	87,586
Bonot e korporatave	42,635	73,384
Gjithsej investimi në letra me vlerë	123,722	194,555

4.3 Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Banka do të hasë vështirësi në përbushjen e detyrimeve financiare. Banka ekspozohet ndaj kërkesave të përditshme mbi burimet e saj të parave të gatshme në dispozicion nga llogaritë rrjedhëse, depozitat që u afrohet afati i maturimit, kreditë e tërhequra dhe garancionet. Risku i likuiditetit menaxhohet nga Menaxhmenti i Bankës. Banka mban pasuri afatmesme dhe afatgjata dhe për shkak të kushteve të tregut, financon pjesën më të madhe të portofolios të saj me borxh afatshkurtër. Në këtë proces, Banka trashëgon riskun e likuiditetit që lidhet me mospërputhjet e maturimit. Risqet nëse menaxhohen në mënyrë korrekte janë risqe të pranueshme. Banka lëshon pasuri afatgjata, siç janë kreditë PI dhe rezidenciale, dhe këto portfolio financohen kryesisht nga depozitat pa afat dhe depozitat me afat deri në 1 vit. Menaxhmenti merr në baza ditore informacionin e raportit të likuiditetit të Bankës, dhe gjithashtu në baza javore pranon raportin e likuiditetit të renditur sipas segmentit të biznesit. Pasi që banka lëshon pasuri afatmesme dhe afatgjata, dhe i financon ato me borxh afatshkurtër dhe afatmesëm, ajo është e ekspozuar edhe ndaj riskut të normës së interesit. Rezerva e likuiditetit rregullativ llogaritet si 10 për qind e detyrimeve mesatare që kanë afat maturimi brenda një viti, rezervë e cila mbahet si depozita në bankën qendrore dhe 50 për qind në para të gatshme. Më 31 dhjetor 2018, teprica e rezervës së likuiditetit është 3,537 mijë Euro (2017: 8,508 mijë Euro). Tabela e mëposhtme tregon pasuritë dhe detyrimet si më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 sipas maturitetit të mbetur kontraktual. Disa nga pasuritë megjilhatë, mund të jenë të natyrës më afatgjatë; për shembull kreditë vazhdojnë shpesh dhe prandaj kreditë afatshkurtra mund të ketë kohëzgjatje më të madhe.

	Me kërkesë dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri 3 muaj	Nga 3 deri 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Jo - specifike	Gjithsej
Pasuritë						
Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	7,600	-	-	-	104,432	112,032
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	23,941	-	-	-	792	24,733
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	34,396	34,626	188,024	336,156	-	593,202
Investimet në letra me vlerë	35	15,097	38,732	69,858	-	123,722
Pasuritë tjera	-	-	2,502	-	-	2,502
Gjithsej pasuritë financiare	65,972	49,723	229,258	406,014	105,224	856,191
Detyrimet						
Depozitat nga klientët	710,815	1,275	16,982	395	-	729,467
Depozitat dhe huamarrjet nga bankat	618	-	-	-	-	618
Borxhi i varur	325	-	-	19,000	-	19,325
Detyrime të tjera	-	-	11,585	-	-	11,585
Gjithsej detyrimet financiare	711,758	1,275	28,567	19,395	-	760,995
Hendeku neto më 31 dhjetor 2018	(645,786)	48,448	200,691	386,619	(105,224)	95,196

	Me kërkesë dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri 3 muaj	Nga 3 deri 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Jo - specifike	Gjithsej
Pasuritë						
Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	16,090	-	-	-	103,519	119,609
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	39,551	-	-	-	-	39,551
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	33,002	31,979	167,965	299,530	-	532,476
Investimet në letra me vlerë	21,454	14,242	38,480	120,379	-	194,555
Pasuritë tjera	-	-	1,954	-	-	1,954
Gjithsej pasuritë financiare	110,097	46,221	208,399	419,909	103,519	888,145
Detyrimet						
Depozitat nga klientët	723,182	1,916	10,211	481	-	735,790
Depozitat dhe huamarrjet nga bankat	9,174	-	-	-	-	9,174
Borxhi i varur	325	-	-	19,000	-	19,325
Detyrime të tjera	-	-	9,848	-	-	9,848
Gjithsej detyrimet financiare	732,681	1,916	20,059	19,481	-	774,137
Hendeku neto më 31 dhjetor 2017	(622,584)	44,305	188,340	400,428	103,519	114,008

Analiza e maturimit të kredive për klientë bazohet në datat e mbetura të maturimit të marrëveshjeve të kredisë, që do të thotë duke marrë parasysh këstet në baza mujore.

Raportimi i likuiditetit në baza javore në nivel të segmentit të biznesit, monitorimi i raportit të pandryshueshmërisë ndaras për të gjitha segmentet e biznesit, limitet në librin bankar dhe raportet të cilat matin riskun e interesit dhe diferencat, janë aktualisht mjetet e zbatuara për të menaxhuar dhe kufizuar riskun themelor për kryerjen e biznesit.

Rezervat e detyrueshme të likuiditetit janë të përfshira në kuadër të kategorisë “me kërkesë dhe më pak se një muaj”, sepse shumica e detyrimeve me të cilat lidhet kjo gjendje janë gjithashtu të përfshira në këtë kategori.

Analiza e maturitetit për detyrimet financiare analizohet si në vijim:

- Në bazë të datës më të hershme kontraktuale të maturitetit– varianti i rastit më të keq;
- Në bazë të rrjedhave kontraktuale të parasë pa u skontuar;
- Përcaktimin e brezave kohorë;
- Rrjedhat e pritura të parasë përdoren si informata plotësuese.

Përputhja dhe/ose mospërputhja e kontrolluar e afateve të maturimit dhe normave të interesit të pasurive dhe detyrimeve është themelore për menaxhimin e Bankës. Është e pazakontë për bankat që të përputhen plotësisht pasi biznesi i kryer është shpesh me afat të pasigurt dhe i llojeve të ndryshme. Një pozicion i papërputhur potencialisht rrit profitabilitetin, por gjithashtu mund të rrisë riskun e humbjeve. Afati i maturimit të pasurive dhe detyrimeve dhe aftësia për të zëvendësuar detyrimet që bartin interes ndërsa ato matorojnë me një kosto të pranueshme janë faktorë të rëndësishëm në vlerësimin e likuiditetit të Bankës dhe ekspozimin e saj ndaj ndryshimeve në interes dhe kursin e këmbimit.

Banka ka një mospërputhje të konsiderueshme të afatit të maturitetit të pasurive dhe detyrimeve me afat maturimi një vit. Kjo mospërputhje e likuiditetit lind për shkak të faktit se burimi kryesor i financimit të Bankës si më 31 dhjetor 2018 ishin llogaritë e klientëve që janë pa afat dhe matorojnë brenda më pak se një muaji. Menaxhmenti beson se, përkundër asaj se një pjesë të madhe e llogarive të klientëve janë “pa afat”, diversifikimi i këtyre depozitave sipas numrit dhe llojit të depozituesve do të tregonte se llogaritë e këtyre klientëve japin një burim afatgjatë dhe të qëndrueshëm të financimit për Bankën.

Banka ka përmirësuar pozicionin neto përmes burimeve të tjera të financimit, të cilat ofrojnë financimin afatmesëm dhe ka për qëllim të vazhdojë përputhjen e maturitetit të pasurive me detyrimet në periudhat që do të vijjnë. Gjithashtu, Banka ka një marrëveshje të papërdorur të një mundësie për kredi, e cila do të ofrojë përkrahje në rast se ka nevojë për likuiditet.

Shuma totale kontraktuese e mbetur e zotimeve për të dhënë kredi nuk paraqet domosdo kërkesa të ardhshme për para, pasi shumë prej këtyre zotimeve do të skadojnë ose përfundojnë pa u financuar.

4.4 Risku i tregut

Risku i tregut është risku që vlera e një investimi do të bjerë për shkak të lëvizjeve në faktorët e tregut. Katër faktorët standardë të riskut të tregut janë: Risku i ekuitetit ose risku që çmimet e aksioneve do të ndryshojnë.

- Rreziku i kapitalit ose rreziku që çmimet e aksioneve të ndryshojnë.
- Risku i normës së interesit ose risku që normat e interesit do të ndryshojnë.
- Risku valutor ose risku që normat e valutës së huaj do të ndryshojnë.
- Risku i mallrave ose risku që çmimet e mallrave (d.m.th., drithërat, metalet etj.) do të ndryshojnë.

Banka merr përsipër ekspozimin ndaj riskut të tregut. Risku i tregut shfaqet nga pozicionet e hapura në normën e interesit dhe produktet valutore, të cilat të gjitha janë të ekspozuara ndaj lëvizjeve të përgjithshme dhe specifike të tregut. Menaxhmenti vendos limitet në vlerën e riskut që mund të pranohet, që monitorohet në baza ditore. Megjithatë, përdorimi i kësaj qasjeje nuk i ndalon humbjet jashtë këtyre kufijve në rast të lëvizjeve më të mëdha të tregut.

Risku gjeografik

Përqendrimi gjeografik i pasurive dhe detyrimeve financiare të Bankës më datën 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është dhënë më poshtë:

	Kosovë	BE	Tjera	Gjithsej
Pasuritë				
Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	104,432	7,600	-	112,032
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	-	24,733	-	24,733
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	593,202	-	-	593,202
Investimet në letra me vlerë	26,023	44,405	53,294	123,722
Pasuritë tjera	2,502	-	-	2,502
Gjithsej pasuritë financiare	726,159	76,738	53,294	856,191
Detyrimet				
Depozitat nga klientët	685,949	16,679	26,839	729,467
Depozitat nga bankat	123	495	-	618
Borxhi i varur	-	19,325	-	19,325
Detyrimet tjera	10,773	812	-	11,585
Gjithsej detyrimet financiare	696,845	37,311	26,839	760,995
Hendeku neto më 31 dhjetor 2018	29,314	39,427	26,455	95,196
	Kosovë	BE	Tjera	Gjithsej
Pasuritë				
Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	103,519	16,090	-	119,609
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	-	39,551	-	39,551
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	532,476	-	-	532,476
Investimet në letra me vlerë	33,592	93,382	67,581	194,555
Pasuritë tjera	1,954	-	-	1,954
Gjithsej pasuritë financiare	671,541	149,023	67,581	888,145
Detyrimet				
Depozitat nga klientët	689,336	18,374	28,080	735,790
Depozitat nga bankat	696	8,478	-	9,174
Borxhi i varur	-	19,325	-	19,325
Detyrimet tjera	8,748	1,100	-	9,848
Gjithsej detyrimet financiare	698,780	47,277	28,080	774,137
Hendeku neto më 31 dhjetor 2017	(27,239)	101,746	39,501	114,008

Risku valutor

Kjo është një formë e riskut që vjen nga ndryshimi në çmimin e një valute kundër një tjetre. Risku valutor menaxhohet përmes monitorimit të pozicioneve të hapura të FX (valutës së huaj). Këto pozicione vendosen për pozicione ditore dhe gjithashtu veç e veç, për pozicionet brenda natës. Analiza e ndjeshmërisë i dorëzohet menaxhmentit në baza javore.

Banka merr përsipër ekspozimin ndaj efekteve të luhatjeve në kurset mbizotëruese të këmbimit në valutë të huaj në pozicionin e saj financiar dhe në rrjedhat e parasë. Menaxhmenti vendos limitet mbi nivelin e ekspozimit sipas valutave dhe në total, të cilat monitorohen çdo ditë. Përdorimi i Euros në Kosovë dhe ekspozimi i kufizuar ndaj valutave të tjera do të thotë që ka pak nevojë për të përdorur instrumentet derivative për menaxhimin e riskut valutor.

Raporti i Riskut të Tregut që përfshinë raportin e rrezikut të normës së interesit dhe raportin e hapur FX, i dërgohen menaxhmentit në baza javore. Raporti përkatës bëhet nga RBI Menaxhmenti i rrezikut bazuar në inputet që sigurohen nga burimet e raportimit lokal.

Tabela në vijim përmbledh ekspozimin e Bankës ndaj rrezikut të kursit të këmbimit në 31 dhjetor 2018 dhe 2017. Në tabelë janë përfshirë pasuritë dhe detyrimet financiare të Bankës në vlerat kontabël, të kategorizuara sipas monedhave dhe të përkthyer në Euro '000.

	Euro	USD	Tjera	Gjithsej
Pasuritë				
Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	102,201	5,080	4,751	112,032
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	12,791	1,488	10,454	24,733
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	593,202	-	-	593,202
Investimet në letra me vlerë	92,447	31,275	-	123,722
Pasuritë tjera	2,502	-	-	2,502
Gjithsej pasuritë financiare	803,143	37,843	15,205	856,191
Detyrimet				
Depozitat nga klientët	672,142	41,747	15,578	729,467
Depozitat nga bankat	618	-	-	618
Borxhi i varur	19,325	-	-	19,325
Detyrimet tjera	11,585	-	-	11,585
Gjithsej detyrimet financiare	703,670	41,747	15,578	760,995
Hendeku neto më 31 dhjetor 2018	99,473	(3,904)	(373)	95,196
	Euro	USD	Tjera	Gjithsej
Pasuritë				
Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	111,862	1,443	6,304	119,609
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	16,238	10,513	12,800	39,551
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	532,476	-	-	532,476
Investimet në letra me vlerë	173,426	21,129	-	194,555
Pasuritë tjera	1,954	-	-	1,954
Gjithsej pasuritë financiare	835,956	33,085	19,104	888,145
Detyrimet				
Depozitat nga klientët	682,101	35,196	18,493	735,790
Depozitat nga bankat	9,174	-	-	9,174
Borxhi i varur	19,325	-	-	19,325
Detyrimet tjera	9,848	-	-	9,848
Gjithsej detyrimet financiare	720,448	35,196	18,493	774,137
Hendeku neto më 31 dhjetor 2017	115,508	(2,111)	611	114,008

Analiza e ndjeshmërisë të valutës së huaj

Valutat e huaja ndaj të cilave Banka është e ekspozuar kryesisht janë Dollari amerikan (USD), Frangu zviceran (CHF) dhe Funta britanike (GBP). Tabela e mëposhtme jep në detaje ndjeshmërisë e Bankës ndaj rritjes përkatëse dhe rënies në vlerën e Euros kundrejt valutave të huaja. Përqindja e përdorur është norma e ndjeshmërisë e përdorur kur raportohet risku i valutës së huaj për personelin menaxhues kryesor dhe përfaqëson vlerësimin e menaxhmentit për ndryshimin e mundshëm në normat e këmbimit të valutës së huaj. Analiza e ndjeshmërisë përfshin vetëm artikujt monetarë të hapur në valutë të huaj dhe korrigjon konvertimin e tyre në fund të periudhës për një ndryshim përkatës në normat valutore. Analiza e ndjeshmërisë përfshin plasmanet në bankat e tjera, paratë e gatshme në bankat korrespondente si dhe depozitat e klientëve, ku emërtimi i shumave është në valutë të ndryshme nga valuta e huadhënësit apo huamarësit. Numri pozitiv më poshtë tregon rritje në fitim dhe kapital tjetër ku Euro forcohet me përqindjet përkatëse kundrejt valutës përkatëse. Për dobësimin përkatës të Euros ndaj valutës përkatëse, do të kishte ndikim përfaqësues të barabartë dhe të kundërt në fitim dhe kapital tjetër, dhe gjendjet më poshtë do të ishin negative.

Normat zyrtare aktuale të këmbimit të valutës për valutat kryesore të përdorura në konvertimin e zërave në datën e raportimit, të denominuara në valuta të huaja, ishin si në vijim (në Euro):

Krahasuar me Euro	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
1 USD	1.144	1.199
1 CHF	1.126	1.177
1 GBP	0.898	0.888

	Dollarë Amerikan (USD)		Franga Zvicerane (CHF)		Funta Britanike (GBP)	
	2018	2017	2018	2017	2018	2017
Normat e ndjeshmërisë	6.5%	10%	3.9%	6%	2.1%	4%
Fitimi dhe humbja	20,538	2,744	45,877	(2,356)	250	957

Sipas mendimit të menaxhmentit, analiza e ndjeshmërisë nuk përfaqëson riskun e brendshëm të këmbimit valutor sepse viti dhe ekspozimi nuk pasqyrojnë ekspozimin gjatë vitit. Transaksionet e denominuara në Dollarë amerikan, Frang zviceran dhe Funta britanike nuk janë të shpeshta dhe janë vetëm për transaksionet dhe plasmanët në institucionet financiare jo të BE-së.

Risku i normës së interesit

Ky është rreziku që vlera relative e një pasurie që sjell interes do të humbasë në vlerë. Mjetet e Bankës janë kryesisht në kredi mesatare dhe afatgjata dhe detyrimet kryesisht janë depozita afatshkurtra, e ekspozon Bankën në një mospërputhje në normat e interesit dhe për pasojë boshllëqet përkatëse i ekspozuan Bankës lëvizjeve të normave të interesit në treg.

Banka merr përsipër ekspozimin ndaj efekteve të luhatjeve në nivelet mbizotëruese të normave të interesit të tregut në bilancin e saj financiar dhe rrjedhat e parasë. Marzhat e interesit mund të rriten si rezultat i ndryshimeve të tilla, por mund të zvogëlohen ose të krijojnë humbje në rast se linden lëvizje të papritura.

Banka është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit, kryesisht si rezultat i kredi dhënies me norma fikse të interesit, me shuma dhe për periudha të cilat ndryshojnë nga ato të depozitave me afat me norma fikse të interesit. Në praktikë normat e interesit në përgjithësi janë fikse për kredi afatshkurtra. Menaxhmenti vendos limitet e nivelit të mospërputhjes së normës së interesit për ndryshim të çmimit që mund të ndërmerret. Sipas kontratave të kundër këmbimit të normave të interesit, Banka pajtohet të këmbëjë dallimin ndërmjet shumës fikse dhe asaj variabile të interesit të llogaritur mbi shumat konceptuale të kryegjës. Paraja në dorë dhe bilanci në BQK në të cilën nuk paguhet interes janë të përfshira në kolonën "pa interes" në tabelën e mëposhtme, si dhe depozitat pa interes të klientëve.

Për t'u mbrojtur për diferencat ndërmjet kredive fikse afatmesme dhe afatgjata në krahasim me ato variabile afatshkurtra dhe afatmesme, përdoret instrumenti derivativ financiar i quajtur kundër këmbim (SWAP) i normës së interesit, ku Banka Raiffeisen në Kosovë është kryesisht paguese e anës së interesit fiks, kurse pala tjetër është paguese e normës variabile, dhe ana variabile është indeksuar në EURIBOR 6 muaj, për të siguruar ndjeshmërisë optimale.

Banka Raiffeisen në Kosovë zbaton menaxhimin aktiv të riskut për t'u mbrojtur kundër pozicioneve të riskut të tregut. Risku i normës së interesit është i mbrojtur pjesërisht nëpërmjet instrumenteve derivative financiare. Për të siguruar stabilitet afatgjatë në rrjedhën e parasë nga portfoliot ekzistuese të kredive, që maturojnë ndërmjet vitit 2018 deri në vitin 2029 këto pozicione janë të mbrojtura përmes kundër këmbimit të normës së interesit.

Kundër këmbimet e normës së interesit kontabilizohen si derivativë në librin bankar pa zbatuar kontabilitetin mbrojtës. Kundër këmbimet e normës së interesit maten me vlerën e tregut në çdo datë raportimi dhe çdo ndryshim që rezulton nga kjo njihet në fitim dhe humbje të vitit. Pozicionet maten duke përdorur metodën e vlerës së pikëve bazë.

Tabela më poshtë jep përmbledhjen e ekspozimit të bankës ndaj riskut të normës së interesit. Të përfshira në tabelë janë pasuritë dhe detyrimet financiare të bankës në shumat e bartura, të kategorizuara sipas ndryshimit të çmimit ose datës së maturimit, cila është më e hershme.

	Me kërkesë dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri 3 muaj	Nga 3 deri 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Jo - specifike	Gjithsej
Pasuritë						
Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	7,600	-	-	-	104,432	112,032
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	23,941	-	-	-	792	24,733
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	34,396	34,626	188,024	336,156	-	593,202
Investimet në letra me vlerë	35	15,097	38,732	69,858	-	123,722
Pasuritë tjera	-	-	-	-	2,502	2,502
Gjithsej pasuritë financiare	65,972	49,723	226,756	406,014	107,726	856,191
Detyrimet						
Depozitat nga klientët	135,419	1,275	16,975	395	575,403	729,467
Depozitat nga bankat	123	-	-	-	495	618
Borxhi i varur	325	-	-	19,000	-	19,325
Detyrimet tjera	-	-	-	-	11,585	10,935
Gjithsej detyrimet financiare	135,867	1,275	16,975	19,395	587,483	760,995
Hendeku neto më 31 dhjetor 2018	(69,895)	48,448	209,781	386,619	(479,757)	95,156

Depozitat me zero interes nga klientët në shumën prej 575,403 mijë Euro janë kryesisht llogari rrjedhëse të bizneseve dhe individëve. Ato nuk kanë ndonjë ndryshim kontraktual të çmimit ose datës së maturimit, por normat e interesit do të përshtateshin në një periudhë të shkurtër kohore si përgjigje ndaj ndryshimeve në normat e interesit të tregut.

	Me kërkesë dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri 3 muaj	Nga 3 deri 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Pa interes	Gjithsej
Pasuritë						
Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	16,091	-	-	-	103,518	119,609
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	38,811	-	-	-	740	39,551
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	33,002	31,979	167,965	299,530	-	532,476
Investimet në letra me vlerë	21,453	14,243	38,480	120,379	-	194,555
Pasuritë tjera	-	-	-	-	1,954	1,954
Gjithsej pasuritë financiare	109,357	46,222	206,445	419,909	106,212	888,145
Detyrimet						
Depozitat nga klientët	136,559	1,998	10,131	534	586,568	735,790
Depozitat nga bankat	8,478	-	-	-	696	9,174
Borxhi i varur	325	-	-	19,000	-	19,325
Detyrimet tjera	-	-	-	-	9,848	9,848
Gjithsej detyrimet financiare	145,362	1,998	10,131	19,534	597,112	774,137
Hendeku neto më 31 dhjetor 2017	(36,005)	44,224	196,314	400,375	(490,900)	114,008

Tabela më poshtë jep përmbledhjen e normave efektive të interesit sipas valutave kryesore për instrumentet financiare monetare kryesore. Analiza është përgatitur duke përdorur normat vjetore efektive.

Në përqindje	2018				2017			
	EUR	USD	CHF	GBP	EUR	USD	CHF	GBP
Pasuritë								
Kreditë dhe paradhëniet për banka	(0.2)	1.6	(0.5)	(0.4)	(0.9)	1.0	(0.8)	0.2
Bonot qeveritare HTM	(0.3)	N/A	N/A	N/A	(0.4)	-	N/A	N/A
Bonot qeveritare AFV	0.5	1.8	N/A	N/A	0.2	2.7	N/A	N/A
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	7.3	N/A	N/A	N/A	7.5	N/A	N/A	N/A
Detyrimet								
Llogaritë e klientëve	N/A	N/A	N/A	N/A	0.0	0.0	0.0	0.0
Depozitat me afat	0.6	0.0	0.0	0.0	1.6	0.0	0.0	0.0
Llogaritë e kursimit	0.0	0.0	0.1	0.1	0.0	0.0	0.2	0.1

Nga perspektiva e menaxhimit të riskut dhe kontrollit, ka dy aspekte të riskut:

- Vlerësimi i riskut
- Kontrolli i riskut

Vlerësimi i riskut të normave të interesit

Ndjeshmëria e riskut të normave të interesit matet për të përcaktuar sasinë e varësisë së vlerës aktuale të një pozicioni në një faktor risku. Ndjeshmëria e normës së interesit, shpesh të referuara si vlera të pikëve bazë (VPB), japin ndryshimin e vlerës aktuale në njësi të monedhës referuese, nën supozimin se normat e interesit ndryshojnë nga 200 bps. Risku i normës së interesit matet duke përdorur metodën VaR (Vlerën në risk). Kjo metodë nënkupton një skenar matjeje ku përdoret kohëzgjatja 10 ditë dhe intervali i besueshmërisë 99 për qind. VaR matet në stresin e 1bps ndryshim në lakoren e rendimentit (yield). Ky skenar supozon implikimin në fitim dhe humbje të Bankës, në rast se lakorja e rendimentit lëviz në një drejtim apo tjetrin me 200 pikë bazë. Më poshtë janë paraqitur të dhënat e VPB për 2018 dhe 2017:

	+200bps		-200bps			+200bps		-200bps	
	Viti1	Viti2	Viti1	Viti2		Viti1	Viti2	Viti1	Viti2
Gjithsej ndjeshmëria e IS 2018	1,500	5,300	-3,700	-8,700	Gjithsej ndjeshmëria e IS 2017	-	4,900	-3,000	-9,700

Vlera në risk më 31 dhjetor 2018 është 234 mijë Euro, për 31 dhjetor 2017 është 207 mijë Euro. Efekti i riskut të normës së interesit në ekuitet është i ngjashëm me atë në fitim dhe humbje. Rezultatet e analizës së ndjeshmërisë i paraqiten menaxhmentit në baza javore, dhe rishikohen në mënyrë të pavarur nga menaxhimi i riskut RBI Vjenë.

Kontrolli i riskut të normës së interesit

Mekanizmi i kontrollit të riskut të normës së interesit shfrytëzohet përmes raporteve ditore të vlerës në pikë bazë (VPB). Banka aktualisht ka limitin e VPB prej 15 mijë Euro. Për qëllim të matjes së VPB, produktet e normës së administruar janë modeluar duke përdorur portfolion e replikuar. Vlera e pikëve bazë matet për valutë dhe për brez kohor. Limitet vendosen edhe për çdo valutë dhe për periudha të ndryshme kohore.

4.5 Risku operacional

Përgjegjësia kryesore për zhvillimin dhe zbatimin e kontroleve për të trajtuar riskun operacional i është dhënë menaxhmentit të lartë në çdo njësi biznesi. Kjo përgjegjësi përkrahët nga zhvillimi i standardeve të përgjithshme të Bankës për menaxhimin e riskut operacional në fushat e mëposhtme:

- kërkesat për ndarjen e duhur të detyrave, duke përfshirë edhe autorizimin e pavarur të transaksioneve
- kërkesat për barazimin dhe monitorimin e transaksioneve
- pajtueshmëria me kërkesat rregullative dhe ligjore
- dokumentimi i kontroleve dhe procedurave
- kërkesat për vlerësimin periodik të riskut operacional dhe përshtatshmërisë së kontroleve dhe procedurave për të trajtuar riskun e identifikuar
- kërkesat për raportimin e humbjeve operacionale dhe veprimet e propozuara korrigjuese
- zhvillimi i planeve kontingjente
- trajnimi dhe zhvillimi profesional
- standardet etike dhe të biznesit
- minimizimi i riskut, duke përfshirë dhe sigurimin kur kjo është efektive.

Pajftueshmëria me standardet e Bankës përkrahet nga një program kontrollesh periodike të ndërmarra nga auditimi i brendshëm. Rezultatet e kontrolleve të auditimit të brendshëm diskutohen me menaxhmentin e njësisë së biznesit të cilës i përkasin, ku përmbledhja i dërgohet komitetit të auditimit dhe menaxhmentit të lartë të Bankës.

4.6 Menaxhimi i riskut të kapitalit

Kapitali rregullativ

Banka menaxhon kapitalin e saj për të siguruar se do të jetë në gjendje të vazhdojë afarizmin duke maksimizuar kthimin për aksionarët përmes optimalizimit të baraspeshës ndërmjet borxhit dhe kapitalit. Strategjia e përgjithshme e Bankës mbetet e pandryshuar nga viti i kaluar. Struktura e kapitalit të Bankës përbëhet nga borxhi, që përfshin huamarrjet dhe ekuiteti që u takon pronarëve të kapitalit, i cili përfshin kapitalin e lëshuar dhe fitimet e mbajtura.

Kërkesat e kapitalit për riskun operacional

Kërkesat e kapitalit për riskun operacional llogariten bazuar në rregulloren e BQK-së "për menaxhimin e riskut operacional", duke përdorur metodën e treguesit themelor. Sipas metodës së treguesit themelor, kërkesa për kapital për riskun operacional është e barabartë me 15 për qind (pesëmbëdhjetë për qind) të treguesit përkatës. Tregues përkatës është mesatarja gjatë tre viteve e shumës së të ardhurave neto nga interesi dhe të ardhurave neto jo nga interesi.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit është proporcioni i kapitalit rregullator ndaj pasurive të ponderuara sipas riskut, zërat jashtë bilancit dhe risqeve të tjera, i shprehur në përqindje. Raporti minimal i kërkuar i mjaftueshmërisë së kapitalit është 8 për qind për kapitalin e Klasit I dhe 12 për qind për fondet vetanake totale. Banka ka përmbushur këto kërkesa rregullative gjatë vitit 2018 dhe 2017.

Pasuritë e ponderuara sipas riskut (RWA-të)

Pasuritë ponderohen në përputhje me kategoritë e gjera të riskut kombëtar, që u caktohet një peshë e riskut në përputhje me shumën e kapitalit që konsiderohet të jetë e nevojshme për t'i përkrahur ato. Zbatohen gjashtë kategori të peshave të riskut (0%, 20%, 50%, 75%, 100%, 150%); për shembull paraja dhe instrumentet e tregut të parasë kanë një peshë risku zero që do të thotë se nuk nevojitet kapital për mbajtjen e këtyre pasurive. Prona dhe pajisjet kanë një peshë 100 për qind të riskut, që do të thotë se duhet të përkrahen nga kapitali (Klasi I) i barabartë me 8 për qind të vlerës së bartur. Pasuritë e ponderuara sipas riskut llogariten në bazë të kërkesave rregullative lokale.

Zotimet e kredive jashtë bilancit merren parasysh. Shumat ponderohen mandej sipas riskut duke përdorur të njëjtat përqindje si për pasuritë e bilancit të gjendjes.

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Gjithsej pasuritë e ponderuara sipas riskut	622,256	565,443
Gjithsej ekspozimet jashtë bilancit të ponderuara sipas riskut	29,915	19,874
Gjithsej pasuritë e ponderuara sipas riskut operacional	53,228	51,739
Gjithsej	705,399	637,056
Kapitali rregullativ (gjithsej kapitali)	132,704	130,351
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (gjithsej kapitali)	18.81%	20.46%

Politika e Bankës është që të mbajë një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besimin e investitorëve, kreditorëve dhe tregut dhe të përkrahë zhvillimin e ardhshëm të biznesit. Ndikimi i nivelit të kapitalit në kthimin e aksionarëve njihet gjithashtu dhe Banka pranon nevojën për të mbajtur një ekuilibër ndërmjet kthimeve më të të larta që mund të jenë të mundshme me më shumë borxh dhe përparësisë dhe sigurisë së ofruar nga një pozicion i fortë i kapitalit.

Nuk ka pasur ndryshime materiale në menaxhimin e kapitalit të Bankës gjatë periudhës.

Raporti borxh/ekuitet

Komiteti i menaxhimit të riskut i bankës rishikon strukturën e kapitalit në bazë të vazhdueshme. Si pjesë e këtij shqyrtimi, komiteti shqyrton koston e kapitalit dhe riskun e lidhur me secilën klasë të kapitalit. Raporti borxh/ekuitet në vitin e përfunduar ishte si më poshtë:

	2018	2017
Borxhi	19,449	27,803
Ekuiteti	127,664	125,315
Raporti borxh/ekuitet neto	15%	22%

5 Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Banka mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të vlerës së drejtë, e cila reflekton rëndësinë e të dhënave të përdorura në kryerjen e matjeve.

Niveli 1: të dhënat që janë çmimet e tregut të kuotuar (të parregulluara) në tregje aktive për instrumente identike.

Niveli 2: të dhënat tjera përveç çmimeve të kuotuar të përfshira në Nivelin 1 që janë të vëzhgueshme ose direkt (d.m.th. si çmime) ose tërthorazi (d.m.th. të përfuara nga çmimet). Kjo kategori përfshinë instrumente të vlerësuar duke përdorur: çmimet e kuotuar në tregjet aktive për instrumente të ngjashme; çmimet e kuotuar për instrumente identike ose të ngjashme në tregje që konsiderohen më pak se aktive; ose teknika tjera vlerësimi ku të gjitha të dhënat e rëndësishme janë direkt ose indirekt të vëzhgueshme nga të dhënat e tregut.

Niveli 3: të dhënat që nuk janë të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin gjithë instrumentet për të cilat teknika e vlerësimit përfshin të dhëna që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe të dhënat jo të vëzhgueshme kanë efekt të konsiderueshëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshinë instrumentet të cilat vlerësohen në bazë të çmimeve të kuotuar për instrumente të ngjashme për të cilat kërkohen korigjime të rëndësishme jo të vëzhgueshme ose supozime për të pasqyruar dallimet ndërmjet instrumenteve.

Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modelet e skontuara të rrjedhave të parasë, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat ekzistojnë çmime tregu të vëzhgueshme, dhe metoda të tjera vlerësimi. Supozimet dhe të dhënat e përdorura në teknikat e vlerësimit përfshijnë normat e interesit pa risk dhe ato si standard krahasimi, rendimentet e bonove (credit spread) dhe premiumet tjera të përdorura në llogaritjen e normave të skontuara, çmimet e bonove dhe kapitalit, normat e këmbimit në valutë të huaj, çmimet e aksioneve dhe çmimet e indeksit të kapitalit dhe luhatjet e pritshme të çmimeve dhe korrelacionet. Qëllimi i teknikave të vlerësimit është të arrijë matjen e vlerës së drejtë e cila pasqyron çmimin që do të merrej për të shitur pasurinë ose që do të paguhej për transferimin e detyrimit në një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes.

5.1 Instrumentet financiare që nuk maten me vlerën e drejtë

Paraqja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme

Paraqja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë depozitat ndërbankare dhe zërat në proces të arkëtimit. Pasi këto gjendje janë afatshkurtra dhe me norma të ndryshueshme vlera e tyre e drejtë konsiderohet e barabartë me vlerën e tyre bartëse.

Kreditë dhe paradhëniet për bankat

Kreditë dhe paradhëniet për bankat përbëhen nga depozitat me afat dhe garancionet nga bankat e tjera. Pasi këto gjendje janë afatshkurtra dhe me norma të ndryshueshme vlera e tyre e drejtë konsiderohet e barabartë me vlerën e tyre bartëse.

Kreditë e varura

Kredia e varur afatgjate, si detyrim ndaj Raiffeisen Bank International, ka një vlerë të drejtë të vlerësuar që përafërsisht është e barabartë me vlerën e saj të bartur për shkak të normës së ndryshueshme të interesit.

Tabela e mëposhtme paraqet vlerën e drejtë të instrumenteve financiare që nuk maten në vlerë të drejtë dhe i analizon ato sipas niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë, ku është e kategorizuar çdo matje e vlerës së drejtë.

Pasuritë	Vlera	Vlera	Vlera	Vlera
	bartëse 2018	e drejtë Niveli 3 2018	bartëse 2017	e drejtë Niveli 3 2017
Hua dhe paradhëniet për klientët	593,202	594,885	532,476	542,246
Detyrimet				
Depozitat nga klientët	729,467	729,962	735,790	735,806
Depozitat nga bankat	618	618	9,174	9,174

5.2 Instrumentet financiare të matura me vlerën e drejtë - hierarkia e vlerës së drejtë

Tabela e mëposhtme analizon instrumentet financiare të matura në vlerë të drejtë në datën e raportimit, sipas nivelit të hierarkisë së vlerës së drejtë, ku është e kategorizuar matja e vlerës së drejtë. Shumat janë të bazuara në vlerat e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar.

31 dhjetor 2018				
Instrumentet jo-derivative	Vlera bartëse	Vlera bartëse drejtë Nivel 1	Vlera e drejtë Nivel 2	Vlera e drejtë Nivel 3
Investimet në letra me vlerë	123,722	97,704	26,018	-
Investime financiare në vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	27,882	6,581	21,301	-
Pasuritë financiare të përcaktuara në vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	95,840	91,123	4,717	-
Derivatvët	812	812	-	-
Derivatvët e mbajtur për menaxhimin e riskut (Shënimi 18)	812	812	-	-

31 dhjetor 2017				
Instrumentet jo-derivative	Vlera bartëse	Vlera bartëse drejtë Nivel 1	Vlera e drejtë Nivel 2	Vlera e drejtë Nivel 3
Investimet në letra me vlerë	194,555	160,970	33,535	-
Investime financiare në vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	79,497	45,912	33,535	-
Investimet financiare në dispozicion për shitje	102,726	102,726	-	-
Investimet financiare të mbajtura deri në maturim	12,332	12,332	-	-
Derivatvët	1,100	1,100	-	-
Derivatvët e mbajtur për menaxhimin e riskut (Shënimi 18)	1,100	1,100	-	-

6 Shpalosjet e tranzicionit

Në faqet në vijim përcaktohet ndikimi i adoptimit të SNRF 9 në pasqyrën e pozicionit financiar dhe fitimet e pashpërndara duke përfshirë efektin e zëvendësimit të llogaritjeve të humbjeve kreditore të SNK 39 me ECL-të e SNRF 9.

	SNK 39			SNRF 9			
	Ref	Kategoria	Shuma	Riklasifikimi	Rimatja	Kategoria	Shuma
Pasuritë							
Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme			119,609				119,609
Investimet financiare - AFV		AFV	79,497	(79,497)	-		0
Në: Instrumenti i borxhit me vlerë të drejtë	A			79,497	-	FVPL	79,497
Investimet financiare - AFS		AFS	102,726	(102,726)	-		0
Në: Instrumentet e borxhit me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	B			102,726	-	FVOCI	102,726
Investimet financiare - HTM		HTM	12,332	(12,332)	-		0
Në: Instrumentet e borxhit me koston e amortizuar	C			12,332	-	AC	12,332
Kreditë dhe paradhëniet për bankat			39,551			AC	39,551
Kreditë dhe paradhëniet për klientët		L&R	532,476	-	(142)	AC	532,334

Gjithsej pasuritë	-	-	(142)	-
Depozitat nga klientët				
Depozitat dhe huatë nga bankat	AC	735,790	-	AC 735,790
Detyrimet financiare të mbajtura për tregtim	AC	9,174	-	AC 9,174
Provizionet dhe detyrimet tjera	AC	1,100	-	FVTPL 1,100
Detyrimi i tatimit të shtyrë	N/A	8,748	-	N/A 8,887
Deferred Tax Liability	D	482	-	482
Gjithsej detyrimet	-	-	139	-

A. Që nga 1 janari 2018, Banka nuk kishte ndonjë instrument borxhi që nuk plotësonte kriterin e SPPI brenda portofolit të saj të mbajtur deri në maturim. Prandaj, zgjodhi të klasifikonte të gjitha këto instrumente si instrumente borxhi të matura me koston e amortizuar

B. Që nga 1 janari 2018, Banka ka vlerësuar portofolin e saj të likuiditetit i cili më parë ishte klasifikuar si instrumenta borxhi AFS. Banka arriti në përfundimin se këto instrumente menaxhohen në kuadër të një modeli biznesi për grumbullimin e rrjedhave monetare kontraktuale dhe shitjen e pasurive financiare. Prandaj, Banka ka klasifikuar këto investime si instrumente borxhi të matura në FVOCI.

C. Që nga 1 janari 2018, Banka ka vlerësuar portofolin e saj të vlerës së drejtë i cili më parë ishte klasifikuar si instrumente borxhi AFV. Banka arriti në përfundimin se këto instrumente menaxhohen në kuadër të një modeli biznesi të portofolit të tregimit. Prandaj, Banka i ka klasifikuar këto investime si instrumente borxhi të matura në FVTPL.

D. Ndikimi i adoptimit të SNRF 9 mbi tatimin e shtyrë është jo-material. Ndikimi i kalimit në SNRF 9 mbi rezervat dhe fitimet e pasqyruara është si më poshtë:

	Rezervat dhe fitimet e mbartura
Fitimet e mbajtura	
Bilanci mbyllës sipas SNK 39 (31 dhjetor 2017)	62,041
Rregullimet e riklasifikimit në lidhje me miratimin e SNRF 9	-
Njohja e SNRF 9 humbjet e pritshme kreditore përfshirë ato të matura në FVOCI (shih më poshtë)	3
Bilanci i hapjes sipas SNRF 9 (1 janar 2018)	62,044
Gjithsej ndryshimi në kapital për shkak të adoptimit të SNRF 9	3

Tabela në vijim barazon kompensimet e hapjes së krijuar të provizioneve për humbjet nga kreditë sipas SNK 39 dhe provizioneve për angazhimet e huasë dhe kontratat e garancisë financiare në përputhje me SNK 37 Provizionet Detyrimet Kontingjente dhe Pasuritë e kushtëzuara në shumat ECL sipas SNRF 9. Detajet tjera janë shpalosur në Shënime 11.

	Provizioni i humbjeve nga kreditë sipas SNK 39 / SNK 37 31 dhjetor 2017	Rimatja	Humbjet e pritshme kreditore SNRF 9 me 1 janar 2018
Lejimet për zhvlerësime			
Kreditë sipas SNK 39 / pasuritë financiare me koston e amortizuar sipas SNRF 9	21,493	(142)	21,351
Llogaritë e arkëtueshme financiare sipas SNK 39 / Instrumentet e borxhit SNK 9	-	-	-
Letrat me vlerë të investimit të borxhit të gatshme për shitje sipas SNK 39 / pasuritë financiare të borxhit në FVOCI sipas SNRF 9	-	-	-
	21,493	(142)	21,351
Garancitë financiare	20	138	158
Letër kreditë për konsumatorët	-	-	-
Angazhime të tjera	-	1	1
	20	139	159

7 Shpenzimet për humbjen e kreditorëve

Tabela më poshtë tregon tarifat e humbjeve të pritshme kreditorëve për instrumentet financiare për vitin 2018 të regjistruara në pasqyrën e të ardhurave:

Shpenzimet e humbjes kreditorëve 2018	Kategoria 1 Individuale	Kategoria 1	Kategoria 2 Individuale	Kategoria 2	Kategoria 3	POCI	Gjithsej
Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme dhe Kreditë dhe paradhëniet për bankat	25	-	-	-	-	-	25
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	-	732	-	102	(49)	2,114	2,899
Instrumentet e borxhit të matur në FVOCI	39	-	-	-	-	-	39
Garancitë financiare	-	16	-	1	-	-	17
Angazhimet e huasë	-	158	-	15	-	-	173
Letër kreditë	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej humbja nga rënia në vlerë	64	906	-	118	(49)	2,114	3,153

Tabela më poshtë tregon shpenzimet e zhvlerësimit të regjistruara në pasqyrën e të ardhurave sipas SNK 39 gjatë vitit 2017:

31 dhjetor 2017	Specifik	Kolektive (ekspozime individualisht jo të rëndësishme)	Kolektive (ka ndodhur por ende nuk është identifikuar)	Gjithsej
Shpenzimet e humbjes kreditorëve në detyrimet nga bankat	-	-	-	-
Shpenzimet e humbjes kreditorëve për kreditë dhe paradhëniet për klientët				
Korporatë	2,387	-	(209)	2,178
NVM	1,138	-	224	1,362
Huazimi i konsumatorëve	1,642	-	442	2,084
Hipotekat rezidenciale	(39)	-	70	31
	5,128	-	527	5,655
Shpenzimet e humbjes kreditorëve për investimet financiare - të vlefshme për shitje				
Letrat me vlerë të borxhit	-	-	-	-
Gjithsej në zërat e bilancor	5,128	-	527	5,655
Zërat jashtë bilancor	-	-	(10)	(10)
Gjithsej	5,128	-	517	5,645

8 Ndryshimet në detyrimet nga aktivitetet e financimit

	1 janar 2018	Rrjedha e parasë	Deklarimi i dividendës	31 dhjetor 2018
Huamarrjet që mbajnë interes Shënim 16	8,478	(8,354)	-	124
Dividendët e pagueshëm	-	(17,500)	17,500	-
Gjithsej detyrimet nga aktivitetet financuese	8,478	(25,854)	17,500	124
	1 janar 2017	Rrjedha e parasë	Deklarimi i dividendës	31 dhjetor 2017
Huamarrjet që mbajnë interes Shënim 16	255	8,223	-	8,478
Dividendët e pagueshme	-	(15,400)	15,400	-
Gjithsej detyrimet nga aktivitetet financuese	255	(7,177)	15,400	8,478

9 Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme

	2018	2017
Paraja në dorë	59,132	46,776
Gjendjet në BQK	45,300	56,743
Llogaritë korrespondente në banka tjera	7,625	16,090
Lejimet për llogaritë me bankat e tjera	(25)	-
Gjithsej	112,032	119,609

Paraja, ekuivalentet e saj dhe rezerva e detyrueshme përfshijnë një bilanc likuiditeti rezervë të detyrueshëm në BQK prej 71,329 mijë Euro (31 dhjetor 2017: 71,623 mijë Euro). Kërkesa e rezervës së likuiditetit llogaritet në bazë të një mesatare të thjeshtë mbi një javë dhe duhet të mbahet si 10 për qind e depozitave bankare të pagueshme brenda një viti. Ajo përbëhet nga bilancet në BQK dhe 50 për qind e parasë në dorë. Si e tillë gjendja mund të ndryshojë nga dita në ditë. Kjo gjendje përjashtohet nga paraja dhe ekuivalentët e parasë për qëllime të pasqyrës së rrjedhjes së parasë.

Më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraja dhe ekuivalentët e parasë së bankës për qëllim të pasqyrës së rrjedhës së parasë ishin si në vijim:

	2018	2017
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme	112,032	119,609
Minus: Rezerva e detyrueshme e likuiditetit	(71,329)	(71,623)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë për qëllim të pasqyrës së rrjedhjes së parasë	40,703	47,986

